# **Roli i gjinisë në parandalimin** dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm

*Praktikat e mira në zbatimin e ligjit*



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Vjenë, prill 2019
©OSBE 2019
Dizajni designMind, Marianne Michalakis
Printimi nga Druckerei Ferdinand Berger & Söhne GmbH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet dhe nuk mund të ruhet në sisteme ku mund të nxirret apo të transmetohet në asnjë formë dhe në asnjë mënyrë – elektronike, mekanike, përmes fotokopjimit, regjistrimit apo mënyrave të tjera – pa lejen paraprake me shkrim të botuesve. Ky kufizim nuk vlen për kopjet dixhitale dhe për kopjet fizike të këtij botimi për përdorim të brendshëm të OSBE-së dhe për përdorim personal apo edukues, për qëllime jofitimprurëse dhe jotregtare, me kusht që në kopje të përcaktohet OSBE-ja si burimi i tij.

ISBN: 978-3-903128-69-9

Departamenti i Kërcënimeve Transnacionale
Sekretariati i OSBE-së
Wallnerstrasse 6, A-1010 Vienna, Austria
www.osce.org/atu

Botimi i këtij udhëzuesi është mundësuar falë kontributit bujar të Ministrisë Norvegjeze të Punëve të Jashtme. Përmbajtja e këtij botimi, duke përfshirë pikëpamjet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në të nuk përbëjnë domosdoshmërisht ato të donatorit. Ky nuk është një dokument që ka për bazë konsensusin e 57shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Sekretariati i OSBE-së nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për saktësinë apo plotësinë e asnjë informacioni, për asnjë udhëzim dhe për asnjë këshillë të dhënë apo për gabimet e shtypit. Sekretariati i OSBE-së nuk mund të mbajë përgjegjësi për asnjë humbje apo dëme që mund të vijnë nga përdorimi i informacioneve që përmban ky botim dhe as për përmbajtjen e burimeve të jashtme, duke përfshirë edhe faqet e jashtme të internetit që përmenden si referencë në këtë botim.

osbe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Norwegian Ministry of Foreign Affairs

# **Roli i gjinisë në parandalimin** dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm

*Praktikat e mira në zbatimin e ligjit*

# Përmbajtja


FALËNDERIME 6

SHKURTESAT 7

FJALORI 9

PARATHËNIE 12

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 15

**KAPITULLI I: TERMAT DHE PËRKUFIZIMET 17**

1) Përkufizimet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (EDhRÇT) 17

*Terrorizmi 17*

*Ekstremizmi i dhunshëm që çon në terrorizëm 18*

*Parandalimi dhe kundërvënia ndaj EDhRÇT-së 19*

2) Shprehjet, përkatësitë gjinore, ndërgjegjësimi dhe integrimi gjinor në kontekstin e parandalimit dhe kundërvënies ndaj EDhRÇT-së 20

**KAPITULLI II: PSE INTEGRIM GJINOR NË PARANDALIMIN DHE KUNDËRVËNIEN NDAJ EDHRÇT-SË 23**

1) EDhRÇT-ja si kërcënim ndaj sigurisë 23

*ISIL/Daesh dhe terrorizmi i ndikuar ideologjikisht 24*

*Terrorizmi i të djathtës dhe së majtës ekstreme 27*

*Faktorët potencialë që favorizojnë EDhRÇT-në 29*

2) Parandalimi efikas dhe masat e marra 32

3) Politikat dhe kërkesat legjislative për parandalimin dhe kundërvënien me bazë gjinore ndaj EDhRÇT-së 34

**KAPITULLI III: SI NDIKOJNË DINAMIKAT GJINORE NË PARANDALIMIN DHE KUNDËRVËNIEN NDAJ EDHRÇT-SË 41**

1) Gratë dhe ekstremizmi i dhunshëm 41

2 Ndërgjegjësimi gjinor dhe analiza me bazë gjinore e EDhRÇT-së 42

*Rolet e ndryshme të burrave dhe të grave në organizatat e dhunshme ekstremiste 44*

*Motivimi me bazë gjinore i ekstremizmit të dhunshëm 47*

*Roli i mashkulloritetit dhe feminitetit në mobilizimin e ekstremizmit të dhunshëm 48*

*EDhRÇT, përkatësia gjinore dhe sistemi i drejtësisë penale 50*

3) Roli i grave në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së 52

**KAPITULLI IV: MËSIMET E NXJERRA RRETH INTEGRIMIT GJINOR DHE GRAVE NË SEKTORIN E SIGURISË** **59**
1) Zbatimi gjithëpërfshirës i ligjit dhe parandalimi dhe kundërvënia ndaj EDhRÇT-së 60
*Respektimi i të drejtave të njeriut* *61*
*Policimi efikas dhe i orientuar nga komuniteti* *62*
2) Integrimi gjinor në sektorin e sigurisë dhe parandalimi dhe kundërvënia ndaj EDhRÇT-së 64
*Efikasiteti operacional i agjencive të zbatimit të ligjit* *65*
*Përfaqësimi në shifra dhe nxitja e ndërgjegjësimit* *67*
*Integrimi gjinor dhe profesionalizimi i forcave të zbatimit të ligjit* *70*
*Integrimi gjinor në reformën e drejtësisë penale* *72*
*Integrimi gjinor në reformën penale* *74*
*Mësimet nga programet ekzistuese për burrat mbi paqen, sigurinë dhe mashkulloritetin* *77*

**KAPITULLI V: RASTE STUDIMORE NGA RAJONI I OSBE-SË. MËSIMET E NXJERRA LIDHUR ME NDËRGJEGJËSIMIN GJINOR NË PARANDALIMIN DHE KUNDËRVËNIEN NDAJ EDHRÇT-SË** **81**
1) Puna në terren dhe angazhimi me komunitetet 82
*Ritmi i punës me parandalimin: Rasti i Policisë Kalorësiake Mbretërore Kanadeze dhe "tabelat e situatës" së Torontos* *82*
*Angazhimi efektiv i komuniteteve të pakicave: Rasti i policisë së Oslos në Norvegji* *85*
2) Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të komuniteteve 89
*Programi për gratë e përfshira në transformimin e komunitetit si dhe Programi për Ndërhyrjen e Hershme të Grave: Rasti i Irlandës së Veriut* *89*
*Fushata e prindërve kundër terrorizmit: rasti i Zyrës së Programit të OSBE-së në Dushanbe* *92*
3) Trajnimet dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për gratë në fushën e sigurisë 95
*Trajnimet për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm për efektivet e policisë: Projekti i Misionit të OSBE-së në Kosovë* *95*
4) Roli i pikave fokale gjinore institucionale 99
*Pikat fokale gjinore në Ministrinë e Sigurisë: Rasti i Bosnjë-Hercegovinës* *99*
5) Policimi në komunitet me ndjeshmëri gjinore dhe mekanizmat e referimit 105
*Programi për policimin në komunitet dhe mekanizmat e referimit për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Rasti Jendouba dhe Tabarka në Tunizi.* *105*

6) Verbëria gjinore në sistemin e drejtësisë penale 109
*Rasti i hetimit dhe gjyqit të Beate Zschäpe në Gjermani 109*

**KAPITULLI VI: UDHËZIME PËR INTEGRIMIN E PERSPEKTIVËS GJINORE NË SEKTORIN E SIGURISË 113**
*Oficerët e vijës së parë 113*
*Drejtuesit e lartë 116*
*Akademitë policore 119*

**KAPITULLI VII: INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË STRATEGJI, POLITIKA DHE PROGRAME PËR PARANDALIMIN DHE KUNDËRVËNIEN NDAJ EDHRÇT-SË 123**
*Analiza gjinore 124*
*Personeli gjinor 125*
*Nisma për ngritjen e kapaciteteve 126*
*Reforma e sektorit të sigurisë 127*
*Bashkërendimi me shoqërinë civile 127*
*Spektri EDhRÇT 129*

BURIMET E OSBE-SË 130

BIBLIOGRAFIA 131

# Falënderime

Ky udhëzues është përgatitur nga Departamenti i OSBE-së për Kërcënimet Transnacionale (DKTN), Njësia e Veprimit kundër Terrorizmit (NjVKT) nën drejtimin e Camilla Bognoe, Këshilltare Kundër Terrorizmit. NjVKT-ja dëshiron të falënderojë Kathrin Quesada për rolin e saj drejtues në hartimin dhe formulimin e këtyre udhëzimeve, Jagoda Walorek dhe Allison Peters për kontributet dhe ekspertizën e tyre të shkëlqyer teknike, si dhe Michelle Barsa për kërkimet e saj në fazat fillestare të hartimit të udhëzuesit. Falënderime të veçanta shkojnë edhe për Georgia Holmer, Këshilltare e Lartë për Çështjet Kundër Terrorizmit, për mbështetjen dhe orientimet e saj të vazhdueshme.

Mbështetje e vyer është dhënë edhe nga drejtuesi i NjVKT-së, Argo Avakov, si dhe nga anëtarët e NjVKT-së, Agnieszka Hejduk, Orlaith King, Aleksandra Klosinka dhe Katerina Koci. NjVKT-ja u shpreh gjithashtu mirënjohjen edhe shumë studiuesve të tjerë për bashkëpunimin dhe vlerësimet e dhëna gjatë procesit. Në mënyrë të veçantë, NjVKT-ja dëshiron të falënderojë personat e mëposhtëm për kontributet e tyre të posaçme me rastet e studimit dhe për seancën e grupit të punës të ekspertëve që e mbështetën këtë projekt:

- **Ankica Tomic,** Ministria e Sigurisë e Bosnje-Hercegovinës
- **Barbara Chalgaf dhe Kathleen White,** Strategjia Aktis
- **Shpresa Mulliqi,** Misioni i OSBE-së në Kosovë
- **Lise Crouch,** Policia Kanadeze, *Royal Mounted*
- **Andreas Corvalan dhe Kim Hiorth,** Distrikti i Policisë i Oslos
- **Ulrich Gams,** Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
- **Sammy Douglas,** Moderator për Rigjenerimin Social, Ekonomik të Komunitetit, Irlanda e Veriut
- **Partneriteti i Grave për Ndërhyrje dhe Alastair Hughes,** Departamenti i Komuniteteve, Irlanda e Veriut
- **Abdumannop Saitov,** Zyra e Programeve të OSBE-së në Dushanbe.

NjVKT-ja është gjithashtu mirënjohëse për bashkëpunimin dhe vlerësimet e dhëna nga stafi i Seksionit të Çështjeve Gjinore të Sekretariatit të OSBE-së, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Misioni në Bosnje-Hercegovinë, Misioni në Kosovë, Misioni në Mal të Zi, Misioni në Serbi, Misioni në Shkup, Zyra e Programeve e OSBE-së në Dushanbe, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut dhe nga subjektet dhe institucionet e tjera të OSBE-së, ekspertët dhe organizatat që dhanë kontribute të rëndësishme gjatë procesit të hartimit të udhëzuesit.

# Shkurtesat

| | |
|---|---|
| **NjVKT** | Njësia për Veprim Kundër Terrorizmit |
| **QKAKPDH** | Qendra Kanadeze për Angazhimin e Komunitetit dhe Parandalimin e Dhunës |
| **OSHC** | Organizatat e Shoqërisë Civile |
| **KEDh** | Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **EUROPOL** | Agjencia e Bashkimit Evropian për Zbatimin e Ligjit |
| **LHT** | Luftëtar i Huaj Terrorist |
| **FGKT** | Forumi Global Kundër Terrorizmit |
| **GFP** | Pikë Fokale Gjinore |
| **GIRDS** | Instituti Gjerman për Studimet e Radikalizimit dhe Çradikalizimit |
| **GRASP** | Projekti për Mbështetje dhe Shpëtimin nga Bandat |
| **Incel** | Beqarë të pavullnetshëm (i referohet lëvizjes me këtë emër) |
| **IZHS** | Instituti për Zhvillim Strategjik |
| **ISIL/Daesh** | I ashtuquajturi Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit |
| **ISIS** | I ashtuquajtur Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë |
| **LDB** | Lëvizja e Djathtë e Burrave |
| **OJQ** | Organizatë Joqeveritare |
| **LNS** | Lëvizja Nacionaliste Socialiste |
| **PkT** | Prindërit kundër Terrorizmit |
| **P/KEDhRÇT** | Parandalimi dhe Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm |
| **PEDh** | Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm |
| **RVR** | Rrjeti i Vetëdijësimit për Radikalizimin |
| **RCMP** | Policia Kanadeze, Royal Mounted |
| **SAVE** | Platforma e Motrave Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm |
| **DhBSGJ** | Dhuna me Bazë Seksin dhe Gjininë |
| **QSS** | Qeverisja e Sektorit të Sigurisë |
| **RSS** | Reformimi i Sektorit të Sigurisë |
| **Q/RSS** | Qeverisja dhe Reformimi i Sektorit të Sigurisë |
| **OSBE** | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| **DKT** | Departamenti i Kërcënimeve Transnacionale |
| **OKB** | Kombet e Bashkuara |

| | |
|---|---|
| **KSKB** | Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara |
| **RKSKB** | Rezoluta e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara |
| **VEO** | Organizata të Dhunshme Ekstremiste |
| **EDhRÇT** | Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi që Çon në Terrorizëm |
| **RGE** | Rrjeti i Grave dhe Ekstremizmit |
| **GPTK** | Gratë e Përfshira në Transformimin e Komunitetit |
| **PNHG** | Programi i Ndërhyrjeve të Hershme të Grave |
| **GPS** | Gratë, Paqja dhe Siguria |
| **GpK** | Gratë Pa Kufij |
| **YMCAV** | Rrethet e Djemve kundër Dhunës |

# Fjalori

Ky fjalor qartëson disa terma kyçë që përdoren në këtë udhëzues. Përkufizimet e dhëna janë vetëm për qëllime të këtij udhëzuesi dhe jo përkufizime zyrtare të OSBE-së.

**"e djathta alternative"**

Përshkrimi bashkëkohor i supremacisë së bardhë dhe nacionalizmit të bardhë, të cilët lidhen me nocionin e ruajtjes dhe mbrojtjes së racës së bardhë në Evropë dhe në Amerikën e Veriut. Kjo lëvizje përshkruhet si përzierje e racizmit, nacionalizmit dhe populizmit të djathtë ekstrem. Ajo kritikon "multikulturalizmin" dhe kërkon më pak të drejta për personat jo të bardhë dhe emigrantët, si dhe për pakicat fetare, etnike dhe seksuale. Këto lëvizje janë shpesh mizogjene dhe, si burrat ashtu edhe gratë që janë pjesë e tyre, besojnë se gratë duhet të qëndrojnë kryesisht në shtëpi, të rrisin fëmijët dhe të kujdesen për familjen. Gratë mund të kryejnë rolin e "gruas me një qëllim" ose atë të "gruas tradicionale" (gruaja tradicionale që mbështet angazhimin e bashkëshortit, veçanërisht mes mediave sociale). Të pakta janë gratë që mund të gjenden në funksione drejtuese.

**Kohezioni i komunitetit**

Shkalla e lidhjes së njerëzve në bazë të interesave dhe qëllimeve të përbashkëta apo zhvillimi i të kuptuarit reciprok dhe një sensi identiteti apo përkatësie kolektive që çon në besim reciprok dhe efikasitet kolektiv.

**Policimi me bazë komunitetin**

Filozofi dhe strategji organizative që nxit përpjekjet bashkëpunuese me bazë partneritetin mes policisë dhe komunitetit, të cilit ajo i shërben, me qëllim identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen në mënyrë efikase dhe efiçente të problemeve me krimin dhe frikën nga krimi, si dhe zgjidhjen e problemeve të sigurisë fizike, trazirave sociale dhe problemeve të lagjeve, duke çuar në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë.

**Qëndresa e komunitetit**

Aftësia e komunitetit për të rezistuar, për t'iu përgjigjur dhe për t'u rikuperuar nga një gamë e gjerë ngjarjesh të dëmshme dhe negative, duke përfshirë edhe krimin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

**Luftëtarë të Huaj Terroristë**

Individë që udhëtojnë në një shtet të ndryshëm nga shteti i tyre i vendbanimit apo kombësisë me qëllim kryerjen, planifikimin e akteve terroriste ose pjesëmarrjen në to ose dhënien dhe marrjen e stërvitjes terroriste, duke përfshirë edhe stërvitjen në lidhje me konfliktet e armatosura.

### Gjinia

Gjinia është termi që përdoret për të përshkruar rolet e krijuara nga shoqëria për gratë dhe burrat. Gjinia është identiteti që njeriu fiton duke e mësuar, ndryshon me kohën dhe ndryshon ndjeshëm brenda një kulture apo mes kulturave të ndryshme. Ndryshe nga gjinia, termi seks përdoret për të treguar ndryshimet biologjike mes grave dhe burrave.

### Pakicë

Një grup, identiteti i të cilit shtrihet përtej normave dominuese ose kryesore kulturore, sociale dhe politike sa i përket racës, etnisë, gjinisë, moshës, aftësisë fizike dhe mendore, klasës, besimit fetar dhe besimeve në përgjithësi, gjuhës dhe kulturës. Pakicat janë zakonisht më të vogla në numër krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, mund të jenë të disavantazhuara politikisht, ekonomikisht dhe në aspekte të tjera dhe kërkojnë shpesh jo vetëm të ruajnë identitetin e tyre, por dhe ta shprehin më fort atë identitet.

### Neonazizmi

Lëvizje militante sociale ose politike që kërkojnë të ringjallin dhe të zbatojnë ideologjinë e nazizmit. Neonazistët kanë për qëllim të krijojnë një shtet politik fashist, të vënë në zbatim ideologjinë e tyre për të nxitur urrejtjen dhe për të sulmuar pakicat. Ky është një fenomen global me përfaqësim të organizuar në shumë vende dhe në rrjete ndërkombëtare. Ai huazon disa elemente nga doktrinat naziste të viteve 1930 dhe 1940, duke përshirë ultra-nacionalizmin, racizmin, ksenofobinë, homofobinë dhe antisemitizmin. Mohimi i holokaustit është një nga karakteristikat e tij të zakonshme, siç është përdorimi i simboleve të nazizmit dhe admirimi i Adolf Hitlerit.

### Nacionalizmi agresiv

Nacionalizmi agresiv karakterizohet nga nxitja e interesave të një kombi të caktuar në kurriz të kombeve apo pakicave të tjera, sidomos me qëllim krijimin apo ruajtjen e sovranitetit mbi një atdhe real apo të perceptuar. Ai orientohet nga krijimi dhe ruajtja e një identiteti kombëtar të bazuar në karakteristika të përbashkëta sociale, si kultura, gjuha apo besimi në një paraardhës të përbashkët. Nacionalizmi agresiv mbron tezën se një komb duhet të vetëqeveriset, të mos ketë ndërhyrje nga jashtë (si për shembull, sulme nga forca të jashtme apo individë që perceptohen si të interesuar për të cenuar karakteristikat e përbashkëta të një kombi).[1]

### Profilizimi

Të parit në mënyrë sistematike të një sërë karakteristikash fizike, psikologjike dhe sjelljesh si të lidhura me lloje të caktuara autorësh të veprave penale dhe përdorimi i këtyre karakteristikave si bazë për marrjen e vendimeve nga ana e organeve të zbatimit të ligjit. Në kuadrin e këtij udhëzuesi, më i rëndësishëm është profilizimi me bazë gjininë, moshën dhe etninë.

---

1 Plani i Veprimit i Bukureshtit i OSBE-së i vitit 2001 promovon “masat me qëllim parandalimin dhe luftën ndaj nacionalizmit agresiv, racizmit, shovinizmit, ksenofobisë dhe antisemitizmit në media.” Shih: *Plani i Veprimit i Bukureshtit për Kundërvënien ndaj Terrorizmit* (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 4 dhjetor 2001), pika 12.

### Mashkulloriteti toksik

Një nocion që u referohet sjelljeve të krijuara sociale që shohin, vlerësojnë rolet steriotipike gjinore mashkullore si të dhunshëm, jo emocionalë, seksualisht agresivë, dominantë e kështu me radhë.

### Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që çon në terrorizëm (EDhRÇT)

Një proces dinamik, ku individi arrin të pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme dhe ndoshta edhe legjitime. Kjo mund ta bëjë personin që në një moment të caktuar, por jo domosdoshmërisht, të mbrojë, të veprojë në mbështetje të terrorizmit apo të angazhohet edhe vetë në terrorizëm.

# Parathënie

Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm (EDhRÇT) janë sfida transnacionale që nuk kufizohen në asnjë kombësi, etni, besim fetar, ideologji apo gjini. Natyra e paparashikueshme dhe në zhvillim e sipër e këtyre kërcënimeve i bën ato të vështira për t'u parandaluar apo për t'iu kundërvënë. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë qenë të prera në dënimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe në mbështetjen e një qasjeje shumëdimensionale që fokusohet në parandalimin e EDhRÇT-së.

OSBE-ja beson te parandalimi dhe kundërvënia ndaj EDhRÇT-së përmes një qasjeje që përfshin të gjithë shoqërinë. Kjo pasqyron besimin e saj se përpjekjet për t'iu kundërvënë terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nuk mund të jenë më përgjegjësi vetëm e aktorëve të sigurisë; për të qenë efikasë në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së kërkohet një qasje bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse, një qasje ku marrin pjesë edhe subjekte të tjera qeveritare dhe aktorë të shoqërisë civile. Kjo do të thotë, gjithashtu, se duhet të përmirësohet dhe besimi dhe komunikimi mes aktorëve të sigurisë dhe komunitetit. Ndonëse përpjekjet e suksesshme të shoqërisë civile për të parandaluar dhe për t'iu kundërvënë EDhRÇT-së marrin parasysh rëndësinë e familjes, grave, rinisë, edukatorëve, drejtuesve të besimeve fetare dhe drejtuesve të komunitetit, sektori i sigurisë ka qenë historikisht më i ngadaltë në përqafimin e diversitetit, duke përfshirë edhe aspektet që lidhen me gjininë. Kjo mund të shihet dhe në përqindjen e grave që punojnë në sektorin e sigurisë, si dhe në mungesën e zakonshme të ndjeshmërisë gjinore të shërbimeve policore që punojnë drejtpërdrejt me komunitetet.

Ky udhëzues pasqyron angazhimin e OSBE-së në mbështetje të një qasjeje me ndjeshmëri gjinore që duhet të ndërmarrë sektori i sigurisë në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e kanë vlerësuar rëndësinë e gjinisë në disa angazhime të tyre, duke përfshirë edhe Deklaratën e Këshillit Ministror të OSBE-së Nr. 4/15 për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, deklaratë që u miratua në Beograd në dhjetor të vitit 2015. Gjithashtu, OSBE-ja mbështet edhe Rezolutën 2242(2015) të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, e cila kërkon një integrim më të mirë të axhendave të shteteve sa u përket grave, paqes dhe sigurisë, duke përfshirë edhe kundërvënien ndaj terrorizmit dhe EDhRÇT-së.

Një përbërës kyç në arritjen e një reagimi me ndjeshmëri gjinore ndaj kërcënimit të EDhRÇT-së është garantimi i përfaqësimit si duhet i grave në sektorin e sigurisë, në tryezat ku përcaktohen politikat dhe programet, si dhe në rolet operacionale në fushën e zbatimit të ligjit. Megjithatë, duhet gjithashtu të merren masat që si burrat, ashtu edhe gratë e përfshira në zbatimin e ligjit të jenë të vetëdijshëm për përvojat dhe sfidat e ndryshme që përbën EDhRÇT-ja për gratë dhe burrat, si dhe për vajzat dhe djemtë. Kjo përfshin edhe se si

persona të ndryshëm vihen në shënjestër të rishikuar deri ketu, 27 shtator se si persona të ndryshëm punojnë për parandalimin e EDhRÇT-së dhe se si mund ta përjetojnë ata ndryshe viktimizimin nga grupet e dhunshme ekstremiste. Ky komponent përfshin edhe një njohje më të thelluar të stereotipeve gjinore që shfrytëzohen nga ekstremistët e dhunshëm dhe se pse është e rëndësishme që komunitetet dhe forcat e zbatimit të ligjit të punojnë së bashku për rrëzimin e këtyre stereotipeve. Kjo mund të nxisë krijimin e modeleve dhe narrativave pozitive që shërbejnë për forcimin e tolerancës dhe për parandalimin e EDhRÇT-së.

Njësia e Veprimit kundër Terrorizmit (NjVKT) në Departamentin e Kërcënimeve Transnacionale të OSBE-së vazhdon të jetë një qendër burimore për të 57 shtetet anëtare të OSBE-së, operacionet e saj në terren dhe për institucionet e pavarura, duke i ndihmuar ato që të mbështesin dhe të zbatojnë angazhimet e OSBE-së kundër terrorizmit. Shpresa jonë është që këto burime të kontribuojnë në përmirësimin e kapaciteteve të forcave të zbatimit të ligjit dhe shoqërisë civile në punën e tyre të përbashkët për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Ne besojmë se rastet e studimit në këtë botim do të ndihmojnë në ilustrimin e disa prej pikave të mira që ekzistojnë dhe do të tregojnë se si forcat e zbatimit të ligjit, përmes ligjeve më të mira me ndjeshmëri gjinore, mund ta integrojnë më mirë punën e tyre operacionale në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

Ky udhëzues shërben si një orientim për forcat e zbatimit të ligjit dhe aktorët e sigurisë për të kuptuar më mirë dinamikat gjinore në EDhRÇT dhe synon t'i ndihmojë ata që të reagojnë më mirë dhe me më shumë ndjeshmëri gjinore. Ai plotëson serinë e udhëzimeve të fokusuara në këtë rajon dhe të botuara nga NjVKT-ja në vitin 2018/19 mbi sfidat në zhvillimin dhe zbatimin e programeve efikase për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Ndonëse ky udhëzues është përshtatur për qëllime të forcave të zbatimit të ligjit, ne presim që ai dhe botime të tjera të jenë burime të çmuara edhe për politikëbërësit dhe aktorët e shoqërisë civile në të gjithë zonën e OSBE-së që punojnë për forcimin e qasjeve gjithëpërfshirëse ndaj paqes dhe sigurisë.



**Rasa Oustraskaite**

Koordinatore e Aktiviteteve për Adresimin e Kërcënimeve Transnacionale
Sekretariati i OSBE-së

# Përmbledhje ekzekutive

OSBE-ja e ka vlerësuar rëndësinë e aspektit gjinor në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm në një sërë deklaratash me të cilat kanë rënë dakord shtetet e saj pjesëmarrëse. OSBE-ja ka përqafuar në veçanti rekomandimet e rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurisë dhe Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara përmes deklaratës së saj nr. 4/15 për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së të Këshillit të Ministrave të OSBE-së, miratuar në Beograd në dhjetor të vitit 2015.

Me daljen e një kuadri politikash dhe studimesh dhe me marrjen e nismave programatike me synim parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, janë kuptuar gjithmonë e më shumë nevojat për adresimin e dimensioneve gjinore të EDhRÇT-së, si në politika, ashtu edhe në praktikë. Stereotipet gjinore dhe ankesat shpesh manipulohen dhe shfrytëzohen nga organizatat e dhunshme ekstremiste në propagandën e tyre për rritjen e rekrutimeve, një fakt shpesh i anashkaluar në reagimet e forcave të zbatimit të ligjit. Rëndësia e qasjes së vetëdijshme gjinore ndaj parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së, përfshirjes së grave në këtë qasje dhe adresimit të mashkulloritetit toksik që kontribuon në tërheqjen e organizatave të dhunshme ekstremiste është vlerësuar nga një sërë organesh rajonale dhe ndërkombëtare.

Provat tregojnë se forcat policore, të cilat kanë në përbërjen e tyre edhe burra dhe gra me uniformë që përfaqësojnë popullatat fetare, etnike dhe pakicat raciale, mund të ndihmojnë në arritjen e besimit mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe komuniteteve. Kjo ndihmon edhe për rritjen e mundësive për kushte të favorshme për kundërvënien ndaj EDhRÇT-së dhe më shumë mundësi për adresimin e tyre. Për të qenë efikase dhe të qëndrueshme, strategjitë e qeverive të ndryshme për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së duhet të përfshijnë në to analiza të forta gjinore. Përveç kësaj, si burrat, ashtu edhe gratë që janë pjesë e forcave të zbatimit të ligjit që punojnë për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së duhet që të kuptojnë minimalisht se si ndikojnë faktorët gjinorë në EDhRÇT.

Ky udhëzues fokusohet kryesisht te zbatimi i ligjit dhe mënyra se si e përmirëson ndërgjegjësimi gjinor mundësinë për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm apo për t'iu kundërvënë atij. Përveç kësaj, në të shpjegohet gjithashtu se si shoqëria civile dhe organizatat e tjera joshtetërore dhe institucionet luajnë role kyçe në ofrimin si të shërbimeve, ashtu edhe të mbikëqyrjes. Ai ofron gjithashtu burime të tjera për këtë temë për aktorët e sigurisë.

Rastet e studimit dhe kërkimet e prezantuara në këtë udhëzues tregojnë se sa i rëndësishëm është integrimi i plotë i perspektivës gjinore në strategji, politika, programe dhe projekte në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së që ato të jenë efikase dhe të qëndrueshme. Përveçse ofron një pasqyrë të hollësishme të mënyrës se si gjinia ndikon te EDhRÇT-ja, ky udhëzues ofron gjithashtu edhe disa rekomandime dhe mjete që i ndihmojnë aktorët e zbatimi të ligjit në integrimin e ndërgjegjësimit për gjininë në punën e tyre për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

# Kapitulli I: Termat dhe përkufizimet

## 1) Përkufizimet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (EDhRÇT)

Diskutimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (EDhRÇT) është i vështirë për shkak se nuk ka përkufizime për të cilat të ketë një dakordësi universale. Qeveritë kombëtare, si dhe organizatat e vendeve të ndryshme, si në nivel rajonal ashtu edhe ndërkombëtar, janë përpjekur t'i klasifikojnë këto fenomene me qëllim parashikimin e tyre si vepra penale dhe të hartojnë strategji efikase parandalimi.

### Terrorizmi

Ndonëse përkufizimi i terrorizmit përbën një çështje debati mes ekspertëve dhe qeverive dhe ndërkohë që ekzistojnë variante të ndryshme të përkufizimeve kombëtare, Kombet e Bashkuara, në një sërë instrumentesh ndërkombëtare, i referohen terrorizmit si një sërë aktesh penale (për shembull, marrja peng,[2] bombardimi,[3] sulmet ndaj mjeteve ajrore civile në bord[4]) ose aktivitete të grupeve që ato konsiderojnë terroriste, si për shembull talibanët sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1267 (1999), dhe ISIS dhe Al-Nusra Front në UNSCR 2253 (2015).

---

2 Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve (Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 17 dhjetor 1979). Gjendet në: https://treaties.un.org/doc/db/terrorism/english-18-5.pdf

3 Konventa Ndërkombëtare për shtypjen e terrorizmit (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 15 dhjetor 1997). Gjendjet në: https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-9&chapter=18&clang=_en

4 Konventën për veprat penale dhe disa akte të tjera të kryera në bordin e avionëve (14 shtator 1963). Gjendet në: https://treaties.un.org/doc/db/Terrorism/Conv1-english.pdf

Përveç kësaj, UNSCR 1566 (2004) e përshkruan qëllimin e terrorizmit si "akte kriminale, duke përshirë akte kundër civilëve të kryera me qëllim shkaktimin e vdekjeve apo dëmtimeve të rënda trupore, ose marrja peng me qëllim provokimin e një gjendjeje terrori te publiku në përgjithësi ose te një grup personash ose personash të veçantë, frikësimin e popullatës apo detyrimin e një qeverie apo një organizate ndërkombëtare që të bëjë diçka apo të tërhiqet nga kryerja e një akti, (...) që nuk justifikohen në asnjë rrethanë me arsyetime të një natyre politike, filozofike, ideologjike, raciale, etnike, fetare apo të ndonjë natyre tjetër."[5]

## Ekstremizmi i dhunshëm që çon në terrorizëm

OSBE-ja ka dalë me këtë përkufizim të EDhRÇT-së: "Radikalizimi që çon në terrorizëm është procesi dinamik, përmes të cilit një individ arrin të pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme dhe ndoshta edhe legjitime të vepruari. Në një moment të caktuar, kjo mund të çojë, por jo domosdoshmërisht, në situatën ku personi ta mbrojë terrorizmin, të veprojë në mbështetje të tij apo të përfshihet edhe vetë në terrorizëm."[6]

Përveç kësaj, disa prej shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së kanë përkufizimet e tyre të ekstremizmit të dhunshëm. Qeveria kanadeze e përshkruan atë si "besime dhe veprime të personave që e mbështesin ose që e përdorin dhunën për të arritur qëllime ideologjike, fetare apo politike ekstreme."[7]

Këshilli i Ministrave i Shqipërisë e përkufizon këtë fenomen si "përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve politike"[8] , kurse Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar i referohet ekstremizmit të dhunshëm si "mbrojtja, angazhimi, përgatitja ose mbështetja e motivuar ideologjikisht ose dhuna e justifikuar për çuarjen më tej të objektivave socialë, ekonomikë, dhe politikë."[9]

Përkufizimi i ekstremizmit të dhunshëm është një përpjekje në proces e sipër, për shkak të natyrës së ndryshueshme dhe gamës së gjerë të konteksteve, motiveve, qëllimeve dhe karakteristikave individuale dhe shoqërore. Mundet që një individ apo një ideologji e caktuar të jetë ekstremiste, por prapëseprapë jo e dhunshme. Ky është realiteti me të cilin përpiqen të jetojnë shoqëritë demokratike, sado e vështirë të jetë kjo, kur kjo përplaset në mënyrë të drejtpërdrejtë me vlerat thelbësore të demokracisë. Nëse dhuna shoqërohet me aktivitete ekstremiste, kjo

5 UNSCR 1566 (2004). Gjendet në: http://unscr.com/en/resolutions/doc/1566

6 *Parandalimi i Terrorizmit dhe Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Qasja e Policimit në Komunitet* (Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, 2014), fq. 15. Gjendet në: https://www.osce.org/secretariat/111438?download=true

7 *Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Radikalizimit ndaj Dhunës* (Qeveria e Kanadasë, Qendra Kanadeze për Angazhimin e Komunitetit dhe Parandalimin e Dhunës, 2018), fq. 7. Gjendet në: https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrcs/pblctns/ntnl-strtg-cntrng-rdclztn-vlnc/ntnl-strtg-cntrng-rdclztn-vlnc-en.pdf

8 *Strategjia Kombëtare e Shqipërisë, Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm* (Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave), fq. 5. Gjendet në: https://www.rcc.int/p-cve/download/docs/Albanian%20National%20Strategy%20on%20Countering%20Violent%20Extremism.pdf/eca873b0e6bd733938a73f957471a75c.pdf

9 *Përgjigja e Zhvillimit për Ekstremizmin e Dhunshëm dhe Kryengritjes: Vënia në praktikë e parimeve* (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar, Shtator 2011), fq.2. Gjendet në: http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pdacs400.pdf

paqartësi kapërcehet lehtësisht. Është e rëndësishme të theksohet se çfarëdolloj ideologjie ka potencialin për të prodhuar anëtarë ekstremistë të një popullate që i drejtohen dhunës. Megjithatë, kjo dëshmon faktin se ekstremizmi i dhunshëm nuk ka lidhje me asnjë ideologji apo besim të caktuar fetar.

Prandaj, ekstremizmi i dhunshëm është një kategori e caktuar, e cila është më e gjerë sesa “terrorizmi”, sepse ajo përfshin edhe dhunën, si protestat e motivuara politikisht dhe krimet e urrejtjes apo veprimet që, ndonëse konsiderohen terroriste për nga natyra nga një pjesë njerëzish, nuk përkufizohen si të tilla ligjërisht. Është e rëndësishme të theksohet se pikëpamjet radikale ose ekstremiste nuk përbëjnë domosdoshmërisht problem në vetvete. Është dhuna ajo që kur përdoret si një mënyrë e justifikueshme, përbën problem për sigurinë.

## Parandalimi dhe kundërvënia ndaj EDhRÇT-së

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm janë që të dyja shprehje që përshkruajnë mënyrat e adresimit të EDhRÇT-së. Ato përdoren shpesh në vend të njëra–tjetrës. Megjithatë, me parandalim nënkuptohet që problemet të ndalen para se ato të ndodhin. Kjo kërkon që të adresohen pikërisht kushtet që e mundësojnë EDhRÇT-në. Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm nënkupton përdorimin e strategjive dhe masave që shërbejnë për shkatërrimin e historive terroriste dhe nxitjen e alternativave të shëndetshme. Këtu mund të përfshihet edhe rehabilitimi dhe riintegrimi i ish-të dënuarve për ekstremizëm të dhunshëm.

Plani i Veprimit i vitit 2015 i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm e sheh parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si një sërë masash të gjera dhe sistematike me qëllim adresimin e shtysave që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm. Ky plan thekson “adresimin e kushteve që favorizojnë terrorizmin”, duke “respektuar në të njëjtën kohë të drejtat e njeriut për të gjithë dhe shtetin e së drejtës në kundërvënien ndaj terrorizmit. Ky plan veprimi thekson se krijimi i shoqërive të hapura, të barabarta, gjithëpërfshirëse dhe pluraliste, të bazuara në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe në mundësitë ekonomike për të gjithë, përbën alternativën më konkrete dhe me më shumë kuptim ndaj ekstremizmit të dhunshëm (...)”.[10]

Nga ana tjetër, OSBE-ja e sheh kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm si “masa proaktive për t’iu kundërvënë përpjekjeve të ekstremistëve të dhunshëm për radikalizimin, rekrutimin dhe mobilizimin e ndjekësve të tyre për t’u angazhuar në akte të dhunshme dhe për të adresuar faktorë specifikë që lehtësojnë apo që mundësojnë rekrutimin e ekstremistëve të dhunshëm dhe radikalizimin e tyre drejt dhunës”.[11]

---

10 Gjendet në: http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/70/674

11 *Roli i Shoqërisë Civile në Parandalimin dhe Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Një fokus mbi Evropën Juglindore* (OSCE, 2018) fq. 6. Gjendet në: https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true

# 2) Shprehjet, përkatësitë gjinore, ndërgjegjësimi dhe integrimi gjinor në kontekstin e parandalimit dhe kundërvënies ndaj EDhRÇT-së

**Përkatësia gjinore** i referohet atributeve dhe mundësive sociale që lidhen me të qenit mashkull apo femër, si dhe marrëdhënieve dhe dinamikave të pushteteve mes grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

Ndryshe nga seksi biologjik, këto atribute, mundësi dhe marrëdhënie ndërtohen dhe mësohen nga ana sociale gjatë gjithë proceseve të socializimit. Nuk janë statike, por të varura nga konteksti dhe koha. Përkatësia gjinore ka të bëjë me atë çka pritet, çka lejohet dhe çka vlerësohet te një grua ose një burrë në një kontekst të caktuar. Në pjesën më të madhe të shoqërive, ka dallime dhe pabarazi mes grave dhe burrave, sa u përket përgjegjësive që u caktohen, aktiviteteve që ndërmarrin, mundësive të tyre për të pasur dhe për të kontrolluar burime të caktuara, si dhe mundësive për të marrë vendime.[12]

Parimi i barazisë gjinore dhe ndalimi i diskriminimit që vjen me të janë parime themelore të të drejtave të njeriut. Nxitja e barazisë gjinore parashikohet edhe në Vendimin Parlamentar Nr. 638 të OSBE-së dhe shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar për ta bërë barazinë gjinore pjesë të pandashme të politikave të tyre.[13]

Dy strategjitë kryesore për nxitjen e barazisë gjinore dhe për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit me bazë seksin dhe gjininë janë rritja e ndërgjegjësimit gjinor dhe integrimi gjinor. Ndërgjegjësimi gjinor i referohet "mundësisë për ta parë shoqërinë nga këndvështrimi i roleve gjinore dhe për të kuptuar se si kjo ndikon te nevojat e grave krahasuar me nevojat e burrave."[14] Integrimi gjinor "përfshin integrimin e këndvështrimit gjinor në përgatitjen, projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, masave rregullatore dhe programeve buxhetore, me qëllim nxitjen e barazisë mes grave dhe burrave dhe luftën ndaj diskriminimit."[15]

Në kontekstin e EDhRÇT-së, ndërgjegjësimi gjinor dhe integrimi gjinor kontribuojnë që të dyja në marrjen e masave më të informuara dhe më konkrete për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe

---

12 http://www.un.org/womenwatch/osagi/conceptsandefinitions.htm

13 https://www.osce.org/pc/14713?download=true

14 *Aspekti gjinor i qeverisjes ekonomike* (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë – Unifem, n.d.). Gjendet në: http://www1.aucegypt.edu/src/engendering/definitions.html

15 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore. Gjendet në: https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/what-is-gender-mainstreaming

terrorizmit. Kjo i bën ato në fund më efikase. Konkretisht, kjo shtjellohet në Kapitullin II të këtij udhëzuesi. Mësime të tjera të nxjerra dhe praktikat e mira në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndjeshmërisë gjinore në punën për parandalimin/ kundërvënien ndaj EDhRÇT-së dalin në pah në rastet e studimit paraqitur në Kapitullin V.



# Kapitulli II: Pse integrim gjinor në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

## 1) EDhRÇT-ja si kërcënim ndaj sigurisë

Rajoni i OSBE-së mbetet i prekshëm nga kërcënimet ndaj sigurisë shkaktuar nga aktivitetet terroriste dhe ekstremizmi i dhunshëm. Në veçanti, aktivitetet e organizatave të ekstremistëve të dhunshëm ose format e tjera të grupeve të dhunshme në situatat e paqëndrueshmërisë së vazhdueshme dhe/ose problemeve të gjata etnike dhe sektare mbeten kërcenim i vazhdueshëm në këtë rajon. Grupet e ekstremistëve të dhunshëm që vazhdojnë të dalin në gjithë rajonin përbëjnë një burim të mundshëm mostolerance dhe dhune në rritje për shkaqe ideologjike.

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë parë një numër të madh viktimash si rrjedhojë e terrorizmit. Në vitin 2016, baza globale e të dhënave për terrorizmin pa se fushat më të mëdha të aktivitetit terrorist ishin brenda kufijve të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së: Turqia (1,047 viktima), Rusia dhe Azia Qendrore (1,395 viktima), Evropa Perëndimore (143 viktima) dhe Ballkani Perëndimor (92 viktima).[16]

16 Shih: https://www.start.umd.edu/gtd/search/Results.aspx?page=6&casualties_type=&casualties_max=&region=7&count=100&expanded=no&charttype=line&chart=overtime&ob=CountryText&od=asc#results-table

### ISIL/Daesh dhe terrorizmi i ndikuar ideologjikisht

Shumë prej akteve të terrorizmit në rajonin e OSBE-së i janë ngarkuar veçanërisht të ashtuquajturit shtet islamik i Irakut dhe Levantit (ISIL/Daesh). Në vitin 2014, ky grup doli me pretendime ndaj territorit të Sirisë dhe Irakut, si dhe me aspiratat për shtrirje globale duke rekrutuar anëtarë nga vende shumë më të largëta se rajoni dhe duke i shtyrë mbështetësit dhe ndjekësit e vet drejt dhunës në të gjithë botën.

Në kulmin e operacioneve të tij në vitin 2014 – 2015, ISIL/Daesh tërhoqi në radhët e veta afërsisht 40,000[17] të ashtuquajtur luftëtarë të huaj terroristë (LHT)[18] nga e gjithë bota. Një numër i konsiderueshëm i këtyre luftëtarëve vinin nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.[19] Mendohet se numri i LHT-ve nga vendet e ish-Bashkimit Sovjetik mund të ketë arritur në 9,000 luftëtarë,[20] më shumë se 1,000 LHT nga Kaukazi i Jugut dhe më shumë se 4,000 luftëtarë nga vendet e Azisë Qendrore. Përveç kësaj, pothuajse 6,000 evropiano-perëndimorë dhe më shumë se 400 amerikano-veriorë llogariten të jenë bërë pjesë e ISIL/ Daesh në Irak dhe Siri. [21]

Nga këta LHT dhe individë të lidhur me LHT-të, gratë përbënin një pjesë të konsiderueshme. Sipas një studimi të vitit 2018 të ndërmarrë nga Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit, gratë përbënin 13% të LHT-ve të ISIL/Daesh ose forcave të lidhura me to dhe mesatarisht 17% të 20,000 LHT-ve që vinin nga rajoni i OSBE-së.[22]

Në bazë të të dhënave të viteve 2014-2015, rreth një mijë gra nga Azia Qendrore kanë qenë të pranishme në zonat e luftës ISIL/Daesh.[23] Sipas statistikave të mbledhura nga institucionet shtetërore të Azisë Qendrore, në radhët e ISIL/ Daesh kishte mbi 150 gra kazake,[24] 200 taxhike dhe deri 500 gra uzbeke[25]. Studimet tregojnë se gratë në Kirgistan përbëjnë 1/4 e grave që largohen nga vendi për t'u bashkuar me ISIL/Daesh. [26]

---

17 *Sfida e Kthimit dhe Rivendosjes së Luftëtarëve të Huaj të Kthyer: Perspektivat e studimit* (Drejtoria Ekzekutive e Komitetit Për Luftën Kundër Terrorizmit e Kombeve të Bashkuara, 2018), fq. 4.

18 Sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara 2178, luftëtarët e huaj terroristë përkufizohen si individë që udhëtojnë në një shtet, të ndryshëm nga shteti i tyre i banimit ose i kombësisë për qëllime kryerje, planifikimi apo përgatitjeje ose pjesëmarrjeje në akte terroriste ose ofrimi apo marrje e trajnimeve terroriste, duke përfshirë lidhjen me konfliktet e armatosura. Shih S/RES/2178 (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, 2014).

19 Richard Barrett, *Përtej Kalifatit: Luftëtarët e huaj dhe Kërcënimi i të Rikthyerve* (Qendra Soufan, 2017), fq. 12-13.

20 Po aty., fq. 10.

21 Richard Barrett, *Përtej Kalifatit: Luftëtarët e huaj dhe Kërcënimi i të Rikthyerve* (Qendra Soufan, 2017), fq. 12-13.

22 Joana Cook dhe Gina Vale, Nga Daesh në *"Diasporë: Gjurmimi i Grave dhe të Miturve të Shtetit Islamik* (Kolegji King, Londër: Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit, 2018), fq. 3-14.

23 Uran Botobekov, "Gratë e Azisë Qendrore në vijën e parë të xhihadit" (*The Diplomat*, janar 2017).

24 "Shërbimi i inteligjencës i Kazakistanit: 150 gra kazake janë anëtare të IS" (Radioja Evropa e Lirë/Radio Liria, nëntor 2014).

25 "Uzbekistani në vështirësi me gratë e rekrutuara nga ISIS (*Antiterror Today*, qershor 2015).

26 Mataeva, A. "Radikalizimi" dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në in Kirgizistan. Gazeta RUSI. Vol. 163, 2018, Botimi 1. fq. 30–46. fq. 34

Tabela 1. **Llogaritjet mediatike dhe analitike të luftëtarëve të huaj dhe emigrantëve të Shtetit Islamik nga Ballkani Perëndimor.**

| | Gjithsej | Gra |
|---|---|---|
| Shqipëria | 90-150 | 13-29 |
| Bosnje-Hercegovina | 192-340 | 36 |
| Kroacia | 1-6 | 1-4 |
| Kosova[27] | 100-232 | 42 |
| Maqedonia | 12-146 | 1 |
| Mali i Zi | 13-30 | Nuk ka |
| Serbia | 50-350 | 1 |

*Burimi: Qendra e Beogradit për Politikat e Sigurisë, Beograd 2016*

Ndonëse numri i LHT-ve gra që vinin nga Evropa Juglindore ka qenë ndjeshëm më i ulët (shih tabelën 1), këto shifra duhen parë në krahasim me popullatën totale të këtyre vendeve, të cilat në disa raste janë më të uléta se sa vendet e tjera të rajonit.[27]

Mes evropianëve perëndimorë, Qendra Ndërkombëtarë për Studimin e Radikalzimit vlerëson se gratë përbënin 1023 të personave të lidhur me ISIS/Daesh që kanë udhëtuar për në Irak dhe Siri ose 17% të totalit siç thuhet më sipër.[28] Në vitin 2016, gratë përbënin 36% të "kontigjentit"[29] francez në ISIL/ Daesh, 40% nga Holanda dhe 20% të atyre që udhëtonin nga Gjermania dhe Finlanda.[30]

Vitet e fundit, rajoni i OSBE-së ka parë një rënie të terrorizmit, por ai vazhdon të mbetet kërcënim për shtetet pjesëmarrëse. Ndonëse i gjithë rajoni i OSBE-së ka parë një ulje të qartë të numrit të akteve terroriste vdekjeprurëse të kryera në vitin 2017 krahasuar me një vit më parë, ka pasur gjithsesi 61 viktima në Evropën Perëndimore, 57 në Turqi dhe 16 në Rusi dhe në Azinë Qendrore.[31] Rënia e numrave mendohet se vjen kryesisht për shkak të humbjeve të territorit nga ISIL/Daesh në Irak dhe në Siri dhe uljes së numrit të rekrutimeve.

Si rrjedhojë e këtyre humbjeve territoriale, numri i LHT-ve që nuk kthehen nga Iraku dhe Siria në vendet e tyre apo në vendet e palëve të treta është rritur në shumë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së.[32] Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit ka regjistruar 7,366 individë që kanë pasur lidhje me ISIL/Daesh dhe që janë kthyer nga Iraku dhe Siria në vendet e tyre (20% në vitin 2018) ose që duket se janë në proces kthimi. Në nivel global, ka pasur vetëm 256 (4%) gra nga numri total i të kthyerve. Prej tyre, 17% janë të mitura, të cilat përbejnë një sërë

---

27 Të gjitha referencat në këtë tekst për Kosovën, qofshin ato për territorin, institucionet apo popullatën duhen kuptuar në përputhshmëri të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të OKB-së 1244.

28 Joana Cook dhe Gina Vale, Nga Daesh në *"Diasporë: Gjurmimi i Grave dhe të Miturve të Shtetit Islamik (Kolegji King, Londër: Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit, 2018)*, fq. 14.

29 *Luftëtarët e huaj terroristë: Tendencat, Dinamikat dhe Përgjigjet e Politikave* (Qendra Ndërkombëtare për Luftën Kundër Terrorizmit, 2016).

30 *Raporti për situatën dhe tendencat e terrorizmit në Bashkimin Evropian 2016* (EUROPOL, 2016), fq. 29.

31 Baza e të dhënave të Sulmeve Terroriste, Janar 01, 31 dhjetor 2017, 2017 (ESRI, 2017). Gjendet në: https://storymaps.esri.com/stories/terrorist-attacks/?year=2017.

32 S/2017/35 – *Raporti i nëntëmbëdhjetë i Mbështetjes Analitike dhe Ekipit të Monitorimit të Sanksioneve të dorëzuar në përputhje me rezolutën 2253 (2015) për ISIL (Da'esh), Al-Kaeda dhe individët e subjektet e lidhura* (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, 2017), paragrafi 9.

sfidash për shtetet ku kthehen, sidomos për sistemet e drejtësisë penale.[33] Nga të kthyerit në Evropën Perëndimore dhe Lindore, gratë përbëjnë përkatësisht 8 dhe 5%. [34] Raportet tregojnë se shumë prej grave dhe fëmijëve që janë ende në Siri dhe në Irak janë në kampe të mbushura me djem dhe vajza të luftëtarëve të ISIL/Daesh, qofshin ata të vdekur, të burgosur apo të arratisur.[35] Lirimi i tyre kushtëzohet me vendime politike që kanë të bëjnë me riatdhesimin nga vendet e tyre.

Fati i të kthyerve të lidhur me ISIL/Daesh ka ndryshuar ndjeshëm. Disa, si meshkuj ashtu edhe femra, janë marrë në sistemet përkatëse të drejtësisë penale të vendeve ku janë kthyer dhe janë përballur me përgjegjësinë për ndihmën që i kanë dhënë organizatave të dhunshme ekstremiste ose për pjesëmarrjen në të.

Disa të kthyer duket se e kanë braktisur ideologjinë e dhunshme ekstremiste për arsye të ndryshme, duke përfshirë zhgënjimin nga premtimet që i çuan drejt bashkimit me ISIL/Daesh. Për disa të tjerë, kthimi në vendin e tyre apo në vende të tjera të treta nuk ka qenë njëlloj me rehabilitimin apo braktisjen e arsyeve që i ka kanë çuar fillimisht drejt vendeve të luftës. Këta persona mund të vazhdojnë të përbëjnë një kërcënim real ndaj sigurisë së këtyre vendeve. [36] Kështu për shembull, ka qenë rasti i Rachid Kassim, një LHT francez dhe rekrutues i ISIL/Daesh, i cili ka mbështetur një sërë sulmesh dhe tentativash për sulme në Francë.[37] Në fakt jo të gjitha qeveritë e OSBE-së kanë “kërkuar kthimin” e shtetasve të tyre, duke pasur frikë se ata mund të përhapin ideologjinë e dhunshme edhe në vendet e veta.

Ndonëse LHT-të që po kthehen dhe rrjetet e terroristëve të huaj vazhdojnë të përbëjnë një kërcënim sa i përket dhunës së mundshme dhe frymëzimit të personave të tjerë, shumica e sulmeve të frymëzuara nga ISIL/Daesh në vitin 2017 janë kryer nga të ashtuquajturit terroristë vendas, që janë radikalizuar në vendet e tyre ku jetojnë dhe që nuk kanë udhëtuar asnjëherë jashtë shtetit për t’u bërë pjesë e një grupi terrorist. Kjo bie shpesh ndesh me atë çka besojnë njerëzit, sidomos me atë çka prezantohet nga forca të caktuara politike polarizuese. Janë pikërisht këta aktorë të vetmuar, persona që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me ISIL/Daesh apo me çfarëdo lloj organizate tjetër terroriste që mund të përbëjnë një nga kërcënimet më të vështira për t’u zbuluar nga forcat e zbatimit të ligjit.[38]

---

33 Joana Cook dhe Gina Vale, Nga Daesh në *“Diasporë: Gjurmimi i Grave dhe të Miturve të Shtetit Islamik (Kolegji King, Londër: Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit, 2018)*, fq. 3.

34 Po aty, fq. 15.

35 Arutunyan, *Të kthyerit e ISIS sjellin shpresë dhe frikë në Çeçeni* (Grupi i krizës ndërkombëtare, 2018).

36 Byman, *Çfarë ndodh kur ISIS vepron sekret?* (Institucioni Brookings, 2018).

37 S/2017/573 – *Raporti i dymbëdhjetë i Mbështetjes Analitike dhe Ekipit të Monitorimit të Sanksioneve të dorëzuar në përputhje me rezolutën 2253 (2015) për ISIL (Da’esh), AlKaeda dhe individët e subjektet e lidhura (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, 2017)*, paragrafi. 6.

38 *Raporti për situatën dhe tendencat e terrorizmit në Bashkimin Evropian 2016 (EUROPOL, 2016)*, fq. 6.

Megjithatë, është e rëndësishme të mos harrohet se ndonëse ISIL/Daesh ka humbur territore fizike, thirrjet e tyre ideologjike janë ende të pranishme. Përveç kësaj, ndonëse vetëm 16% e sulmeve apo e tentativave për sulme në Bashkimin Evropian në vitin 2017 kanë qenë të frymëzuara nga ISIL/Daesh, ato përbënin numrin më të madh të viktimave.[39] Sulmet aktuale që merren përsipër nga ky grup pas humbjeve të mëdha të territoreve tregojnë se ky grup mund të tërheqë ende mbështetje dhe të vazhdojë operacionet. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se ideologjitë vazhdojnë të mbijetojnë edhe pasi të mos ekzistojnë më krijuesit e tyre. Kështu, fuqia e zjarrit ushtarak nuk mund të jetë e vetmja armë që përdoret për t'iu kundërvënë dhunës me motive ideologjike. Ndonëse mobilizimi i forcave të sigurisë dhe qasjeve ushtarake mund të adresojnë simptomat e EDhRÇT-së, ato nuk zhdukin shkaqet kryesore. Në fakt, qasjet parandaluese efikase kërkojnë që të merren parasysh faktorët që çojnë në pranimin nga djemtë dhe vajzat të dhunës si një rrugë për një qëllim të caktuar.

## Terrorizmi i të djathtës dhe së majtës ekstreme

Klima e ndryshueshme politike në shumë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së ka rritur shqetësimet për kërcënimet ndaj sigurisë që vijnë nga forma të ndryshme të lëvizjeve ekstremiste të dhunshme të ndryshme nga ato që frymëzohen nga ISIL/Daesh ose që lidhen me to dhe me grupe të tjera me ideologji të ngjashme.

Në të gjitha Shtetet e Bashkuara, Evropë e më tej, po përhapen retorika polarizuese nga lëvizje që janë gjithmonë e më shumë ksenofobe. Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në fushën e Zbatimit të Ligjit (Europol) konstaton se kjo i ka hedhur benzinë "spektrit të së djathtës së dhunshme ekstremiste".[40] Për shkak të rritjes së numrit të emigrantëve nga zonat e konfliktit jashtë zonës së OSBE-së, është rritur gjithmonë e më shumë tërheqja nga kjo lloj retorike, sidomos kur prezantohet në paketa politikash populiste.

Sulmet nga grupet dhe personat e frymëzuar nga ISIL/Daesh në të gjithë botën e kanë rritur edhe më shumë frikën e publikut, siç ka ndodhur edhe me nocionin që kriza e refugjatëve dhe emigrantëve përbën një kërcënim urgjent ndaj sigurisë. Për shembull, partitë politike që pretendojnë se emigrantët shfrytëzojnë sistemin evropian të mirëqenies,[41] që cenojnë mënyrën evropiane të jetesës,[42] apo që përbëjnë një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë për popullatat lokale[43] kanë mbizotëruar në kutitë e votimit në vende të ndryshme. Edhe në Shtetet e Bashkuara, e djathta e dhunshme esktremiste duket se është në rritje.[44]

---

39 Po aty, fq.9.

40 Po aty, fq. 7.

41 Cf. McKie, "Ekstremisti i djathtë Geert Wilders i quan emigrantët marokenët 'plehra'", (*The Guardian,* Shkurt 2017); dhe Warren, "Marine Le Pen e quan imigrimin "KËRCËNIM" për vlerat franceze", (*Express*, Mars 2018).

42 Dearden, "Ndalimi i burkave të plazhit: Pse po i arreston Franca gratë myslimane për veshje të kostumeve të banjos që mbulojnë të gjithë trupin dhe pse janë njerëzit kaq të acaruar?" (*Independent*, prill 2016).

43 Për shembull, sulmi në Berlin në tregun e Krishtlindjeve në vitin 2016 u krye nga një kërkues për azil.

44 Seth G. Jones, *Ngritja e të djathtës ekstremiste në Shtete e Bashkuara* (Qendra për Studimet Strategjike dhe Ndërkombëtare, 2018). Shih gjithashtu: http://time.com/5249811/neo-nazis-burn-swastika-georgia/

Gjithashtu, edhe lëvizjet nacionaliste, duke përfshirë edhe ato të dhunshme, po fitojnë mbështetje masive, diçka që nuk është parë në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore. Vitet e fundit, ndarje gjithmonë e më të thella kanë dalë në sipërfaqe në shoqëri të ndryshme në të gjithë zonën e OSBE-së, duke përfshirë shpesh një gjuhë urrejtjeje dhe dhunë ekstremiste ndaj emigrantëve dhe ndaj pakicave etnike, kombëtare ose fetare. Në disa raste, retorikat polarizuese dhe politikat e identiteteve janë provokuar ose janë përqafuar heshturazi nga partitë kryesore politike.

Kjo prirje e re i ka dhënë një shtysë ridaljes në sipërfaqe të grupeve të dhunshme ekstremiste pas dekadash të tëra që ata perceptoheshin si lëvizje të parëndësishme periferike. Ata tashmë po tërheqin më shumë ndjekës dhe po dalin më hapur mbi motivet dhe qëllimet e tyre ideologjike.[45] Shkalla e përhapjes së mendësive të dhunshme ekstremiste mund të shihet nga pjesëmarrja e shtuar në aktivitete si koncerte muzikore dhe tubime të organizuara nga këto lloj grupesh. Për shembull, një tubim nacionalist i organizuar në Varshavë nga Oboz Narov Doradikalni (kampi radikalist nacionalist) në ditën e pavarësisë së Polonisë në vitin 2017, është ndjekur, siç raportohet, nga 60,000 pjesëmarrës nga e gjithë Evropa. Ky tubim u ndalua në vitin 2018.[46]

Ndonëse ekstremizmi i dhunshëm i djathtë është parë tradicionalisht si problem mes të rinjve, edhe gratë luajnë rol kryesor në këto lëvizje. Në lëvizjet e djathta ekstreme, gratë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë anëtare dhe mbështetëse aktive. Megjithatë, ato janë më pak publike në aktivitetet e tyre, kështu që numri i tyre është më i vështirë për t'u përcaktuar. Kjo kërkon studimet e veta të fokusuara tek aspekti gjinor.

Një studim për pjesëmarrjen e grave në grupet neonaziste dhe në forma të tjera grupesh ekstremiste të djathta, është konstatuar se ka një rritje të "numrit të grave të djathta ekstremiste aktive, si dhe një rritje të numrit të grupeve të grave në skenën e ekstremistëve të djathtë. Edhe rolet dhe pozicionet që mund të marrin gratë në këtë lëvizje janë zgjeruar: nga aktiviste, luftëtare në rrugë dhe drejtuese bandash deri në politikane të qeverisë vendore dhe nga koordinatore demonstrimesh deri në aktiviste në internet."[47] Kjo pasqyron edhe studime të tjera të shkruara mbi këtë temë.[48]

Përveç kësaj, terrorizmi i majtë mbetet një kërcënim i vazhdueshëm në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Europol ka konstatuar se në vitin 2017, 12% e sulmeve të dështuara, të tentuara dhe të realizuara në Bashkimin Evropian ishin për nga natyra të majta.[49] Në Bashkimin Evropian, në vitin 2017 u pa një rritje e lehtë krahasuar me një vit më parë në arrestimin e të dyshuarve për të majtë

---

45 Shih për shembull: Gray, "Neonazistët dogjën një Svastika pas garës së tyre në Gjeorgji" (*TIME,* Prill 2018).

46 "Ndalohet marshimi i nacionalistëve në ditën e pavarësisë së Polonisë në Varshavë" (*BBC News*, nëntor 2018).

47 Të nënvlerësuar dhe të shpërfillur: Gratë në Grupet e së Djathtës Ekstremiste (Fondacioni Amadeu Antonio), fq. 3.

48 Claire Provost dhe Lara Whyte, "Pse po u bashkohen gratë lëvizjeve të së djathtës ekstremiste dhe pse jemi kaq të surprizuar?" (OpenDemocracy.net, Janar 2018).

49 *Raporti për situatën dhe tendencat e terrorizmit në Bashkimin Evropian 2016* (EUROPOL, 2018), fq. 9.

terroristë.[50] Ky lloj terrorizmi ka më shpesh në shënjestër ndërtesat qeveritare dhe çon në më shumë konflikte civile sesa dhuna ndaj individëve dhe grupeve.

### Faktorët potencialë që favorizojnë EDhRÇT-në

Qeveritë, së bashku me aktorët e shoqërisë civile, duhet të marrin masa konkrete për të frenuar atë çka i shtyn individët të ndërmarrin udhëtime për në fusha të huaja beteje apo për të kryer akte terroriste në vendin e tyre. Kjo përfshin adresimin e mënyrave se si përdoren pikat e dobëta, shpesh me specifika gjinore nga organizatat e dhunshme ekstremiste për të provokuar të rinj dhe të reja që të bëhen pjesë e grupeve të tyre.

Thuhet se nuk ekziston një rrugë e vetme drejt radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm.[51] Prandaj edhe çdo rast i EDhRÇT-së duhet parë si rrjedhojë e një kombinimi unik të trajektores dhe psikologjisë personale të një individi të caktuar dhe mjedisit (ndoshta favorizues), ku jeton individi. Rrjeti i Komisionit Evropian për Ndërgjegjësimin rreth Radikalizimit (RAN) i ka organizuar faktorët që çojnë drejt EDhRÇT-së në këto grupe:

- **Faktorë social-psikologjikë individualë**: Këta faktorë përfshijnë shqetësimet dhe emocionet, si tjetërsimin dhe përjashtimin; zemërimin dhe frustrimin; ndjenjën e fortë të padrejtësisë; ndjenjën e poshtërimit; pikëpamjet strikte mbi botën; tendencat për të keqinterpretuar situatat; teoritë konspirative; ndjesinë e të qenit viktimë; pikat e dobëta personale; si dhe/ose jetesën në kundërshtim me normat kulturore kryesore.

- **Faktorë socialë:** Këtu përfshihen faktorët që lidhen me përjashtimin social, stigmatizimin, marxhinalizimin dhe diskriminimin (realë ose të perceptuar); lëvizjet e kufizuara sociale; mundësitë e kufizuara për arsim dhe punësim; elementët e zhvendosjes fizike; kriminaliteti dhe/ose mungesa e kohezionit social dhe vetëpërjashtimi.

- **Faktorët politikë**: Këtu përfshihen problemet që lidhen me viktimizimin si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të qeverisë, duke përfshirë shkeljen e të drejtave të njeriut. Këta faktorë shoqërohen me një ndjesi të fortë tjetërsimi dhe padrejtësie, për shembull, nga ndjesia e të mosqenit të përfaqësuar nga lidershipi politik apo policia, përforcuar shpesh nga ksenofobia, diskriminimi dhe marxhinalizimi.

50 Në të njëjtin burim fq. 48.

51 *Dokumenti i Diskutimit | Shkaqet Bazë të Radikalizimit në Evropë dhe Komonuelthi i Shteteve të Pavarura* (Programi për Zhvillim i OKB-së, 2016).

- **Dimensionet ideologjike dhe "fetare":** Këtu përfshihet anëtarësimi në grupe të dhunshme ekstremiste për shkak të besimit te një detyrë e shenjtë, një mision historik, apo një profeci apolitike dhe/ose si mënyrë për arritjen e hakmarrjes apo shpërblimit. Disa norma fetare mund të ndikojnë te mënyra se si i shohin rolet e tyre burrat dhe gratë në shoqëri dhe në strukturën familjare, gjë që mundet gjithashtu të ketë ndikim.

- **Kriza e kulturës dhe identitetit:** Kjo lidhet me marxhinalizimin kulturor që mund të prodhojë tjetërsimin e shoqërive. Për shembull, emigrantëve të brezit të dytë në Evropën Perëndimore u mungon ndonjëherë ndjesia e përkatësisë, duke mos u ndjerë as pjesë e "shtëpisë" së re dhe as pjesë e vendit që kanë lënë pas prindërit e tyre.

- **Trauma dhe mekanizmat e tjerë nxitës:** Këtu përfshihen traumat psikologjike. Ato mund të përjetohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nga prindërit që kanë çrregullime stresi post-traumatike ose probleme të tjera psikologjike komplekse.

- **Dinamikat e grupit:** Këtu përfshihen aspekte si admirimi i një lideri karizmatik; miqësitë e mëparshme apo lidhjet familjare; socializimi; vetëizolimi; elementë të sjelljeve polarizuese dhe kundër-kulturore; përpjekjet për një ndjesi përkatësie që nuk gjendet në shoqërinë kryesore; ose shoqërimi me persona të tjerë që kanë nevoja dhe kërkesa të ngjashme. Për shembull, burrat e interesuar për të pasur dhe për të përdorur armë janë ndonjëherë të prirur të bëhen pjesë e grupeve ushtarake. Një studim ka konstatuar se "ekstremizmi rritet pjesërisht në rastet kur anëtarësimi në një grup përforcon idealet që një person i ka pasur më parë dhe kur identiteti i individit shkrihet me atë të grupit".

- **Të radikalizuarit:** Këtu përfshihet ekspozimi ndaj atyre që predikojnë urrejtjen dhe atyre që përfitojnë nga dobësitë dhe problemet e njerëzve, mobilizimi i personave që rekrutohen në EDhRÇT përmes metodave si bindja, presioni dhe manipulimi.

- **Mediat sociale:** Këtu përfshihet komunikimi mes njerëzve, pjesëmarrja virtuale dhe dhomat e *chat*-it për pikëpamjet e ngjashme ekstremiste. Interneti mund ta përshpejtojë procesin e radikalizimit dhe të rrisë mundësitë e "vetëradikalizimit". [52]

Nuk ka një rrugë të qartë drejt terrorizmit dhe as ndonjë grup konsistent faktorësh që çojnë në EDhRÇT. Çdo rast i EDhRÇT-së vjen nga një kombinim unik faktorësh individualë. Studimet e ndërmarra nga Qendra Ndërkombëtare

52 *RAN Issue Paper: Shkaqet bazë të ekstremizmit të dhunshëm* (Ranstorp, Rrjeti për Ndërgjegjësimin Kundër Radikalizimit, Komisioni Evropian, 2016).

e Antiterrorizmit[53], Zyra e OKB-së për Antiterrorizmin,[54] dhe Këshilli i Evropës[55] kanë përcaktuar një sërë arsyesh që çojnë drejt EDhRÇT-së, siç përmendet nga LHT-të (si meshkuj, ashtu edhe femra) nga rajoni i OSBE-së. Këtu përfshiheshin:

- Të ndjerit të vetmuar dhe të izoluar, duke përfshirë edhe konfuzionin dhe ndjesinë e qenit të pasigurt nëse i përkasin rrymës kryesore apo strukturave të komunitetit, një situatë e përjetuar shpesh nga emigrantët e brezit të dytë në vendet ku kanë emigruar prindërit e tyre në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut; popullatat e shumicës që janë përballur me një fluks në rritje emigrantësh dhe refugjatët. Emigrantët e Azisë Qendrore që vuajnë nga diskriminimi në Rusi dhe Turqi; shoqëritë konservatore në vende të caktuara ku kufizohet pavarësia financiare, lëvizja e grave; si dhe shoqëritë liberale me më shumë barazi gjinore, ku burrat ndihen të frikësuar nga pavarësia e grave, sic e tregon lëvizja e "beqarisë së pavullnetshme" (lëvizja Incel) .[56]

- Besimi se komuniteti është i rrezikuar nga dhuna apo përndjekja, ku përfshihet ksenofobia dhe profilizimi i popullatës myslimane në Evropë dhe në Amerikën e Veriut, ose perceptimi i kërcënimeve ndaj sigurisë dhe ndaj mënyrës lokale të jetesës që përjetohet kur emigrantë të kulturave dhe formimeve të ndryshme fetare vendosen në qytetet evropiane. Të tilla ide janë shprehur në një manifest me titull "2083: Deklarata Evropiane e Pavarësisë" nga Anders Breivik, autori i sulmeve terroriste 2011 në Norvegji.

- Shqetësimet në lidhje me persekutimin dhe ndjekjen penale nga shërbimet shtetërore dhe/ose aksesi i pabarabartë në to. Këtu mund të përfshihet profilizimi i të dyshuarve për terrorizëm nga forcat e zbatimit të ligjit në bazë të etnisë së tyre pas sulmeve terroriste në Evropë dhe në Amerikën e Veriut; abuzimet me të drejtat e njeriut nga forcat e zbatimit të ligjit; ose perceptimi se gratë dhe burrat nuk kanë të njëjtin akses në drejtësi dhe nuk gëzojnë të njëjtën siguri.

- Zemërimi me mosveprimin e shtetit në nivel ndërkombëtar, si për shembull frustrimi me mosveprimin në shkallë ndërkombëtare në përgjigje të ndjekjeve ndaj myslimanëve apo frustrimi në lidhje me vendimet zyrtare për pranimin nga BE-ja të kuotave të emigrantëve në Evropën Lindore.

---

53 Boutin et al., *Fenomeni i luftëtarëve të huaj në Bashkimin Evropian: Profilet, Kërcënimet dhe Politikat* (Hagë: Qendra Ndërkombëtare për Luftën kundër Terrorizmit, 2016).

54 el-Said dhe Barrett, *Përmirësimi i Kuptimit të Fenomenit të Luftëtarëve të huaj Terroristë në Siri* (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Terrorizmit 2017).

55 Komiteti i Ekspertëve për Terrorizmin, *Rolet e Grave në Daesh: Dokumenti i diskutimit* (Këshilli i Evropës, 2016).

56 "Beqaria e pavullnetshme", e njohur ndryshe si "Incel", i referohet burrave që besojnë se për arsye përtej kontrollit të tyre janë të destinuar të rrinë beqarë. Incel-ët fajësojnë gratë për paaftësinë e tyre për të gjetur partnerë seksualë, gjë që lidhet me ndjenjat e vetë-urrejtjes, vetë-vlerësimit të ulët dhe zemërimit të drejtuar kundër të tjerëve.

Në faktorët e mësipërm përfshihen edhe elementet e eksperiencave të një jete negative, si dhe kushtet social-ekonomike. Ato kontribuojnë në "shtyrjen" e burrave dhe grave drejt ideologjive ekstremiste.

## 2) Parandalimi efikas dhe masat e marra

Kompleksiteti i faktorëve që favorizojnë EDhRÇT-në tregon se sa e nevojshme është që të ketë strategji gjithëpërfshirëse parandaluese, strategji të hartuara në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me standardet e të drejtave të njeriut. Në hartimin e strategjive të tilla, përfshihen shumë fusha si: siguria, mirëqeverisja, parandalimi i konflikteve, edukimi, zhvillimi social-ekonomik, angazhimi i të rinjve dhe komunikimi.[57]

Duke qenë se faktorët që çojnë drejt EDhRÇT-së, apo që krijojnë kushtet e përshtatshme për EDhRÇT, nuk kanë të njëjtin ndikim te burrat dhe djemtë, ashtu sikurse te gratë dhe vajzat (shih Kapitullin 3, seksioni 1, më poshtë), që ato të jenë efikase dhe të qëndrueshme, është gjithashtu shumë e rëndësishme që në këto strategji për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së të përfshihet edhe një analizë e fortë gjinore dhe të ketë një ndërgjegjësim të plotë gjinor. Këto strategji mund të hartohen në një mënyrë të tillë specifike që reflekton nevojat social-ekonomike, kulturore dhe politike të të gjithë shoqërisë, duke marrë parasysh edhe ekzistencën e shumë dallimeve gjinore.

Për të adresuar morinë e faktorëve që çojnë drejt EDhRÇT-së, metodat që kanë si synim parandalimin dhe kundërvënien ndaj saj duhet të fokusohen te krijimi i shoqërive gjithëpërfshirëse dhe tolerante. Nismat e ndërmarra nga qeveritë, OSHC-të dhe organizatat ndërkombëtare mund t'i mbështesin shoqëritë gjithëpërfshirëse përmes forcimit të një pjesëmarrjeje të gjerë në proceset politike dhe/ose proceset në lidhje me paqen dhe sigurinë, si dhe përmes adresimit të marxhinalizimit dhe diskriminimit.

Efikase mund të jenë gjithashtu edhe fushatat me ndjeshmëri gjinore dhe fushatat e përshtatura të ndërgjegjësimit për burrat dhe gratë e rrezikuara nga EDhRÇT-ja, fushata që i informojnë ata për dimensionet e ndryshme të propagandës ekstremiste. Për ta kuptuar EDhRÇT-në dhe për t'iu përgjigjur si duhet nevojave të atyre që ndihen të cenuar në një shoqëri, aspekte që mund të ndikojnë te parandalimi, është e rëndësishme të ndërtohet dhe të forcohet dialogu me përfaqësuesit e të rinjve, drejtuesit fetarë, grupet e grave, punonjësit socialë, edukuesit, prindërit, personat që nuk janë pjesë të asnjë organizate formale dhe forcave të zbatimit të ligjit.

Përfundimisht, qasjet parandaluese efikase kërkojnë përfshirjen e një numri të madh aktorësh, duke përfshirë shtetin (strukturat qeveritare, ofruesit e

57 *Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm* (Sesioni i shtatëmbëdhjetë i Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, A/70/674).

shërbimeve), shoqërinë civile (punonjësit socialë dhe punonjësit e vijës së parë, edukatorët dhe mentorët), familjet dhe bashkëmoshatarët në komunitet, sektorin privat (duke përfshirë ofruesit e internetit/komunikimeve dhe bizneset lokale). Futja e programeve të policimit në komunitet, ku oficerët e policisë, si meshkuj dhe femra, angazhohen në një dialog me komunitetet për çështjet lokale, mund të ndihmojë në identifikimin e pikave të nxehta të radikalizimit, në ndjekjen e tendencave lokale, si dhe në plotësimin e hendekut mes shtetit dhe qytetarëve për të ndihmuar në diktimin dhe parandalimin e krimit dhe dhunës, duke përfshirë edhe ekstremizmin e dhunshëm.

Pjesa e shtetit që komunitetet shohin dhe ndërveprojnë shpesh më shumë janë forcat e zbatimit të ligjit. Në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, forcat e zbatimit të ligjit luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm. Shqetësimet që vijnë për shkak të abuzimeve nga forcat e zbatimit të ligjit apo, më gjerësisht, abuzimet nga sektorë të caktuar të sigurisë apo korrupsioni institucional mund të krijojnë kushte që favorizojnë parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Kjo e pengon sektorin e sigurisë për të qenë efikas në parandalimin dhe kundërvënien ndaj këtij kërcënimi.

Nëse komunitete të caktuara, sidomos popullatat e marxhinalizuara, diskriminohen, shihen si stereotipe apo keqtrajtohen nga forcat e zbatimit të ligjit, lufta ndaj EDhRÇT-së sjell rezultate të kundërta me ato që dëshirohen. Nëse policia nuk arrin të fitojë besimin e *të gjithë* popullsisë, anëtarët e grupeve dhe komuniteteve në pakicë mund të vuajnë diskriminimin *de facto,* ku ata trajtohen jo në mënyrë favorizuese, thjesht dhe vetëm për shkak të faktorëve si raca, gjinia, mosha, aftësitë e kufizuara apo origjina etnike.[58]

Një sërë studimesh dhe vlerësimesh shkencore nxjerrin në pah ndikimin që kanë eksperiencat negative me forcat e zbatimit të ligjit, që çojnë në aftësinë apo paaftësinë e oficerëve të policisë për t'iu kundërvënë kërcënimeve ndaj sigurisë.[59] Një vlerësim i vitit 2009 i faktorëve që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm, përgatitur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, konstatoi se trajtimet brutale dhe degraduese të policisë përbëjnë një shtysë të tërthortë drejt EDhRÇT-së.[60]

Ndonëse është jetësore që forcat e zbatimit të ligjit, sidomos policia lokale, të luajnë një rol aktiv në parandalimin e EDhRÇT-së, shteti duhet gjithashtu të marrë masat për të garantuar llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e veprimeve të policisë. Forcat e zbatimit të ligjit duhet që në procesin e identifikimit dhe adresimit të EDhRÇT-së të marrin masa që veprimet e tyre të mos e nxisin edhe më shumë këtë fenomen.

58 Manuali për ligjin evropian të mosdiskriminimit– botimi i vitit 2018 (Agjencia e Bashkimit Evropian për Agjencinë e të Drejtave Themelore, 2018).

59 Shih, për shembull, ato të nënvizuara tek: Peters dhe Saeed, *Promovimi i kuadrove të politikave gjithëpërfshirëse për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm: Lidhja e Teorisë dhe Praktikës: Rasti studimor i një policeje grua në Pakistan* (Instituti i Georgetown për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe Siguria gjithëpërfshirëse, 2017), fq. 6-7.

60 Denoeux dhe Carter, *Udhëzues për Drejtuesit e Ekstremizmit të Dhunshëm* (Management Systems International, Agjencia e SHBA-së për Zhvillimin Ndërkombëtar, 2009), fq. 31.

Garantimi i një policie të larmishme dhe që përfaqëson popullatën vendase e bën atë të besueshme. Përbërja gjithëpërfshirëse e policisë, duke përfshirë edhe të pasurit e grave dhe burrave me uniforma që përfaqësojnë popullata të ndryshme fetare, etnike, apo raciale që janë në minoritet, mund të ndihmojë në krijimin e besimit mes forcave të zbatimit ligjit dhe komuniteteve. Duket se forcat më gjithëpërfshirëse të policisë mund t'i adresojnë më mirë shqetësimet e popullatës në raport me forcat e zbatimit të ligjit, duke pakësuar kështu kushtet e favorshme për EDhRÇT. Megjithatë, nëse forcat e zbatimit të ligjit nuk e kanë këtë diversitet dhe këtë përfaqësim të shoqërive të tyre, ky mund të jetë një faktor që nuk i lejon ato të jenë efikase.

Siç do të diskutohet në mënyrë më të hollësishme në Kapitullin 4, një komponent kyç i krijimit të forcave gjithëpërfshirëse të policisë është marrja e masave që gratë të jenë të përfaqësuara si duhet. Përfshirja e grave në forcat e zbatimit të ligjit, sidomos në pozicione drejtuese, garanton që këto forca ta përfaqësojnë popullatën që kanë për detyrë të mbrojnë. Studimet tregojnë se kjo përfshirje i bën më të afta këto forca për të arritur te komunitetet e marxhinalizuara dhe për të fituar besimin e tyre.[61] Personat e rrezikuar nga EDhRÇT-ja, burrat dhe gratë "e rrezikuar nga radikalizimi", bien shpesh në kontakt me ligjin; sektori i drejtësisë penale duhet të jetë në gjendje të dallojë shenjat e hershme të këtij rreziku para se sjellja e këtyre personave të kthehet në veprime penale. Përveç kësaj, duhen kuptuar dinamikat gjinore që lidhen me radikalizmin dhe me ekstremizmin e dhunshëm dhe të merren masat që e marrin parasysh këtë dinamikë gjinore, si dhe të aktivizohen mekanizmat parandalues, si referimi në vijën e parë apo bashkëpunimi me vijën e parë apo shërbime sociale dhe edukuese.

## 3) Politikat dhe kërkesat legjislative për parandalimin dhe kundërvënien me bazë gjinore ndaj EDhRÇT-së

Me rritjen e nismave programatike dhe kornizave të politikave që kanë në qendër parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, është rritur edhe fokusimi te nevoja e integrimit të perspektivës gjinore për garantimin e një pune operacionale efiçente dhe për shmangien e pikave të verbra. Këtu përfshihet promovimi i pjesëmarrjes së grave në këto përpjekje për të garantuar që ato përpjekje të jenë efikase, të qëndrueshme, si dhe të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat e grave.

---

61 Peters dhe Saeed, *Promovimi i kuadrove të politikave gjithëpërfshirëse për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm: Lidhja e Teorisë dhe Praktikës: Rasti studimor i një policeje grua në Pakistan* (Instituti i Georgetown për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe Siguria gjithëpërfshirëse, 2017), fq. 6–8.

Një sërë organesh rajonale dhe ndërkombëtare kanë pranuar domosdoshmërinë e parandalimit me bazë gjinore dhe përfshirjen e grave në kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Lëvizjet e ekstremistëve të dhunshëm i manipulojnë dhe i përdorin stereotipet dhe normat gjinore në propagandën e tyre[62] për rritjen e rekrutimeve, faktorë që ndonjëherë anashkalohet në përpjekjet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Në mënyrë që strategjitë, politikat dhe programet e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së të jenë më efikase, duhet të bëhet analiza e tyre gjinore. Këtu përfshihet njohja e përvojave të burrave dhe grave që janë ndeshur me përpjekjet për rekrutim të autorëve të dënuar për ekstremizëm të dhunshëm. Forcat e zbatimit të ligjit, së bashku me të tjerë aktorë në hapësirën e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së, duhet të marrin parasysh mbizotërimin e një lloj mashkulloriteti toksik që përdoret shpesh për promovimin e imazhit të një mënyre stereotipike e prapëseprapë të dëshirueshme jetese të mashkullit, një lloj jete që një njeri mund ta ketë vetëm duke u bashkuar me personin/ekstremistin e dhunshëm në fjalë.

OSBE-ja ka konfirmuar nevojën për marrjen parasysh të gjinisë në një sërë deklaratash të rëna dakord nga shtetet e saj pjesëmarrëse. OSBE-ja ka përqafuar në veçanti rekomandimet e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara dhe Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara përmes Deklaratës nr. 4/15 të Këshillit të Ministrave të OSBE-së për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT, miratuar në Beograd në dhjetor të vitit 2015. Kjo deklaratë rikonfirmon edhe një herë se UNSCR 2242 (2015) kërkon integrim më të madh nga shtetet në axhendat e tyre për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (WPS) antiterrorizmin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm që mund të favorizojë përhapjen e terrorizmit.

Kjo deklaratë u bën thirrje shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së "të marrin parasysh perspektivën gjinore në përpjekjet e tyre për t'iu kundërvënë terrorizmit dhe për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çon në terrorizëm, duke u fokusuar te fuqizimi i grave dhe pjesëmarrja e grave, po ashtu edhe e burrave në këto përpjekje". Roli i grave në parandalimin e EDhRÇT-së është theksuar sërish më pas në Deklaratën e Këshillit të Ministrave të OSBE-së të dhjetorit 2016 për forcimin e përpjekjeve të OSBE-së për parandalimin dhe kundërvënien ndaj terrorizmit.[63] Edhe Deklarata e Berlinit e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së u bën thirrje shteteve pjesëmarrësve të OSBE-së t'u përmbahen angazhimeve të tyre për të promovuar avancimin e grave edhe në institucionet e sektorit të sigurisë.[64]

62 *Lahoud, Fuqizimi apo nënshtrimi: Analiza e mesazheve gjinore të ISIL* (UN Women, 2018).

63 *Deklarata për Fuqizimin e Përpjekjeve të OSBE-së për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit* (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Këshilli i Ministrave, Dhjetor 2016, MC/DOC/1/16).

64 *Deklaratë e Berlinit dhe Rezoluta e miratuar nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së në seancën vjetore të njëzet e shtatë* (Asambleja Parlamentare e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, korrik 2018), paragrafi 17.

Përveç kësaj, edhe shumë rezoluta dhe dokumente të Kombeve të Bashkuara kanë konfirmuar rëndësinë që ka përfshirja e grave dhe forcimi i dimensioneve gjinore të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së. Rezoluta e 6të e Asamblesë së Përgjithshme për rishikimin e Strategjisë Globale kundër Terrorizmit, miratuar në qershor të viti 2018, thekson rolin e rëndësishëm që kanë gratë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, si dhe nevojën për integrimin e analizave gjinore në programet që kanë për synim adresimin e faktorëve që çojnë drejt radikalizmit.

Që prej miratimit në vitin 2005 të Strategjisë Globale të Kombeve të Bashkuara Kundër Terrorizmit, OKB-ja ka miratuar një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurisë dhe Asamblesë së Përgjithshme, ku thekson rëndësinë e integrimit të perspektivës gjinore dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.[65] Këto rezoluta mbështeten nga vite të tëra studimesh shkencore që tregojnë rolin e rëndësishëm që luajnë gratë në forcimin e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të strategjive dhe proceseve për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Ato gjithashtu marrin parasysh morinë e roleve që kanë luajtur gratë në ekstremizmin e dhunshëm, qoftë në parandalimin apo mbështetjen e tij, apo edhe si viktima të terrorizmit. Këto studime kanë shqyrtuar gjithashtu edhe manipulimin strategjik të formave dhe stereotipeve gjinore nga organizatat e ekstremistëve të dhunshëm.

Përveç kësaj, një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurisë së OKB-së (UNSC) për gratë, për paqen dhe për sigurinë (GPS) theksojnë rëndësinë që ka harmonizimi i përpjekjeve kundër ekstremizmit të dhunshëm me përpjekjet për çuarjen përpara të përfshirjes së grave në parandalimin, zgjidhjen e konflikteve dhe në rikuperimin prej tyre. Në vitin 2015, UNSC-ja miratoi disa rezoluta të rëndësishme që reflektojnë rëndësinë që ka përfshirja e grave dhe e të rinjve në hartimin e strategjive kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Rezoluta 2242 (2015) e OKB-së kërkon një integrim më të madh të axhendës për gratë, paqen dhe sigurinë në masat kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë edhe "pjesëmarrjen e grave, rolin e tyre drejtues dhe fuqizimin e grave" në hartimin e strategjive kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.[66]

Kjo thirrje për harmonizimin e axhendës GPS me përpjekjet në fushën e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së konfirmon se këto përpjekje janë më efikase dhe më të qëndrueshme në planin afatgjatë nëse pjesëmarrja e grave rritet dhe nëse për garantimin e qasjeve më tërësore merret parasysh edhe perspektiva gjinore. Axhenda GPS, e njohur zyrtarisht së pari nga KSKB-ja në vitin 2000 me miratimin e RKSKB 1325[67], vërteton se konflikti ka ndikime të ndryshme te gratë dhe vajzat krahasuar me ndikimet që ai ka te burrat dhe djemtë dhe se angazhimi më gjithëpërfshirës i grave në parandalimin e konflikteve, në zgjidhjen e tyre dhe në rikuperimin nga konfliktet, si dhe

65 A/RES/60/288 (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2006).

66 S/Res/2242 (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, 2015), OP11.

67 S/Res/1325 (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, 2000).

përfshirja e tyre e qenësishme është pjesë e pandarë e paqes dhe sigurisë afatgjatë. Kjo reflekton edhe njohjen e ndikimit që kanë dinamikat gjinore te faktorët që çojnë drejt EDhRÇT-së apo që krijojnë kushtet e favorshme për këtë fenomen, rolet e ndryshme që mund të luajnë burrat dhe gratë në kundërvënien dhe parandalimin e këtij fenomeni, si dhe ndikimet e ndryshme që ka dhuna te secili prej tyre.

Rezolutat pasuese kanë të bëjnë me përvojat specifike të grave në zona konflikti dhe me rolet e tyre në faza të ndryshme të ciklit konfliktual, duke përfshirë pjesëmarrjen, parandalimin, mbrojtjen, ndihmën dhe riaftësimin. [68]

Për shembull, Rezoluta 2242 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2015)[69] thekson ndikimet e ndryshme që terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm ka te "të drejtat e njeriut të grave dhe vajzave, duke përfshirë shëndetin, arsimimin dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike". Rezoluta thekson edhe se "gratë dhe vajzat shpesh shënjestrohen drejtpërdrejt nga grupet terroriste". Gjithashtu, Rezoluta 2178 (2014) për LHT-të i inkurajon Shtetet Anëtare të angazhojnë komunitetet vendore dhe aktorët joqeveritarë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë edhe fuqizimin e grave dhe grupeve të tjera të shoqërisë civile.[70] Bazuar në këtë thirrje, Rezoluta 2396 (2017) i inkurajon Shtetet Anëtare që të garantojnë lidershipin dhe pjesëmarrjen e grave në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjive që synojnë integrimin dhe sistemimin e të kthyerve dhe LHT-ve dhe familjeve të tyre.

Përveç këtyre rezolutave, OKB-ja ka njohur edhe rëndësinë e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe lidershipit të grave dhe të barazisë gjinore në hartimin e politikave dhe programeve për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Për shembull, Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm i vitit 2017[71] u bën thirrje Shteteve Anëtare të BE-së që strategjitë KEDhRÇT të mos ndikojnë për keq te të drejtat e grave. Gjithashtu, bën thirrje që mbrojtja dhe fuqizimi i grave të jetë aspekt qendror gjatë hartimit të strategjive që i kundërvihen terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Plani i Veprimit i OKB-së për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm e përcakton barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si pjesë të shtatë fushave kryesore që qëndrojnë në thelb të strategjisë parandaluese të OKB-së ndaj EDhRÇT-së. Këtu përfshihet:

---

68 Rezoluta të tjera të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për gratë, paqen dhe sigurimin: 1820 (20082008), 1888 (2009), 1889 (2009) 1889 (2010), 1960 (2011), 2106 (2013) dhe 2122 (2013).

69 Rezoluta 2242 (OKB, Këshilli i Sigurimit, 2015).

70 Rezoluta 2178 (OKB, Këshilli i Sigurimit, 2014), OP16.

71 *Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Sesioni i Shtatë*, A/70/674).

a) Integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
b) Investimi në studime shkencore me ndjeshmëri ndaj gjinisë dhe në mbledhjen e të dhënave për rolin e grave në ekstremizmin e dhunshëm, duke përfshirë edhe identifikimin e faktorëve që i shtyjnë gratë të bëhen pjesë e grupeve të dhunshme ekstremiste, si dhe ndikimin që kanë strategjitë kundër terrorizmit në jetën e tyre me qëllim hartimin e politikave me synime të qarta dhe të bazuara te provat, si dhe hartimin e programeve të ndryshme;
c) Përfshirja e grave dhe e grupeve të tjera të papërfaqësuara sa duhet në forcat e zbatimit të ligjit në vend dhe në agjencitë e sigurisë, duke përfshirë edhe në kuadrin e parandalimit dhe masave kundër terrorizmit;
d) Ngritja e kapaciteteve të grave dhe të grupeve të tjera të shoqërisë civile për t'u angazhuar në parandalimin dhe masat kundër ekstremizmit të dhunshëm; si dhe
e) Marrja e masave në mënyrë që një pjesë e të gjitha fondeve të caktuara për adresimin e ekstremizmit të dhunshëm të jenë në dispozicion të projekteve që adresojnë nevojat specifike të grave apo që fuqizojnë gratë, siç rekomandohet në raportin e vitit 2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë për gratë, paqen dhe sigurinë (S/2015/716).

Plani i Veprimit kërkon plane kombëtare dhe rajonale për parandalimin e EDhRÇT-së, duke marrë parasysh këto rekomandime dhe konsultimin me një gamë të gjerë aktorësh, duke përfshirë edhe me grupet e grave në hartimin e tyre nga ana e shteteve anëtare.



# Kapitulli III: Si ndikojnë dinamikat gjinore në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

## 1) Gratë dhe ekstremizmi i dhunshëm

Për të pasur një qasje gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe kundërvënien ndaj këtij kërcënimi duhet të kuptohet më mirë qëllimi i përfshirjes së grave në EDhRÇT. Përfshirja e grave në terrorizëm dhe në ekstremizmin e dhunshëm nuk përbën fenomen të ri – gratë kanë qenë aktive në grupet dhe rrjetet terroriste gjatë gjithë historisë. E megjithatë, prania e tyre si aktiviste të vijës së parë, si propaganduese, rekrutuese dhe mbledhëse fondesh është bërë gjithmonë dhe më e dukshme në grupet terroriste të kohëve të fundit në të gjithë globin.[72]

Në vitet 1960 dhe 1970, gratë ishin aktive në organizatën terroriste të ekstremit të majtë Baader-Meinhoff në Gjermani. Ato shërbyen aty edhe në rolet kyçe drejtuese dhe luftarake në lëvizjet separatiste në Evropë që janë shndërruar në lëvizje terroriste. Përveç kësaj, gratë kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë rol edhe në Al-Kaeda dhe në degët e Al-Kaeda-s, duke përfshirë edhe aktivitetet e tyre operacionale dhe duke ofruar mbështetje ideologjike.[73]

72 Bloom, *Gratë dhe Terrorizmi* (Zyra e shtypit e Universitetit të Oksfordit, 2017).

73 Von Knop, “Xhihadi femëror: Gratë e Al-Kaedas”: *Studimet e konflikteve dhe terrorizmit* 30.5 (2007).

Ndonëse shifrave të grave në grupet terroriste dhe në grupet e dhunshme ekstremiste u është kushtuar mjaft vëmendje, nuk është bërë po aq shumë për të shtjelluar arsyet që i çojnë gratë të largohen nga këto grupe.

Motivet që mund të kenë gratë për t'u larguar nga grupet nacionaliste dhe grupet e djathta ekstremiste që mbështesin fuqimisht partitë populiste mund të marrin forma nga më të ndryshmet. Këtu përfshihet zhgënjimi kur konstatojnë se jo të gjithë anëtarët e grupit janë të përkushtuar thellësisht ndaj kauzës apo rastet kur nuk gjejnë atë çka presin, si dhe ndjesia e tradhtisë, sidomos në rastin e grave që bashkohen me të djathtën ekstremiste me shpresën se do të gjejnë aty një familje të shëndetshme dhe mikpritëse që do të zëvendësojë marrëdhëniet jo të mira që kanë përjetuar gjetkë. Raportohet se gratë largohen nga këto grupe edhe kur gjasat për dhunë, duke përfshirë edhe sulmet ndaj këtyre grupeve nga komuniteti jashtë tyre, shndërrohen në kërcënime për fëmijët e tyre. Dhe përfundimisht, në braktisjen e këtyre grupeve nga këto gra ndikojnë shpesh edhe njohjet apo miqësitë që ato zënë me persona të grupeve të ndëshkuara nga këto lëvizje – si për shembull persona që u përkasin pakicave fetare ose atyre seksuale.[74]

Ende nuk dihen plotësisht arsyet që i shtyjnë gratë të largohen nga ISIL/Daesh. Studimet tregojnë se disa arsye janë të ngjashme me motivimet e renditura më lart. Në intervistat me studiuesit, gratë e përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi në ISIL/Daesh rrëfejnë se janë larguar (ose kanë tentuar të largohen) nga grupi për shkak se kanë qenë dëshmitare të akteve brutale apo se ishin të shqetësuara për fëmijët e tyre. Disa gra thonë se u zhgënjyen nga premtimet e pambajtura të ISIL/Daesh nisur nga situata që panë në terren, por edhe nga roli që prisnin të kishin me të mbërritur në Irak apo Siri. Megjithatë, studimet tregojnë se gratë që janë përpjekur të largohen nga ISIL/Daesh kanë pasur më pak sukses sesa meshkujt në këtë përpjekje.[75]

## 2) Ndërgjegjësimi gjinor dhe analiza me bazë gjinore e EDhRÇT-së

Ndërgjegjësimi gjinor në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT ka të bëjë me të kuptuarit e një morie rolesh që gratë luajnë në parandalimin, kundërvënien dhe mbështetjen e EDhRÇT-së, si dhe në përvojat e tyre si viktima. Kjo kërkon edhe njohjen e mënyrave se si strategji, politika dhe programe të ndryshme të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së mund të ndikojnë edhe negativisht te grupe të caktuara grash dhe burrash.

74 Blee, Simi, Latif dhe DeMichelle, "Pse largohen gratë nga e djathta ekstremiste?" (Universiteti i Oslos, Qendra për Studimet për Ekstremizmin, Korrik 2018).

75 Speckhard dhe Shajkovci, "Kujdes nga gratë e ISIS-it": Janë shumë dhe mund të jenë më të rrezikshme sesa burrat (*Daily Beast*, gusht 2017).

Terrorizmi dhe EDhRÇT-ja janë fenomene që e kanë një aspekt gjinor: gratë dhe vajzat i përjetojnë ato ndryshe nga burrat dhe djemtë (qoftë si viktima, autore apo si persona që punojnë për parandalimin apo kundërvënien ndaj këtij kërcënimi). Është e rëndësishme të kuptohet se ndonëse burrat mund të përbëjnë shumicën e ekstremistëve të dhunshëm, edhe gratë luajnë role të rëndësishme në organizatat ekstremiste të dhunshme. Në mënyrë që autoritetet ta parandalojnë apo t'i kundërvihen në mënyrë efikase EDhRÇT-së, është e domosdoshme që të kenë këtë lloj ndërgjegjësimi.

Strategjitë, politikat dhe programet që nuk e kanë një analizë të tillë gjinore janë të destinuara të mos i shohin dallimet gjinore në shtysat që çojnë drejt EDhRÇT-së. Analiza gjinore lejon bërjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës në një kontekst të caktuar, të dallimeve mes grave dhe burrave sa u përket mundësive, kufizimeve, shpërndarjes së burimeve dhe strukturave të shtetit. Kryerja e një analize gjinore të shtysave që çojnë drejt EDhRÇT-së, si dhe analizimi i roleve të diferencuara që luajnë burrat dhe gratë në shoqëri na ndihmon të kuptojmë motivet e ndryshme që i shtyjnë burrat dhe gratë të bëhen pjesë e rrjeteve ekstremiste dhe terroriste.

Ndonëse nuk ka asnjë dyshim se shumë burra, gra dhe fëmijë detyrohen apo manipulohen për t'u bërë ekstremistë të dhunshëm, është e domosdoshme që të thyhet stereotipizimi i arsyeve që i shtyjnë individë të caktuar të bëhen pjesë e këtyre grupeve, sidomos stereotipet që i portretizojnë gratë si pasive dhe "ndjekëse" të nënshtruara. Autoritetet dhe shoqëria civile duhet të kuptojnë çdo individ që me ndërgjegjen e vet vendos të bëhet pjesë e një organizate të ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë edhe dallimet gjinore në motivet që e shtyjnë atë individ të marrë një vendim të tillë. Njohja e këtyre dimensioneve gjinore lejon edhe që të kuptohet më mirë edhe procesi i radikalizimit të burrave dhe grave, si dhe marrjen e masave më të përshtatshme për adresimin e dinamikave me bazë gjinore në lidhje me personat që zgjedhin të bëhen pjesë e grupeve të tilla.

E njëjta gjë duhet thënë gjithashtu edhe për gratë dhe vajzat që vendosin të bëhen pjesë e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së. Gratë janë shpesh të papërfaqësuara sa duhet në sferën publike/qeveritare dhe në sektorin e sigurisë, sidomos në pozicione drejtuese. Përfshirja e grave në këta sektorë lejon pjesëmarrjen e tyre në procese kyçe të vendimmarrjes në lidhje me parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së dhe në përgjegjësinë për çështje që kanë të bëjnë me mirëqenien e komuniteteve.

Analizat e hollësishme gjinore duhet të përfshijnë një analizë të mënyrës se si kontribuojnë disa norma në përvojat personale, si stereotipet për mashkullin apo femrën: burrë "i vërtetë" ose grua "e mirë". Aty duhet të përfshihen edhe shqetësimet, ndërveprimet ndërpersonale dhe sjelljet në nivel organizatash, si për shembull duhet të vlerësohet ndikimi që ka pavarësia kulturore dhe fetare, përgjegjësitë në familje apo në komunitet, përgjegjësia e përkatësisë, etj. Një sërë organizatash kanë hartuar udhëzime për mënyrë se si duhet të bëhen të tilla analiza të hollësishme gjinore, udhëzime që mund të përdoren

në hartimin dhe në zbatimin e strategjive, politikave dhe programeve për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.[76]

## Rolet e ndryshme të burrave dhe të grave në organizatat e dhunshme ekstremiste

Për të kuptuar dinamikat gjinore të EDhRÇT-së, duhet të kuptohet jo vetëm objekti i pjesëmarrjes së grave në ekstremizmin e dhunshëm, por edhe dallimet gjinore në rolet që ato luajnë brendapërbrenda organizatave të dhunshme ekstremiste, role që varen nga natyra e secilës organizatë. Është e rëndësishme të kuptohet se gratë dhe burrat nuk formojnë në asnjë organizatë një grup uniform; ato luajnë role të ndryshme.

Në shumë organizata të dhunshme ekstremiste, burrat janë aktorët kryesorë në drejtim, luftime dhe në role operacionale [77]. Ata mund të jenë gjithashtu të prirur ta ngrenë më shumë zërin për tendencat e tyre ekstremiste dhe për përfshirjen e tyre në EDhRÇT, si dhe më të dukshëm për botën jashtë, duke përfshirë edhe përmes akteve të dhunës. Tubimet e djathta ekstremiste, si ato të neonazistëve, dominohen shpesh nga imazhet e djemve të rinj, veshur me simbole ideologjike, duke lëshuar slogane të dhunshme ekstremiste.

Po kështu, pjesa më e madhe e imazheve të propagandës së aktivitetit të ISIL/ Daesh që ka hyrë në sferën publike ka konsistuar në filmime të burrave të armatosur nga fushat e betejës në Siri dhe në Irak. Burrat kanë qenë ata që kanë dominuar radhët e luftimit të ISIL/Daesh, Al-Kaeda dhe grupeve të tjera që lidhen me ta, si dhe grupimeve terroriste. Roli i grave në luftime ka qenë shumë i kufizuar ose më pak i dukshëm.

Megjithatë, ndonëse pjesëmarrja e grave në ekstremizmin e dhunshëm ka qenë e kufizuar krahasuar me atë të burrave, studiuesit kanë theksuar se mosnjohja e shkallës së roleve që kanë luajtur gratë në organizatat e dhunshme ekstremiste dhe e ndikimit që kanë pasur dinamikat gjinore në rekrutimet në këto grupe kanë përbërë një boshllëk të jashtëzakonshëm në përpjekjet për parandalimin/ kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Njohja kryesisht e burrave si autorë të dhunshëm çon në politika të verbra ndaj këtyre dinamikave gjinore në përpjekjet për të parandaluar dhe për t’iu kundërvënë kësaj dhune, një dhunë ku kontribuojnë edhe gratë[78].

Përpjekjet fillestare për të kuptuar rolin e grave në organizatat e dhunshme ekstremiste dhe në grupet terroriste kanë vuajtur nga analizat e shpejta pavarësisht faktit se ka vërtet gra që në disa grupe terroriste dhe organizata të dhunshme terroriste luajnë role drejtuese dhe operacionale, shifrat e tyre relativisht të ulëta në radhët e ekstremistëve kanë çuar në perceptimin se gratë

---

76 Shih, për shembull, *Si kryhet analiza gjinore: Një shënim udhëzues për stafin e UNDP* (Programi i Zhvillimit i OKB-së, 2016).

77 Shih, për shembull, bazën e të dhënave të terroristëve dhe ekstremistëve (Projekti për luftën kundër ekstremizmit), https://www.counterextremism.com/extremists.

78 Pearson, *Pse burrat luftojnë dhe gratë jo: Mashkulloriteti dhe Dhuna Esktremiste* (Instituti i Tony Blair për Ndryshim Global, 2018).

nuk janë të rëndësishme për funksionimin e përgjithshëm të këtyre grupeve. Rrjedhimisht, roli i grave në organizatat e dhunshme ekstremiste dhe në grupe terroriste është parë zakonisht si "viktima të pafuqishme të nënshtruara dhe familjare".[79]

Është parë një përjashtim në disa grupe, ku gratë përfaqësojnë një pjesë më të madhe në radhët e këtyre grupeve ose janë më shumë autore të dhunës. Ngjarjet ku aktet terroriste kanë qenë të kryera ose të trajtuara nga femrat (për shembull, "Vejushat e Zeza" çeçene në krizën e vitit 2002 të pengjeve në teatrin e Moskës apo "Vejusha e Bardhë" që mendohej se ishte pas sulmit të vitit 2013 në Nairobi, *Westgate*) janë përshkruar shpesh nga media si raste përjashtuese, gjë që çon në një lloj sensacioni për angazhimin e grave në dhunë. Konvencioni popullor i përshkrimit të grave ekstremiste përmes marrëdhënieve të tyre me burrat (përshkrimi i tyre si bashkëshorte apo si gruaja e një burri, apo si vejusha e tyre) i zhvesh ironikisht *de facto* gratë nga vendimi që ato vetë marrin për t'u përfshirë në terrorizëm dhe nuk i përfaqëson si duhet pikëpamjet e përgjithësuara të prirjeve të grave për dhunë. Si rrjedhojë, reagimet nga forcat e zbatimit të ligjit janë shpesh joefiçente.

Roli i grave në ISIL/Daesh në veçanti është kuptuar më mirë duke qenë se studiuesit kanë pasur mundësi të intervistojnë dezertorë të ISIL/Daesh dhe LHT të kthyer. Është parë se gratë, ashtu sikurse edhe burrat, luajnë role të rëndësishme në operimin e këtij grupi, ndonëse rolet e tyre janë shpesh të ndryshme.

Sipas Qendrës Ndërkombëtare për Studimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, gratë në ISIL/Daesh është parë se përmbushin role aktive si rekrutuese, propaganduese dhe anëtare të organizatës së këtij grupi. Është konstatuar gjithashtu se ndaj grave që nuk i janë përmbajtur kodit moral strikt të imponuar nga grupi janë ndërmarrë masa shumë brutale nga gratë e tjera[80]. Shumë gra në ISIL/Daesh luajnë edhe rolin e kujdestareve, duke përfshirë rritjen dhe indoktrinimin e fëmijëve të luftëtarëve të ISIL/Daesh.

Komiteti i Këshillit të Evropës Kundër Terrorizmit i ka ndarë rolet që luajnë gratë në ISIL/Daesh në tre kategori kryesore: agjente të nevojshme të ndërtimit të shtetit, rekrutuese dhe militante[81].

Kategoria e parë përfshin detyrat që kanë të bëjnë me kontributin aktiv në mbajtjen në këmbë të ISIL/Daesh, duke përfshirë këtu rolet si grua dhe nënë, mësuese, mjeke apo infermiere, si dhe detyra logjistike për llogari të kësaj organizate terroriste. Së dyti, si rekrutuese, anëtaret femra të ISIL/Daesh ftojnë gra të tjera për t'u bërë pjesë e këtij grupi. Ato përhapin propagandë dhe i orientojnë këto gra se si t'i kapërcejnë pengesat që dalin nga familjet e

---

79 Idris dhe Abdelaziz, *Gratë dhe kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm* (GSDRC, 2017).

80 Almohammad dhe Speckhard, *Kategoritë operacionale dhe Rolet e Grave në funksionet e ISIS: Nga vrasësit dhe policia moralistet deri tek spiunët dhe bombat vetëvrasëse* (Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, 2017).

81 Komiteti i Ekspertëve për Terrorizmin, Rolet e Grave në Daesh: Dokumenti i diskutimit (Këshilli i Evropës, 2016), fq. 5-8.

personave të rekrutuar para se ata të nisen. Dhe së treti, ndonëse gratë kanë luajtur role më aktive luftuese në grupe të tjera terroriste, gratë në ISIL/Daesh kanë luajtur rol aktiv edhe në inkurajimin e akteve terroriste. Këshilli i Evropës ka dokumentuar gjithashtu raste të disa grave të ISIL/Daesh që kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në akte terrorizmi[82].

Ndonëse organizatat e ekstremizmit të dhunshëm dhe grupet terroriste i kanë lejuar gratë që të shërbejnë në role direkt luftarake, duke përfshirë edhe si kamikaze, angazhimi i grave në luftime në ISIL/Daesh është konsideruar i padëshirueshëm, ndonëse i lejuar në rrethana të jashtëzakonshme. Kështu ka ndodhur në rastin e betejave të Levantit në muajt që çuan në mundjen ushtarake të ISIL/Daesh. Në propagandën e kohëve të fundit të shpërndarë nga ISIL/Daesh, gratë janë portretizuar përmes imazheve në pozicione luftarake.[83]

Gratë kanë shënuar edhe një lloj lufte urbane edhe në vendet nga ato vijnë. Për shembull, një qeli në vitin 2016 në Francë ishte e mbushur vetëm me gra të akuzuara se kishin komplotuar për të organizuar një shpërthim me bombë të një makine afër Katedrales së Notrë Damit në Paris[84]. Roli aktiv i grave në terrorizëm ka përfshirë edhe hedhjen e tyre në erë si kamikaze. Sipas studimeve të bëra për këtë aspekt, autoret femra kanë përbërë afërsisht 15% të të gjitha sulmeve vetëvrasëse nga viti 1985 deri në 2006[85].

Përveç kësaj, gratë kanë ndërmarrë role të ndryshme në grupet e djathta ekstremiste, grupe që mund të kryejnë akte terrorizmi. Studimet e disa rasteve të grupeve të djathta ekstremiste kanë konstatuar se burrat luajnë më shumë rolin e aktivistëve publikë në këto grupe dhe rrjete, ku retorika antifeministe dhe thirrjet për kufizim të të drejtave të grave janë shpesh ato që karakterizojnë ideologjitë e tyre.

Megjithatë, gratë po luajnë prapëseprapë gjithmonë e më shumë role kyçe operacionale në këto grupe,[86] duke përhapur ideologjitë e tyre dhe duke ekuilibruar mashkulloritetin e dhunshëm të burrave në këto grupe përmes propagandës[87]. Në imazhin publik, ekstremizmi i djathtë prezantohet shpesh si një fenomen mashkullor, ku roli i grave shpesh mbetet i panjohur. Edhe në përpjekjet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së mund të anashkalohen burrat që nuk përputhen me imazhin e "burrit të djathtë mashkullor" ose që nuk e prezantojnë ideologjinë e tyre në mënyra të dukshme publikisht[88].

82 Po aty, fq. 8

83 Ingram, "Manipulimi gjinor i Shtetit Islamik në operacionet e tyre *online* të informacionit" (Vox Pol, mars 2018).

84 Dickey, "Tani ISIS po i shndërron gratë në mish për top në Francë" (The Daily Beast, shtator 2016).

85 Davis, "Evoluimi i xhihadit global: Kamikazet femra në Irak" (*Studimet e Konfliktit dhe Terrorizmit*, 2013).

86 Shih, për shembull, Pegida – protestat e burrave (Fondacioni Amadeu Antonio). Gjendet në: http://www.gender-und-rechtsextremismus.de/gmf-und-gender-1/pegida-und-gender/

87 Flood, "Gjinia dhe ekstremizmi i dhunshëm: Debate bashkëkohore" (Universiteti i Oslos, Qendra për Studimin e Ekstremizmit, Korrik 2018).

88 Informacion i përgjithshëm (Fondacioni Amadeu Antonio), http://www.gender-und-rechtsextremismus.de/hintergrund/

## Motivimi me bazë gjinore i ekstremizmit të dhunshëm

Organizatat ekstremiste të dhunshme i kuptojnë mirë dinamikat gjinore dhe i manipulojnë stereotipet dhe normat gjinore si u leverdis në procesin e rekrutimit dhe në mesazhet propaganduese, mesazhe që shpesh shënjestrojnë posaçërisht burrat ose gratë.

Për shembull, fushata gjermane e të djathtës alternative '#120db' (120 decibel – i referohet volumit të alarmeve të xhepit që mbajnë disa gra për t'u mbrojtur nga ngacmimet në rrugë) fajëson emigrantët dhe refugjatët për dhunën seksuale në Evropë. Faqja e internetit e kësaj fushate[89] i fton gratë të rrëfejnë përvojat e tyre me "dhunën e importuar" dhe të bashkohen me "qëndresën" kundër "zëvendësimit" të evropianëve (të bardhë) me emigrantët.

Me propagandën për krijimin e komunitetit "të vërtetë" mysliman (*Ummah*) në territoret e veta në Lindjen e Mesme, ISIL/Daesh u drejtohej rekruteve evropiane që kanë vuajtur nga forma diskriminimi për shkak të besimit të tyre fetar në vendet e tyre. Për shembull, gratë që zgjedhin të mbulohen me *hijab* ose *niqab* kanë përjetuar forma abuzimi verbal dhe fizik në publik, për shkak se zgjedhin të tregojnë më hapur identitetin e tyre mysliman.

Disa ekspertë nënvizojnë se ndjesia e izolimit brenda një komuniteti më të madh jomysliman dhe dëshira për ndjesinë e përkatësisë në një komunitet mysliman janë ndër faktorët që i shtyjnë të bashkohen me ISIL/Daesh.[90] Shumë i referohen solidaritetit të fortë mes grave të ISIL/Daesh, si një ndjesi superiore krahasuar me marrëdhëniet sipërfaqësore që kanë pasur në shoqëritë evropiane. Nevoja e përkatësisë shihet nga disa edhe si motivi i angazhimit të grave në grupet e ekstremit të djathtë - grupe që shpesh japin përshtypjen sikur kanë struktura të shëndetshme dhe familjare.[91]

Në tërë spektrin e organizatave të dhunshme ekstremiste, gratë i ka twrhequr edhe ideja se do të bëhen nëna të një brezi të ri fëmijësh që do t'i përmbaheshin ideologjisë së këtij grupi.

---

89 Shih: https://www.120-db.info

90 "Gratë në ekstremizmin e dhunshëm: Mësimet e nxjerra nga Kosova" (Qendra Kosovare për Studimet e Sigurisë, 2017).

91 "Pse largohen gratë nga e djathta ekstreme?" (Universiteti i Oslos, Qendra për Studimin e Ekstremizmit). Gjendet në: https://www.sv.uio.no/c-rex/english/news-and-events/right-now/why-do-women-leave-the-far-right.html/

## Roli i mashkulloritetit dhe feminitetit në mobilizimin e ekstremizmit të dhunshëm

Në rekrutime dhe në propagandën e tyre, organizatat e ekstremizmit të dhunshëm shpesh përfitojnë nga koncepti i mashkulloritetit dhe feminitetit. Në shumë shoqëri tradicionale, "burri i mirë" shpesh barazohet me patriarkun e fortë i familjes, i përkufizuar në krahasim me burrat e tjerë që përpiqet t'ua kalojë sa i përket statusit, pasurisë dhe pozitës shoqërore. Burrave që e kanë të vështirë të përmbushin pritshmëritë tradicionale të të qenit mashkull - p.sh. të qenit personi kryesor që siguron të ardhurat, që respektohet dhe nderohet apo që ka mundësi të ketë partnerë seksualë sipas zgjedhjes së vet - organizatat e ekstremizmit të dhunshëm mund t'u duken një alternativë e mirë për të konfirmuar mashkulloritetin e tyre[92].

Për shembull, propaganda e ISIL/Daesh i portretizon luftëtarët si mbrojtës tejet mashkullorë të besimit apo komunitetit, që gëzojnë atributet e begatisë dhe përmbushjes seksuale. Pranimi dhe përdorimi i dhunës nga grupet e dhunshme ekstremiste përkon me etosin mashkullor të fuqisë fizike. Përveç kësaj, rrjetet e dhunshme të ekstremit të djathtë shpesh trumbetojnë narrativa historike për kohët kur "burrat ishin burra", kur luftonin në fushën e betejës dhe vdisnin me lavdi. Në disa ideologji të ekstremizmit të dhunshëm, elementi i luftës "për kauzën e drejtë" synon të portretizojë imazhin e një rendi të rreptë ushtarak ku gjaku dhe nderi janë vlerat kryesore - edhe pse mund të mos jetë kështu në realitet.

Përveç kësaj, mobilizimi i të djathtës ekstreme mbështetet shpesh te rolet gjinore[93], ku burrat janë mbrojtësit dhe i përkasin vijës së parë, ndërsa gratë kanë si detyrë të kujdesen për familjen. Ka anëtare që i përqafojnë me dëshirë këto dogma dhe që kundërshtojnë në mënyrë aktive feminizmin, sepse u duket koncepti i barazisë gjinore si sfidë ndaj rrymës kryesore të shoqërive të tyre (në Evropën Perëndimore apo në Amerikën e Veriut).[94] Për shembull, koncepti *tradewives* (gra tradicionale) në disa prej lëvizjeve djathtiste që lidhen me familjen (e bardhë) tradicionale, e përkufizojnë rolin e grave se ato duhet të merren vetëm me punë shtëpie. Duke e theksuar këtë dogmë edhe me ngjyrën e bardhë të lëkurës, përhapin ide raciste dhe kundër emigracionit[95].

---

92 Ní Aoláin, "Mashkulloriteti, Xhihadi dhe Mobilizimi" (*Just Security*, Tetor 2018). Gjendet në: https://www.justsecurity.org/33624/masculinity-jihad-mobilization/

93 Kitchener, "Gratë pas së "djathtës alternative'" (*The Atlantic*, gusht 2017).

94 Bowman dhe Stewart, "Gratë pas të "djathtës alternative" (*National Public Radio*, gusht 2017).

95 Michelle, "Gratë me një qëllim: Vala e re e Grave Tradicionale të Alternativës së Djathtë" (*Medium*, qershor 2018).

Në organizatat e dhunshme ekstremiste, respektimi i rreptë i roleve gjinore "tradicionale" të burrave dhe të grave ndikon shpesh te mënyra se si vendosin rendin shoqëror. Organizatat e dhunshme ekstremiste e dinë mjaft mirë si ta shfrytëzojnë shtypjen seksuale dhe dhunën me bazë seksi dhe gjinie në dobinë e tyre. Shfrytëzimi bëhet në disa mënyra, përfshirë skllavërinë seksuale, trafikimin e qenieve njerëzore, përdhunimin individual dhe në grup, kufizimin e të drejtave të grave dhe aksesit në shërbimet sociale bazë, çiftimi i detyruar, e madje edhe përmes ndëshkimit të grave si "armike".

Rezoluta 2331 (2016) e Këshilli i Sigurisë të Kombeve të Bashkuara ka konstatuar se "aktet e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën që shoqëron trafikimin e qenieve njerëzore, njihen si pjesë e objektivave strategjike dhe ideologjisë së grupeve të caktuara terroriste që i përdorin si taktikë terrorizmi dhe si instrument për rritjen e financave dhe pushtetit të tyre përmes rekrutimit dhe shkatërrimit të komuniteteve."[96]

Kontrolli i rreptë dhe sistematik mbi rolet e caktuara gjinore vlen edhe për meshkujt. Meshkujt që nuk konsiderohen mjaftueshëm të fortë mendërisht apo fizikisht për të luftuar, mund të përjashtohen dhe madje të përdoren me forcë si mburoja njerëzore. Në grupe të caktuara terroriste, disa elementë të dhunës seksuale përdoren për të nxitur luftëtarët meshkuj dhe për të joshuar rekrutët e rinj[97].

Në Evropë dhe në Amerikën e Veriut, këto narrativa gjinore u drejtohen meshkujve që i shohin format e dhunshme të mizogjenisë si kompensim për kufizimet e veta. Narrativa gjithnjë e më popullore se feminizmi viktimizon meshkujt e bardhë është bërë fokusi i Lëvizjes së Djathtë të Burrave (MRM) dhe përdoret shumë në lëvizjet djathtiste[98]. MRM-ja i jep zë urrejtjes dhe përçmimit të grave dhe e sheh feminizmin dhe emancipimin e grave si zhburrëruese dhe cenim të "dominimit mashkullor". Kjo retorikë mizogjene shkon nga mosrespektimi i grave deri te nxitja e dhunës ndaj tyre.

MRM ka disa dhoma çati *online* ku përqafohen ide si përdhunimi në takimin e parë apo përdhunimi në martesë, kurse disa të tjera kremtojnë dhe inkurajojnë dhunën mizogjene. Për shembull, të ashtuquajturit "beqarë të pavullnetshëm" (incelët) e shohin pamundësinë e tyre për të gjetur një partner seksual si formë të shtypjes femërore[99]. Ata mbrojnë dhunën ndaj grave të cilat i fajësojnë për mungesën e përmbushjes seksuale që sipas tyre u takon. "Rebelimi i Incel" është përmendur si motiv edhe nga autori i sulmit terrorist të prillit 2018 në Toronto, ku gratë ishin shënjestra kryesore[100].

---

96 S/RES/2331 (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, 2016).

97 Malik, *Terrori i trafikimit: Si e financojnë terrorizmin skllavëria modern dhe dhuna seksuale* (The Henry Jackson Society, 2017).

98 *Kur gratë janë armiku: Pikëprerja e Mizogjenisë me Supremacinë e Bardhë* (Anti-Defamation League Center on Extremism, 2018).

99 Johnson, "Mizogjenin e zemëruar nga ekstremisti i dhunshëm e ndan një hap i vogël" (*Stuff*, Maj 2018). Gjendet në: https://www.stuff.co.nz/life-style/life/103591936/verity-johnson-its-a-short-step-from-angry-misogynist-to-violent-extremist

100 "Alek Minassian, I dyshuari për sulmin me furgon në Toronto lavdëron 'vrasësin *incel*" (BBC News, prill 2018).

Politika të ndryshme, programe dhe media shpesh e konsiderojnë strukturën shoqërore të feminitetit si njëfarë inferioriteti dhe nënshtrimi ndaj burrave në kontekstin e EDhRÇT-së. Për pasojë, kemi një paraqitje të pasaktë të shkallës së pjesëmarrjes së grave në organizatat e dhunshme terroriste. Shpesh media i portretizon gratë që u përkasin grupeve të tilla si të rekrutuara thjesht si ndjekëse të heshtura të partnerëve të tyre[101]. Megjithatë, ky është një steriotip që nuk jep tablonë e drejtë dhe të plotë të së vërtetës, pasi ka plot gra që e kanë nisur, e kanë mbështetur dhe e kanë nxitur kauzën ekstremiste.

Cilësimi i përgjithshëm i grave si "të padëmshme" dhe si të paafta për të kryer akte dhune ka minuar shpesh saktësinë e politikave dhe masave operacionale EDhRÇT. Kjo qasje ka edhe implikime të qarta në përpjekjet kundër terrorizmit. Për shembull, ka pasur raste ku meshkujt që ishin anëtarë të organizatave të dhunshme terroriste janë veshur si gra për t'u larguar nga vendngjarja e krimit apo për të hyrë në hapësira të kufizuara, me dijeninë e plotë se rojet në postblloqet e sigurisë janë më tolerantë me gratë dhe shpesh këto postblloqe nuk kanë personel femëror të mjaftueshëm për të kryer kontrollin e grave[102].

## EDhRÇT, përkatësia gjinore dhe sistemi i drejtësisë penale

Ndonëse ky botim nuk synon të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse të aspektit gjinor dhe të drejtësisë penale në rastet e EDhRÇT-së, ia vlen të theksohen disa pika për ta kuptuar këtë fenomen në përgjithësi[103]. Sistemi i drejtësisë penale shpesh nuk arrin të marrë parasysh dinamikat gjinore evidentuar më lart, gjë që çon në masa të papërshtatshme ose joefikase në trajtimin e EDhRÇT-së. Shpesh, sektorët e drejtësisë penale janë të njëanshëm në perspektivën e tyre gjinore, me metoda që kanë kryesisht në shënjestër autorët meshkuj, duke shpërfillur metodat e ndryshme që duhet të përdoren për gratë. Kjo shpesh shoqërohet me mungesën e grave në sektorët e drejtësisë penale, për shkak se mungojnë politika të përshtatshme për punësiminn, mbajtjen dhe promovimin e grave në këta sektorë.

Meqë burrat kryejnë shumicën e veprave penale, sistemet e drejtësisë penale zhvillohen zakonisht për trajtimin e autorëve meshkuj. Kjo ndodh në të gjitha pjesët e sistemeve të drejtësisë penale: për parandalimin dhe hetimin e krimeve, mbledhjen e informacionit sekret, kontaktet e përgjithshme apo specifike me efektivët ligjzbatues, vendimet gjyqësoredhe burgimet e ndryshme. Mosnjohja e aspekteve gjinore të sjelljes penale, mund të bëjë që aktorët e fushës së drejtësisë të trajtojnë burrat dhe gratë në konflikt me ligjin bazuar në steriotipet gjinore.

---

101 Komiteti i Ekspertëve për Terrorizmin, *Rolet e Grave në Daesh: Dokumenti i diskutimit* (Këshilli i Evropës, 2016).

102 Barsa, "Qasjet e SHBA-së ndaj Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm duhet të prioritizojnë gratë" (*New America*, mars 2015).

103 Për më shumë informacion mbi qasjet që lidhen me gjininë dhe reagimet e drejtësisë penale për EDhRÇT-në, shih manualin e UNODC *Dimensionet gjinore të Reagimeve të Drejtësisë Penale për Terrorizmin*, i ardhshëm 2019.

Për shembull, në zinxhirin e drejtësisë penale shpesh vihet re tendenca në rastin e autoreve femra të veprave penale që t'ua atribojnë krimin shpërthimeve emocionale apo mungesës së stabilitetit psikologjik, pa u nisur nga qëllimet e vërteta kriminale (shih rastin studimor në Kapitullin V). E njëjta gjë vlen edhe për mënyrën si shihen gratë në kuadrin e elementëve të EDhRÇT-së që kanë të bëjnë me dhunën dhe me aktivitetin kriminal.

Shumë studiues kanë shqyrtuar faktorët e riskut që mund të çojnë gratë drejt dhunës apo militantizmit (motivuar edhe nga ideologjia), por ato duhet të eksplorohen më tej. Të tillë faktorë risku përfshijnë reagimet ndaj problemeve me institucionet shtetërore apo me komunitetet, reagimet prej perceptimit se zbatohen masa jo të njëjta sigurie për burrat dhe për gratë, apo ekspozim ndaj dhunës me bazë gjinore shoqëruar me aspekte psikologjike që vijnë si rrjedhojë e saj.

Gratë përballen me stigmatizim në disa shoqëri, ku viktimat e krimeve të caktuara mund të ndikojnë në aftësinë e grave për të marrë drejtësi për krime të tilla, sidomos në juridiksionin ku ka njëlloj "detyrimi moral" në lidhje me këto forma të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore (DhBSGj)[104]. Viktimat e këtyre krimeve mund të gëzojnë më pak mbrojtje ose më pak akses në mjete juridike. Në administrimin e drejtësisë, steriotipet gjinore mund të çojnë aktorët e drejtësisë penale në njëanshmëri, përfshirë policinë, avokatët dhe gjyqtarët. Kjo njëanshmëri mund të manifestohet në rastet e dhunës seksuale që ndikohen, për shembull, nga besimet rreth sjelljes apo qëndrimeve të viktimës ndaj dhunës martesore[105]. Pamundësia e sistemit të drejtësisë penale për t'u dhënë drejtësi viktimave të krimeve me bazë gjinore mund të ndikojë te besimi që kanë burrat dhe gratë te aktorët e drejtësisë penale. Kjo është e rëndësishme, pasi ndikon drejtpërdrejt në vullnetin e grave për t'u angazhuar në sistemin e drejtësisë penale. Kështu ndihet e përjashtuar gjysma e popullatës dhe normalisht kjo e pengon punën e sistemit të drejtësisë penale në identifikimin, arrestimin dhe procedimin penal të kriminelëve, përfshirë këtu ekstremistët e dhunshëm. Në rastin e efektivëve të policisë dhe agjentëve të shërbimit sekret, kjo ul kapacitetin e tyre për parandalimin dhe luftimin e krimit, përfshirë EDhRÇT-në.

Në kontekstin e EDhRÇT-së, mungesa e besimit te sistemi i drejtësisë penale mund të krijojë kushte të përshtatshme për dhunë dhe abuzim. Përvojat negative me aktorët e drejtësisë penale - përfshirë diskriminimin seksual dhe dhunën me bazë gjinore nga këta aktorë - mund të jetë një faktor që shtyn drejt EDhRÇT-së si gratë edhe burrat. Për më tepër, boshllëqet gjinore në sistemin e drejtësisë penale mund t'u japin grupeve të ekstremizmit të dhunshëm avantazhe strategjike dhe taktike, siç është supozimi gjinor se gratë janë më paqësor dhe janë më pak të prirura të përfshihen në akte dhune.[106]

---

104 *Paketa e instrumenteve të Profesionistëve për Aksesin e Grave në Programimin e Drejtësisë* (UN Women, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut 2018).

105 Po aty, fq. 96.

106 Bloom, "Predhat: Gratë dhe Terrori" (*Çështjet gjinore*, 2011), fq. 3.

# 3) Roli i grave në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

Ekstremizmi i dhunshëm është një fenomen kompleks që prek kombe dhe komunitete në disa nivele. Trajtimi i dimensioneve të tij të shumëfishta kërkon qasje tërësore ndaj shprehjes dhe kauzave të ekstremizmit. Sipas Planit të Veprimit të OKB-së për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, një parandalim i ekuilibruar dhe i mirëstrukturuar i EDhRÇT-së kërkon marrjen e masave në fushat prioritare të parandalimit të konflikti, mirëqeverisje, angazhim të komuniteteve, fuqizim të të rinjve, barazi gjinore, arsimim dhe komunikim strategjik[107].

Nismat parandaluese në këto fusha duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të marrin parasysh faktorët që shtyjnë burrat dhe gratë drejt ekstremizmit. Qasjet P/K EDhRÇT që merren me shkaqet kryesore të dhunës duhet të jenë të ndjeshme ndaj aspekteve gjinore. Përveç kësaj, ato duhet t'i japin prioritet përfshirjes së qenësishme të aktorëve kryesorë, sidomos grave, në zhvillimin dhe zbatimin e këtyre masave.

Parandalimi i konflikteve, ndërtimi i paqes dhe reforma e sektorit të sigurisë (RSS) lidhen saktësisht me parandalimin e radikalizimit terrorist. Në mjedise armiqësore, shkalla e suksesit e rekrutimit nga organizatat e ekstremizmit të dhunshëm shpesh është në raport të drejtë me konfliktet e mbrujtura nga probleme të pazgjidhura kolektive apo padrejtësitë dhe diskriminimin mbi baza etnike apo fetare. Konstatohet se gratë janë në pozitat e duhura për të diktuar shenjat paraprake të dhunës. Falë rolit kyç në familje dhe në komunitete, gratë janë në pozita të përshtatshëm për të dalluar rutina sjelljeje dhe aktivitete të pazakonta, si mobilizimi nën armë apo grumbullimi i armëve.

Për shembull, në Kosovë, gratë ishin të parat në komunitetet e tyre që ngritën shqetësimin për burrat që po gjenin armë dhe që po stërviteshin për luftë në vitin 1998. Këto shenja ishin raportuar që përpara se të shpërthente dhuna[108]. Përveç kësaj, rreth 6-8 javë para shpërthimit të dhunës së gjerë në Bosnjë-Hercegovinë në vitin 1992, një numër i madh grash kryesisht me origjinë myslimane u larguan nga qyteti i Prijedorit. Këtë e përshkruan si masë për të mbrojtur familjet nga rreziku, sepse kishin dalluar shenja paralajmëruese të një dhune të afërt[109].

---

107 *Plani i veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm* (Seanca e shtatëmbëdhjetë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/70/674).

108 Hill, *Kontributi i grave në parandalimin e konfliktit, paralajmërimi i hershëm dhe Çarmatimi* (Instituti i Kombeve të Bashkuara për Studimin e Çarmatimit, 2003), fq. 18.

109 https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/ToolkitWomenandConflictPreventionandResolution_InternationalAlert2004.pdf

Përveç kësaj, gratë janë në pozita të përshtatshme për të përceptuar tendencat negative në komunitetet e tyre, sepse shpesh shënjestra e parë e ideologjive të dhunshme ekstremiste janë të drejtat dhe integriteti fizik i grave[110]. Kufizimet e të drejtave të grave kanë shoqëruar shpesh lindjen e grupeve ekstremiste (sidomos të atyre me ideologji fetare fondamentaliste) në të gjithë globin, siç dëshmohet nga talibanët, ISIL/Daesh, Al-Kaeda dhe Boko Haram[111]. Prandaj, OKB-ja ka bërë thirrje për më shumë integrim të përpjekjeve për GPS (Gratë, Paqja dhe Siguria) dhe KEDh, pjesëmarrje më të madhe të grave, lidership dhe fuqizim të tyre në hartimin e strategjive kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm[112]. Përveç kësaj, provat kanë treguar se kur gratë përfshihen në negociatat për paqe, marrëveshjet e arritura janë më jetëgjatë dhe kanë më shumë gjasa të adresojnë shkaqet kryesore të dhunës[113].

Në shumë vende të prekura nga terrorizmi, shoqëria civile ka identifikuar përvojën negative me zbatimin e ligjit si faktor shtytës që gërryen legjitimitetin e shtetit. Problemet e krijuara çojnë në kushte favorizuese për ekstremizmin e dhunshëm. Praktikat diskriminuese që ndjek sektori i sigurisë mund të çojnë në përshkallëzim të problemeve ekzistuese mes popullatave të marxhinalizuara, duke sjellë një valë më të madhe mosbesimi mes sektorit të sigurisë dhe komuniteteve.

Nëse policia është përfaqësuese e popullatës që ka për detyrë të mbrojë, atëherë kjo mund të ndihmojë në trajtimin e shqetësimeve të tilla. Studimet tregojnë se gratë police (edhe me modelin e policimit në komunitet) janë shumë të rëndësishme për rritjen e efikasitetit operacional të forcave policore, përfshirë uljen e dhunës dhe krijimin e besimit mes komuniteteve lokale[114]. Ato janë shumë më të afta të dallojnë dhe të frenojnë abuzimet me të drejtat e njeriut, përdorimin e forcës së tepërt dhe tensionet e ndryshme më me efikasitet[115].

Personeli femëror jopolicor mund të jetë veçanërisht më efikas në përpjekjet P/K EDhRÇT dhe në mbledhjen e informacioneve shumë të rëndësishme për kërcënimet ndaj sigurisë, në kontekstet ku dallimet gjinore dhe pritshmëritë kulturore nuk i lejojnë burrat të futen në komunitete të caktuara. Në raste të tilla, ndodh edhe që efektivet vepra janë të parët që u shërbejnë viktimave femra të sulmeve terroriste. Nëse komunitet ka pasur përvojë negative me efektivët meshkuj në të shkuarën, mund të reagojë më mirë ndaj efektiveve femra pa uniformë. Përveç kësaj, gratë ka më shumë gjasa t'i denoncojnë rastet e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore (DhBSGj) te efektivet femra. Kjo mund të ndikojë te besimi që kanë komunitetet te policia dhe te drejtësisë, diçka që

---

110 *Gratë dhe Radikalizimi i Dhunshëm në Jordani* (UN Women, 2016).

111 Bigio dhe Vogelstein, *Si pjesëmarrja e grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit favorizon interesat e SHBA-së* (Këshilli për Marrëdhëniet e Jashtme, tetor 2016), fq. 4.

112 S/Res/2242 (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, 2015).

113 Peters, "Kundërvënia ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Pakistan: Pse duhet të kenë rol policet femra" (*Siguria gjithëpërfshirëse*, 2014).

114 Lonsway et al., *Punësimi dhe Mbajtja e më shumë grave: Avantazhet e Agjencive të Zbatimit të Ligjit* (Qendra Kombëtare për Gratë dhe Policimin, pranverë 2003), fq. 2.

115 Fink, Zeiger dhe Bhulai (eds.), *Një botë burrash? Eksplorimi i roleve të grave në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm* (Hedayah dhe Qendra Globale për Sigurinë e Përbashkët, 2016).

pastaj mund të ndikojë në rendimentin e punës së forcave ligjzbatuese në P/K EDhRÇT.[116]

Për më tepër, është pozitive nëse gratë shërbejnë në poste drejtuese në institucionet shtetërore përgjegjëse për P/K EDhRÇT-në, sepse kjo ndihmon që përpjekjet të ndjekin një qasje mbarëshoqërore dhe të trajtojnë në mënyrë tërësore faktorët gjinorë nxitës të EDhRÇT-së.[117] Arsyeja është se prania e grave në hartimin dhe zbatimin e strategjive, politikave dhe programeve kombëtare dhe rajonale P/K EDhRÇT janë të hapura të përfshijnë më shumë aktorë të zotë dhe të gatshëm që të ulen në tavolinën e konsultimeve. Në fund, kjo bën që këto strategji, politika dhe programe të jenë më përfshirëse.[118]

Gama e funksioneve që mund të ushtrojnë gratë përfshin të gjitha aspektet e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së[119]. Ato mund të jenë bashkëbiseduese të rëndësishme mes institucioneve qeveritare, duke përfshirë forcat e zbatimit të ligjit, duke ndihmuar në veçanti në identifikimin e shqetësimeve sa i përket sigurisë dhe nevojave që kanë komunitetet. Si anëtare të grupeve këshillimore të qytetarëve dhe të këshillave të sigurisë në nivel bashkie, gratë mund të ndërveprojnë më përfaqësuesit lokalë të zbatimit të ligjit dhe t'i paralajmërojnë ata për çështje sigurie të një natyre gjinore (siç është vënë re në Serbi[120] dhe në Shqipëri[121]).

Si pjesë e të ashtuquajturve mekanizma referimi – mekanizma formalë ose informalë ku përfshihen profesionistë të disiplinave të ndryshme dhe/ose agjencive dhe organizatave që kanë për qëllim identifikimin, vlerësimin, ndihmën, dhe trajtimin e personave që shfaqin shenja të të qenit të rrezikuar apo të cenuar nga angazhimi në EDhRÇT ose që i janë futur rrugës së EDhRÇT[122] - përfaqësuese femra të organizatave të shoqërisë civile dhe gratë nga profesione të ndryshme (për shembull, mësuese, psikologe ose drejtuese fetare) mund të ofrojnë një këndvështrim të vlefshëm për rastet e djemve dhe vajzave të rrezikuar nga përfshirja në ekstremizmin e dhunshëm. (Për një rast studimi për mënyrën se si mund të fuqizohen gratë për të marrë pjesë në mekanizmat e referimit, shih Kapitullin V). Përveç kësaj, pjesëmarrja e grave në komisionet e sigurisë së komunitetit dhe njësitë e tjera të mbikqyrjes së forcimit të ligjit e përforcojnë ndjenjën e llogaridhënies së policisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së përbashkët për sigurinë.

---

116 Miller dhe Segal, "A e përmirësojnë oficeret femra cilësinë e zbatimit të ligjit? Efektet mbi raportimin e krimit dhe përshkallëzimin e dhunës në familje" (SSRN, shkurt 2014), fq. 4.

117 Për analizën gjinore të disa strategjive kombëtare për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, shih: Fransen et al., *Analizë: Planet Kombëtare të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Një analizë gjinore e përmbajtjes* (Aleanca e Grave për Lidership në fushën e Sigurisë, Rrjeti Ndërkombëtar i Veprimit të Shoqërisë Civile, 2017).

118 *Udhëzime dhe Praktikat e Mira për Hartimin e Strategjive Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm* (Hedayah).

119 *Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Fokusi mbi Evropën juglindore* (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2018).

120 *Reforma policore: Zhvillimet në Serbi dhe Mal të Zi* (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Maj 2005).

121 "USAID kremton Përvjetorin e 20të të Panelit Këshillues të Qytetarëve të Kuçovës" (Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-së, Maj 2018).

122 Udhëzuesi i OSBE-së për mekanizmat referues, prill 2019

Falë pozicionit të tyre në zemër të komunitetit dhe të strukturave familjare, gratë janë shpesh në pozicionin më të mirë për të identifikuar, parashikuar dhe për t'iu përgjigjur pikave të dobëta që mund cenohen nga ekstremizmi[123]. Për të përfituar nga ky funksion i rëndësishëm që ushtrojnë gratë, organizatat e shoqërisë civile punojnë shpesh me gratë për t'i ndërgjegjësuar në rreziqet e përfshirjes në organizatat e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për t'i aftësuar që të dallojnë shenjat e hershme te fëmijët dhe adoleshentët të interesimit të tyre për ideologji të dhunshme. Nëse pajisen me aftësitë e nevojshme për shquarjen e këtyre shenjave, nënat mund të kontribuojnë në fazat e formimit të tyre, sa i përket edukimit dhe nxitjes së mendimit kritik që nevojitet për të krijuar pengesa ndaj ndikimeve të dëmshme.

Organizatat e shoqërisë civile kanë ngritur rrjete të shumta për komunikimin e grave në të gjithë globin (si për shembull, rrjeti i Grave dhe Ekstremizmit [WaE] i Institutit për Zhvillimin Strategjik [IST]; Gratë pa Kufij [WwB] dhe platforma e saj Motrat Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm [SAVE], Nënat për Rrjetin e Jetës, një rrjet i Institutit Gjerman për Studimet e Radikalizimit dhe Çradikalizimit [GIRDS]). Këto rrjete lehtësojnë shkëmbimin e njohurive mes grave në një sërë kontekstesh të prekura nga ekstremizmi për shembull, përmes projekteve novatore si MotherSchools, WwB mbështet trajnimin e nënave për aftësitë personale, komunikuese dhe prindëruese, në mënyrë që ato të mund të dallojnë dhe të reagojnë ndaj shenjave të hershme paralajmëruese të radikalizimit të mundshëm të fëmijëve të tyre.

Këto rrjete synojnë arritjen e një edukimi më të gjerë mbi P/K EDhRÇT-në duke shfrytëzuar aftësinë që kanë gratë për të shpjeguar si terrorizmi ndikon te dimensioni njerëzor. Kjo përdoret për ofrimin e kundërnarrativave të rëndësishme[124]. Përmes nismave të tilla të lehtësuara nga organizatat e shoqërisë civile, grave u jepet një platformë për të shkëmbyer histori për mënyrën se si fëmijët, me zgjedhjet e tyre, kanë shkatërruar jetën e vet dhe të familjes. Përmes përdorimit strategjik të internetit (faqe interneti[125], platforma ose forume[126]) dhe mediave tradicionale (si filmat[127]), këto mesazhe mund të fuqizojnë nënat dhe baballarët për të marrë masa mbrojtëse për familjet e tyre dhe për të nxitur biseda të rëndësishme rreth terrorizmit, radikalizimit dhe rëndësisë që kanë prindërit në parandalimin e tij[128].

---

123 *Praktikat më të mira për gratë dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm* (Forumi global kundër terrorizmit).

124 Roli i familjeve në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm: Rekomandime strategjike dhe opsionet e programimit (Forumi global kundër terrorizmit).

125 Për shembull, shih: http://www.stop-djihadisme.gouv.fr/

126 Për shembull, shih Motrat kundër ekstremizmit të dhunshëm (SAVE): http://womenwithoutborders-save.blogspot.com/

127 Shih: http://womenwithoutborders-save.blogspot.com/2012/09/your-mother-new-film-by-save.html

128 Radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm – fokusi tek gratë: Si radikalizohen gratë dhe si të fuqizohen ato për parandalimin e radikalizimit (Komiteti i Parlamentit Evropian për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore, dhjetor 2017).

Një aspekt i rëndësishëm për parandalimin efikas të EDhRÇT-së është edhe të kuptuarit qëartë i roleve gjinore brenda strukturës familjare në kontekste të ndryshme. Për të kuptuar rolin e grave në familje, duhet patjetër të kuptohet edhe roli i meshkujve të rritur të familjes te jeta e adoleshentëve. Modelet pozitive mashkullore dhe femërore janë të rëndësishme për orientimin adoleshentëve teksa kalojnë në moshë të pjekur. Mentorët e organizatave të shoqërisë civile mund të japin këshilla praktike dhe mbështetje emocionale për të rinjtë, marrëdhëniet e vështira familjare të të cilëve mund t'i shtyjnë ata drejt ekstremizmit dhe dhunës.

Modelet pozitive janë veçanërisht të fuqishme kur përfshijnë ish-ekstremistë. Në nisma si Jeta pas Urrejtjes dhe Dalja (SHBA),[129] disa ish-ekstremistë morën përsipër raste individuale edukimi dhe trajnimi në punë për disa persona që t'i ktheheshin jetës së tyre. Të dobishme janë edhe ndërveprimet mes të rinjve dhe personave që i kanë mbijetuar rrjeteve të dhunshme, ose atyre që i kanë dhënë fund përfshirjes në grupe të tilla (si grupet nacionaliste ose grupet neonaziste). Programe të tjera ndërhyrjesh përfshijnë ish-anëtarë bandash që kryejnë seanca mentorimi me të rinj të rrezikuar nga përfshirja në dhunën e bandave (p.sh. projekti Gang Rescue and Support [GRASP])[130].

Përvojë mjaft të gjerë kanë edhe institucionet e sigurisë që merren aktivisht me parandalimin dhe kundërvënien ndaj llojeve të tjera të aktivitetit kriminal. Prandaj, praktikat e mira të këtyre institucioneve, mësimet e nxjerra dhe integrimi në to i ndërgjegjësimit gjinor mund të përdoren në hartimin e masave efikase që respektojnë të drejtat e njeriut në kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Disa praktika të tilla analizohen në kapitullin më poshtë.

129 Shih: https://www.lifeafterhate.org/exitusa

130 Shih: http://graspyouth.org/

# Kapitulli IV: Mësimet e nxjerra rreth integrimit gjinor dhe grave në sektorin e sigurisë

Në pjesën më të madhe të vendeve, institucionet kryesore të sektorit të sigurisë janë ato që ofrohen nga shteti, si forcat e zbatimit të ligjit/policia dhe forcat e armatosura. Sektori i sigurisë (ose sistemi i sigurisë) mund të kuptohet si një sektor që përfshin të gjitha institucionet shtetërore ose njësitë e tjera që luajnë një rol në garantimin e sigurisë së një shteti apo popullatës së tij. Sigurisht që këtu përfshihen aktorët kryesorë të sigurisë, si forcat e armatosura, policia, xhandarmëria dhe roja kufitare. Por këtu përfshihen edhe organet e menaxhimit dhe mbikqyrjes së sigurisë, si parlamentet dhe komisionet parlamentare përkatëse, agjencitë dhe ministritë qeveritare, si dhe institucionet e drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës (burgjet, gjykatat, etj.). Përveç kësaj, ky sektor mund të shihet si një sektor që përfshin forcat e sigurisë pa një statut specifik, si dhe grupet e shoqërisë civile, institucionet kërkimore shkencore, organizatat fetare dhe ato të avokatësisë[131]. Në nivel lokal, zbatimi i ligjit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe më ndjeshmëri gjinore mund të bëhet kur nismat policore të orientuara nga komuniteti punojnë krah për krah me organizatat e shoqërisë civile ose kur lloje të caktuara ndryshimesh strukturore bëhen brendapërbrenda policisë me qëllim adresimin më të mirë të shqetësimeve kryesore të sigurisë, si ngritja e njësive specifike për dhunën në familje.

---

131 Për një përmbledhje të të gjithë aktorëve në sektorin e sigurisë, shih Kristin Valasek, “Reformimi i sektorit të sigurisë dhe gjinia”, në: Megan Bastick dhe Kristin Valasek (eds.), Paketa e instrumenteve të reformimit të sektorit të sigurisë dhe gjinia (Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW, 2008)

Përveç ofrimit të sigurisë për shtetet dhe institucionet e tij, sistemet e sigurisë nënkuptojnë gjithashtu edhe sigurinë e njerëzve, domethënë sigurinë njerëzore. Për njerëzit, kjo do të thotë se siguria duhet të jetë ekuivalente me të qenit të lirë dhe pa frikë (duke përfshirë këtu edhe kërcënimet nga ekstremistët e dhunshëm dhe nga grupet terroriste), si dhe të qenit të lirë nga dëshirat, gjë që përfshin aspektet ekonomike, shëndetësore dhe mjedisore. Procesi i reformimit të sektorit të sigurisë ka qenë prioritet në axhendën e qeverive dhe organizatave që prej vitit 1990. Reformimi i sektorit të sigurisë kuptohet gjerësisht si një proces politik dhe teknik i përmirësimit të sigurisë së shtetit dhe sigurisë njerëzore përmes marrjes së masave për sigurinë, menaxhimit dhe mbikqyrjes në mënyrë më efikase dhe më të përgjegjshme. Në kuadrin e kontrollit civil demokratik, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, procesi i qeverisjes/ reformimit të sektorit të sigurisë (Q/RSS) ka kontribuar për një qasje "të fokusuar më shumë te njerëzit" të sigurisë[132].

Procesi i Q/RSS është fokusuar te të gjitha institucionet e sigurisë, duke përfshirë agjencitë e zbatimit të ligjit, përmbushja e roleve të tyre, përgjegjësive dhe misioneve në nivele të larta profesionale dhe tek ofrimi i shërbimeve të mira për të gjithë popullatën, pavarësisht gjinisë, besimit fetar, etnisë apo moshës. Ky proces ka përfshirë gjithashtu edhe pritshmëri të qarta për institucionet e sigurisë, sa i përket përgjegjshmërisë së tyre në marrjen e masave, menaxhimit dhe mbikëqyrjes së tyre, duke qenë se autoritetet e pavarura pritet të mbikqyrin nëse përmbushen këto pritshmëri.

## 1) Zbatimi gjithëpërfshirës i ligjit dhe parandalimi dhe kundërvënia ndaj EDhRÇT-së

Metodat gjithëpërfshirëse dhe siguria me fokus njerëzit nga ana e agjencive të zbatimit të ligjit ndihmojnë në adresimin e një sërë problemesh që mund të ekzistojnë mes një shoqërie dhe sektorit të saj të sigurisë. Disa prej këtyre problemeve lidhen drejtpërdrejt ose krijojnë drejtpërdrejt kushte të favorshme për EDhRÇT-në: korrupsioni dhe shkeljet e të drejtave të njeriut nga personeli i sektorit të sigurisë, mungesa e aftësive të tyre teknike apo sociale, si dhe mangësitë në llogaridhënie dhe mbikqyrje në një masë të madhe në këtë sektor[133]. Dy prej faktorëve të rëndësishëm për këtë janë:

132 Shih për shembull: https://www.un.org/ruleoflaw/thematic-areas/access-to-justice-and-rule-of-law-institutions/ssr/

133 Për një ekzaminim të thelluar të lidhjeve mes ekstremizmit të dhunshëm dhe abuzimeve të sektorit të sigurisë, shih UNDP 2017, "Udhëtim drejt ekstremizmit në Afrikë: Drejtuesit, Nxitësit dhe pika e kthesës për rekrutimin". Gjendet në: https://journey-to-extremism.undp.org/content/downloads/UNDP-JourneyToExtremism-report-2017-english.pdf

- Nëse policia shihet apo jo si e besueshme, nëse i përmbahet ligjit (nocioni i shërbimit policor **të besueshëm dhe në përputhje me të drejtat e njeriut**), dhe

- Nëse policia është në gjendje të adresojë në mënyrë efikase nevojat për siguri të një popullate të tërë dhe nëse i shërben të gjithë komunitetit si një i tërë (parimi i **policimit efikas dhe të orientuar nga komuniteti**).

### Respektimi i të drejtave të njeriut

**Mes policimit dhe të drejtave të njeriut nuk ka dhe nuk mund të ketë negocim.** Ndonëse policia është shpesh e para që i përgjigjet dhunës, ajo kryen edhe punë parandaluese, duke përfshirë këtu edhe komunikimin sistematik me komunitetet. Nëse policia gëzon besimin e komunitetit dhe nëse ndërton marrëdhënie të mira me ta, komuniteti mund të jetë një kontribues i rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Në kontekstin e parandalimit dhe kundërvënies ndaj EDhRÇT-së, mundet që anëtarët e një komuniteti të përjetojnë shkelje të të drejtave të njeriut për shkaqe raciale/etnike apo gjinore nga zyrtarët e zbatimit të ligjit. Praktikat e mira të adresimit të shkeljeve të tilla përfshijnë punën e mekanizmave të pavarur të të drejtave të njeriut dhe të grupeve të interesit që janë në pozicion të përshtatshëm për ta këshilluar dhe për ta mbështetur policinë. Edhe linjat e hapura të komunikimit mes komunitetit në fjalë dhe policisë lokale janë po ashtu të rëndësishme. Përveç kësaj, një ekip i larmishëm i oficerëve të policisë së vijës së parë duke përfshirë si gra, ashtu edhe burra, si dhe oficerë që vijnë nga grupmosha të ndryshme, formime të ndryshme etnike dhe fetare, e zbusin rrezikun e të vepruarit të oficerëve të policisë mbi bazë steriotipesh.

Në vitin 2017, Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Ontario, Kanada, i kërkoi Policisë së Torontos të vërë në dispozicion mbi 7 vjet të dhëna për ndërveprimet me komunitetin me ngjyrë, ku përfshihen praktikat e ndalimit dhe marrjes në pyetje, përdorimin e forcës dhe arrestimet për arsye të thjeshta si kapja me drogë, pengimi ose dhunimi i një efektivi policie, prishja e rendit publik ose shkelja e lirimit me kusht. Në vitin 2010, gazeta e përditshme *Toronto Star* raportonte se pjesëtarët e komunitet me ngjyrë kishin më shumë gjasa të ndaloheshin për verifikim - pra, kur policia ndalon pa shkak personin dhe i kërkon dokument identifikimi.

(Nga *Toronto Star*, 30 nëntor 2017, https://www.thestar.com/news/crime/2017/11/30/human-rights-commission-launching-inquiry-into-racial-profiling-by-toronto-police.html)

Policimi i besueshëm në shkallë komuniteti është i rëndësishëm në forcimin e qëndresës së publikut ndaj narrativave të grupeve të ekstremistëve të dhunshëm, të cilat shpesh përdorin padrejtësi reale ose të perceptuara, shkelje të të drejtave të njeriut dhe korrupsionin e aktorëve të sigurisë për të fituar mbështetjen e komuniteteve lokale. Në fakt, studimet kanë treguar se këto probleme të prodhuara nga abuzimet e sektorit të sigurisë ndaj popullatave dhe nga korrupsioni institucional janë faktorë të rëndësishëm shtytës në shumë kontekste[134]. Eliminimi i këtyre abuzimeve me të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe DhBSGj-në nga personeli i policisë apo personeli i sektorëve të tjerë të sigurisë është në këtë mënyrë i një rëndësie të jashtëzakonshme.

Aktivitetet e përbashkëta mes policisë dhe institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut, si organizatave të shoqërisë civile si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel kombëtar, mund të shkojnë nga adresimi i funksionimit të strukturave të brendshme të mbikqyrjes së policisë, ofrimi i trajnimeve për të drejtat e njeriut dhe vlerësimi i kulturës institucionale të policisë dhe aftësisë së saj për të punuar për të sjellë ndryshime[135].

### Policimi efikas dhe i orientuar nga komuniteti

Policimi i orientuar nga komuniteti fokusohet te krijimi i besimit dhe i partneriteteve mes policisë, autoriteteve të tjera publike dhe komuniteteve, besimit që mund të çojë në zgjidhjen proaktive të problemeve. Ky është një instrument i domosdoshëm në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Ai adresohet në mënyrë të hollësishme në publikimin e OSBE-së *Parandalimi i terrorizmit dhe kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Metoda e policimit në komunitet*[136].

Për të qenë efikas, policimi i orientuar nga komuniteti duhet të shndërrohet në një qëndrim dhe filozofi që përshkon gjithë kulturën dhe praktikën e të gjithë shërbimit, nga niveli i lartë drejtues deri tek oficerët bazë. Në praktikë, kjo mund të çojë në qytetarë të aftë për të komunikuar me policinë në mënyrë më komode. Kjo do të thotë gjithashtu se ka avantazhe nëse oficerët e policisë punojnë në komunitete afër me familjet e tyre, nëse flasin gjuhën e këtyre komuniteteve dhe nëse reflektojnë larminë e komuniteteve, të cilave iu shërbejnë (për shembull, sa i përket etnisë, besimit fetar dhe gjinisë). Qëllimi është krijimi i besimit me qëllim rritjen e sigurisë së komuniteteve lokale.

134 Për studimet më të fundit të ndikimeve të reagimeve të ashpra të sistemit të drejtësisë penale mbi ISIS/Daesh, shih Kristen Kao dhe Mara Redlich Revkin, "Të dënohet apo të falet? Riintegrimi i bashkëpunuesve të rebelëve pas konfliktit në Irak" (Programi për qeverisjen dhe zhvillimin lokal në Gotenburg). Gjendet në: https://gld.gu.se/media/1503/gld-working-paper-17-final.pdf

135 Për një përmbledhje të projekteve të përbashkëta të këtij lloji, shih faqen e internetit të Komisionit të të Drejtave të Njeriut të Ontarios. Gjendet në: http://www.ohrc.on.ca/en/about-commission

136 Shih edhe kutinë e tekstit në faqen e mëposhtme. Për informacionet të përgjithshme më të thelluara, si dhe për raste studimore në rajonin e OSBE-së, shih Manuali për Parandalimin e Terrorizmit dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që çon në Terrorizëm: Qasja e policimit në komunitet, (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Vjenë, shkurt 2014).

Studimet për policimin e orientuar nga komuniteti në fushat me larmi fetare si Irlanda e Veriut, tregojnë se toleranca ndaj besimeve të ndryshme fetare rrit bashkëpunimin e komunitetit me policinë[137]. Po kështu, Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara ka hartuar një sërë studimesh kërkimore që kanë konstatuar se kur diversiteti rritet në agjencitë e zbatimit të ligjit, duke përfshirë diversitetin sa i përket racës, etnisë dhe gjinisë, kjo ndihmon në krijimin e besimit te policia dhe ul perceptimet negative për ta[138].

Departamenti i Sigurisë i Shteteve të Bashkuara (DHS), Zyra e të Drejtave Civile dhe Lirive Civile thekson provat nga Minneapolis, ku banorët me origjinë afrikano-lindore nuk kishin besim te forcat e zbatimit të ligjit të qytetit. Mes arsyeve të tjera për këtë mosbesim ishte edhe mungesa e diversitetit në këtë polici sa i përket racës, besimit fetar dhe etnisë. Disa nga këto tensione u ulën kur për sigurinë në aeroporte dhe në polici u punësuan punonjës me origjinë somalezo-amerikane[139]. Ky shembull, si edhe shembuj të tjerë që përshkruhen me hollësi në këtë udhëzues, tregojnë vlerën operacionale të diversitetit nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Ky diversitet rrit besueshmërinë e këtyre agjencive, si dhe efikasitetin e tyre operacional.

137 Topping, J. & Byrne, J., "Policimi hije: kufijtë e "policimit" të bazuar në komunitet në Irlandën Veriore", Policimi dhe shoqëria 26.5 (2014), fq. 522-543.

138 Favorizimi i diversitetit në zbatimin e ligjit (Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara, Komisioni për Mundësi të Barabarta të Punësimit, tetor 2016), fq. 7–9. Gjendet në: https://www.justice.gov/crt/case-document/file/900761/download

139 Farah, A., Intervistë me Zyrën e DHS të të Drejtave Civile dhe Lirive Civile (Uashington D.C., 2017).

# 2) Integrimi gjinor në sektorin e sigurisë dhe parandalimi dhe kundërvënia ndaj EDhRÇT-së

Integrimi i këndvështrimit gjinor përbën një pjesë kyçe të garantimit të legjitimitetit dhe efikasitetit operacional të sektorit të sigurisë. Për nxjerrjen e mësimeve sa i përket integrimit të përkatësisë gjinore në Q/RSS dhe për të shqyrtuar se çfarë nënkuptojnë ato për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, objektivat dhe fushat e mëposhtme të ndërhyrjeve në Q/RSS do të shqyrtohen më nga afër;



# 2.1 Integrimi gjinor: objektivat kyçe për aktorët e sigurisë

**“**
***Përvojat nga operacionet e mëparshme tregojnë se nëse jemi në gjendje të zbatojmë perspektivën gjinore në përputhje me RKSKB 1325/2000, do të kemi më shumë shanse për të pasur sukses në misionin tonë, për të sjellë paqen dhe sigurinë në të gjithë shoqërinë e zonës sonë të operimit.”***
**”**

– Toger Anders Lindström, Drejtor i Operacioneve, Forcat e Armatosura Suedeze.

### Efikasiteti operacional i agjencive të zbatimit të ligjit

Një objektiv kryesor për të gjithë personelin e sektorit të sigurisë është efikasiteti i punës. Për oficerët e zbatimit të ligjit, kjo do të thotë që të jenë të aftë të ofrojnë siguri dhe drejtësi për të gjithë popullatën në zonën ku ata operojnë. Për ta bërë këtë, duhet të kuptojnë nevojat e ndryshme që kanë burrat, gratë, djemtë dhe vajzat për siguri dhe drejtësi, si dhe mënyrat e ndryshme në të cilat ata e perceptojnë sektorin e sigurisë dhe ndërveprojnë me të, sidomos sistemin e drejtësisë penale dhe policinë. Njohja e këtyre dallimeve dhe të qenit të aftë për t’i adresuar ato, kërkon që personeli i zbatimit të ligjit t’i ketë të qarta nevojat dhe dinamikat gjinore në shoqërinë ku jetojnë.

Si provat e rastësishme, ashtu edhe ato empirike, tregojnë se gratë mund të kontribuojnë në forcimin e ndërgjegjësimit në përgjithësi rreth përpjekjeve të sigurisë, sidomos në situata të veçanta[140]. Përmes pozicionit që ato mbajnë në komunitet dhe në familje, gratë kanë shpesh njohuri të dorës së parë për njerëz dhe për ngjarje, akses që burrat nuk e kanë. Disa shembuj përfshijnë njohuritë që mbledhin gratë përmes rrjeteve informale dhe sociale, si dhe përmes marrëdhënieve të tyre me fëmijët e vet.

Po kështu, në shumë raste, anëtarët meshkuj të familjeve kanë marrëdhënie më të drejtpërdrejta me burrat dhe djemtë e familjeve të tyre. Edhe ky është një faktor që tregon nevojën për ndërgjegjësim të plotë gjinor për të qenë në gjendje të dallojmë ndryshimet që mund të jenë të dëmshme dhe ndikimet potencialisht të dëmshme në shoqëri, sidomos te fëmijët dhe te të rinjtë.

---

140 Për një bazë gjithëpërfshirëse informacioni të pjesëmarrjes së grave në përpjekjet për paqe siguri, shih “Studim global për zbatimin e UNSCR 1325”, 2015. Gjendet në: http://wps.unwomen.org/
Për disa shembuj, shih Tobie Whitman dhe Jacqueline O’Neill, “Vëmendja ndaj gjinisë rrit sigurinë në operacione: Shembuj nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO)”. Gjendet në: https://www.inclusivesecurity.org/wp-content/uploads/2013/05/NATO-Report_8.pdf

Policimi me ndjeshmëri gjinore mund të rrisë aksesin në të gjithë komunitetin. Në shumë raste, gratë raportojnë krime të caktuara dhe i shprehin më lehtë shqetësimet te oficeret femra të policisë[141], që do të thotë se të pasurit e një numri të madh oficeresh femra është shumë i rëndësishëm. Kur vjen fjala te EDhRÇT-ja, ajo çka është e rëndësishme është që si oficerët meshkujt, ashtu edhe oficeret femra të policisë t'i kuptojnë dinamikat gjinore dhe mënyrën se si ato paraqiten veçanërisht në komunitet, si dhe nevojat e ndryshme të burrave dhe të grave.

### Analiza gjinore që kontribuon për patrullime dhe lidhje më efikase me komunitetin

Me një shembull nga Afganistani, një patrullë e përbërë vetëm nga meshkuj si pjesë e Ekipit suedez të Rindërtimit të Provincave iu drejtua këshilltarit gjinor të ekipit për të kuptuar se përse nuk shihnin kurrë gra afgane në publik. Këshilltari gjinor i pyeti nëse ushtarët meshkuj patrullonin sistematikisht dhe u sugjeroi që të provonin të patrullonin edhe në rrugët jo aq të ngarkuara. Shumë shpejt, patrulla filloi të ndeshej me gra vendase, të cilat edhe iu afruan ekipit. Kjo ndodhi pavarësisht faktit që ekipi përbëhej vetëm nga meshkuj. Në një rast, disa gra iu afruan patrullës dhe pas një bisede të shkurtër e ftuan atë në shtëpi për t'u takuar me anëtarët meshkuj të familjeve të tyre.

Kur mbërritën në shtëpi, gjatë bisedës duke pirë çaj, doli çështja e "diçkaje që ato prisnin të ndodhte". Gratë i thanë ekipit se ato do të kishin së shpejti në një dasmë të madhe që do të zhvillohej në qytet pas dy ditësh. Në qytet do të vinin për të festuar qindra familjarë dhe të afërm. Këtë nuk e përmendi asnjë prej meshkujve të familjes.

Informacioni i lidhur me një ngjarje të tillë ishte i rëndësishëm për përforcimin e gatishmërisë së ushtarëve. Kur pas 48 orësh mbërritën qindra vetë, misioni ishte në dijeni, i priste dhe ishte në gjendje të hartonte një plan për monitorimin e qarkullimit të tyre. Duke e ditur se shkaku për këtë ishte dasma, mundi të parandalohej edhe një përshkallëzim i mundshëm i tensioneve. Nëse misioni nuk do të ishte vënë në dijeni të qëllimit të thjeshtë të kësaj ngjarjeje, ata mund ta kishin interpretuar lehtësisht këtë lëvizje të madhe personash si një taktikë kryengritjeje apo si një formë tjetër agresioni. Kjo mund të kishte çuar më pas në dhunë si dhe në rrezikun afatgjatë të mosbesimit ndaj komuniteti te ky mision.

Ndonëse shembulli në kutizën e mësipërme flet për një vend me një rrezik të shtuar ndaj sigurisë, ku siguria ofrohet nga forcat e armatosura, përfundimi që mund të nxirret nga ky rast është se burrat dhe gratë kanë shpesh këndvështrime të ndryshme dhe se për këtë arsye japin edhe lloje të ndryshme informacionesh. Këto informacione mund të lidhen edhe me sigurinë.

141 Për një studim të kohëve të fundit mbi raportimet në polici për dhunën seksuale në Shtetet e Bashkuara, shih: https://news.virginia.edu/content/study-hiring-female-police-officers-helps-women-report-violence-sexual-assault

Në një tjetër shembull nga policia e distriktit të Oslos në Norvegji, policia vizitonte rregullisht xhamitë dhe tempujt *Sikh* me qëllim që të fitonte besim dhe të ndërtonte marrëdhënie të forta me komunitetet e ndryshme të pakicave në këtë qytet. Pas fillimit të këtij programi, oficerët e policisë kuptuan se ndonëse oficerët meshkuj pranoheshin shpejt dhe mund të takoheshin me anëtarët e vjetër në moshë meshkuj të komunitetit, liderët fetarë dhe të pranishmit (meshkuj) e rregullt të xhamive, atyre u duhej të kishin në ekip edhe oficere femra që të komunikonin me të gjithë popullatën. Për vite me radhë, dy prej oficerëve të policisë për diversitetin që punuan në mënyrë specifike për policimin parandalues dhe për të fituar besimin e komuniteteve të pakicave në Oslo kanë qenë gra. Policia ka bërë përpjekje për të ndjekur ngjarje të rëndësishme të komunitetit dhe për të vizituar qendrat e tyre kulturore, gjë që ndihmon për të treguar interesimin e tyre për mirëqenien e komunitetit (për një përshkrim të plotë të punës së policisë së Oslos, shih rastin në Kapitullin V).

Nisma të tilla nuk ndërmerren domosdoshëmrisht për shkak të ndonjë kërcënimi specifik ndaj sigurisë në këto komunitete, por si një përpjekje për të fituar besimin e qytetarëve dhe për t'u siguruar se qytetarët e këtyre komuniteteve e dinë se ku të drejtohen nëse kanë nevojë për ndihmën e policisë. Përveç kësaj, kjo ndihmon edhe në uljen e frikës nga autoritetet që ekziston mes disa popullatave të pakicave për shkak përvojave të tyre negative në të kaluarën me personelin e sigurisë. Kështu, nëse ndonjë anëtar i këtyre komuniteteve të pakicave ka ndonjë shqetësim në lidhje me EDhRÇT-në apo për ndonjë sjellje tjetër kriminale, ata ndihen të sigurt për t'ia komunikuar këtë policisë lokale.

Këta shembuj tregojnë nevojën për të qenë në gjendje për të komunikuar si me burrat, ashtu edhe me gratë, me djemtë dhe me vajzat, jo vetëm për të pasur një tablo të qartë të nevojave të tyre të ndryshme të sigurisë me qëllim adresimin e tyre, por edhe për të ndërtuar marrëdhënie besimi me te gjithë anëtarët e komunitetit. Ndonëse kjo mund të rezultojë e vështirë në varësi të kontekstit kulturor apo social, këta shembuj vërtetojnë gjithashtu se përfshirja e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimit gjinor në punën e përditshme të policisë është e mundur edhe në shoqëritë që perceptohen si konservatore.
Çdo kontekst lokal apo kombëtar duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe me shumë kujdes. Ndërkohë që te shembulli nga Afganistani, ekipi i përbërë vetëm nga meshkuj nuk pati ndonjë vështirësi për t'u takuar me gra lokale afgane, sapo ndryshuan itinerarin e tyre të patrullimit, policia e Oslos kuptoi se oficeret femra ishin përgjithësisht më të përshtatshme për të folur me gratë që frekuentonin xhamitë.

### Përfaqësimi në shifra dhe nxitja e ndërgjegjësimit

Shembulli nga policia e Oslos tregon se si policia (dhe sektori i sigurisë në përgjithësi) mund të përfaqësojë popullsinë së cilës ajo i shërben. Në fakt, kërcënime ndaj sigurisë dhe krimet kryhen kundër çdo shtrese të shoqërisë. Megjithatë, policia në të gjithë zonën ku shtrihet OSBE-ja vazhdon të dominohet nga meshkujt, duke pasur një përfaqësim jo të mirë të grave dhe të grupeve të pakicave.

Policia si profesion është konsideruar prej kohësh si një profesion "mashkullor". Ky është një steriotip gjinor dhe vjen për shkak të perceptimit të policisë si një institucion që merret me krimin, rrezikun dhe që kërkon forcë fizike[142]. Duke u fokusuar më shumë te policimi i në komunitet, studimet tregojnë se profili mashkullor (i cili ndikon edhe tek ajo çka një person dëshiron të jetë dhe dek dëshira për t'u rekrutuar në polici) po ndryshon dalëngadalë drejt cilësive dhe aftësive si durimi, dhembshuria, komunikimi dhe aftësitë për të bashkëpunuar me të tjerët për zgjidhjen e problemeve[143]. Sipas Qendrës Kombëtare për Gratë dhe Policimin në Shtetet e Bashkuara, oficeret gra marrin vlerësime më të mira dhe më pak ankesa nga qytetarët, gjë që u jep atyre mundësinë të jenë në një pozicion më të mirë për të zhvilluar policimin në komunitet[144].

Të pasurit e një numri të madh grash në institucione ka treguar se ndikon te ndërgjegjësimi gjinor institucional. Rritja e numrit të oficereve gra në polici ka efektin e shtuar të rritjes së gjasave që të raportohen dhe të hetohen më shumë krimet e DhBSGj-së[145].

Në kontekstin e parandalimit të EDhRÇT-së, të kuptuarit dhe të reaguarit si duhet ndaj DhBSGj-së, duke përfshirë edhe ndaj dhunës së partnerëve intimë, mund të jenë të domosdoshme për parandalimin e krimeve të tjera të dhunshme.

Autorët e sulmeve në Orlando, Uestminster dhe Nisë, si dhe bombëvënësit në Maratonën e Bostonit, kishin pasur histori abuzimesh intime në familje. Seung-Hui Cho, i cili qëlloi dhe vrau 32 persona në Institutin Politeknik të Virxhinias në vitin 2007, ishte akuzuar më parë për përndjekje dhe ngacmime të studenteve.

Edhe i krishteri ungjillor Robert Lewis Dear që qëlloi dhe vrau tre persona në një klinikë shëndetësore grash në vitin 2015, kishte pasur histori dhune dhe abuzimesh në familje. Dylann Roof, supremacisti i bardhë që vrau nëntë persona në Çarlston në vitin 2014, mendohet se është rritur në një shtëpi me dhunë në familje.

Në rastin e Anders Behring Breivik në Norvegji, raportet e psikologëve nga fëmijëria e tij e hershme tregojnë për abuzime fizik dhe psikologjike dhe se për rritje në familje me "sjellje të seksualizuara". (https://www.tv2.no/a/8241631/ )

142 S.E. Martin dhe N.C. Jurik, "Natyra e punës së policisë dhe hyrja e grave në zbatimin e ligjit" tek: *Të bërit e drejtësisë dhe barazisë gjinore: Gratë në pozicione pune ligjore dhe në drejtësinë penale*, botimi i 2të (Botimet Sage, 2006).

143 Lorene M. Sandifer, "Ushtrimi i forcës policore: A përbën ndryshim gjinia?", tezë e pabotuar masteri, Universiteti i Teksasit në Arlington, 2006.

144 Qendra Kombëtare për Gratë dhe Policimin, 2006.

145 Në të njëjtin burim.

Siç tregojnë edhe gjetjet e mëposhtme, një sërë autorësh të EDhRÇT ose mbartin trauma që nga fëmijëria për shkak të ekspozimit ndaj dhunës në familje dhe/ose kanë kryer abuzime ndaj partnerëve intimë ose anëtarëve të tjerë të familjes, duke e bërë përdorimin e dhunës të duket si një reagim normal për zgjidhjen e konflikteve. Të dhënat për të shtënat masive në Shtetet e Bashkuara nga viti 1999 deri në 2013, duke përfshirë edhe disa raste që lidhen edhe me EDhRÇT-në[146], tregojnë se në rreth një të pestën e të gjitha këtyre të shtënave masive kanë ndikuar mosmarrëveshje të caktuara[147].

Theksimi i këtyre konstatimeve në diskutimet rreth rëndësisë së institucioneve përfaqësuese në institucionet e sigurisë nuk nënkupton se oficeret e policisë gra janë më të përshtatshme për t'iu përgjigjur rasteve të DhBSGj-së, duke përfshirë edhe dhunën e ushtruar nga partnerët intimë apo nga anëtarët e tjerë të familjes. Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse viktimat femra mund të ndihen më të prirura që t'i raportojnë incidentet e dhunës seksuale apo dhunës në familje te gratë (siç mund të bëjnë edhe burrat, për shkak të frikës së stigmatizimit), që të thuash se gratë janë ato që duhet të merren me "çështjet e grave" apo që gratë janë nga natyra eksperte për çështjet gjinore do të kishte efektin e kundërt. Si gratë dhe burrat duhet që të përfshihen në të gjitha institucionet e sektorit të sigurisë për shkak të profesionalizmit dhe ekspertizës dhe jo për shkak të gjinisë së tyre. Në përgjithësi, kjo do të kontribuojë në optimizimin e aftësive të organizatave të sigurisë për t'iu përgjigjur *të gjithë* publikut, si dhe për ta bërë më të mundur komunikimin mes qytetarëve dhe komuniteteve dhe aktorëve të sigurisë.

Çdo përpjekje për të rekrutuar më shumë gra duhet të shoqërohet me ndryshime kulturore dhe strukturore në institucionet përkatëse. Fokusimi te rritja e numrit të oficereve gra nuk mjafton. Në kuadrin e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së, grave duhet t'u jepen mundësi profesionale për t'u zhvilluar në karrierë, në mënyrë që edhe ato të mund të bëhen pjesë e pandashme e proceseve vendimmarrëse që ndikojnë te strategjitë parandaluese ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe pjesë e hartimit të nismave të përshtatshme për t'iu kundërvënë këtyre fenomeneve

---

146 "Gjuajtje masive" i referohet "një incidenti të shumëfishtë vrasjeje, në të cilin u vranë katër ose më shumë viktima me armë zjarri, në një event dhe në një ose më shumë vende në afërsi me njëri-tjetrin. Krouse dhe Richardson, "Përmbledhje" tek: *Vrasjet masive me armë zjarri: Incidentet dhe viktimat*, 1999-2013 (Shërbimi Studimor i Kongresit i Shteteve të Bashkuara, 30 korrik 2015, R44126).

147 Po aty, fq. 29.

### Integrimi gjinor dhe profesionalizimi i forcave të zbatimit të ligjit

Sjellja dhe qëndrimi profesional i kombinuar me aftësitë dhe njohuritë teknike në lidhje me punën janë vendimtare për personelin e sigurisë që është në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të përditshme me krimin. Mbështetja e forcimit të aftësive dhe njohurive është shpesh e nevojshme në një sërë fushash. Këtu përfshihet njohja e legjislacionit dhe parimeve që rregullojnë sektorin e sigurisë, si dhe njohja e kuadrit kombëtar dhe ndërkombëtar të të drejtave të njeriut që ka rëndësi për punën e forcave të zbatimit të ligjit.

Në Berlin, Qendra e Ekspertëve për Ekstremizmin Gjinor dhe Ekstremizmin e Djathtë pranë Fondacionit “Amadeu Antonio” është përqendruar te trajnimi i policisë në çështjet gjinore dhe te ekstremizmi i djathtë. Hapja e kësaj qendre daton që në vitin 2007 dhe ka për qëllim “forcimin e shoqërisë demokratike qytetare dhe eliminimin e ekstremizmit neonazist, ekstremizmit të djathtë, antisemitizmit dhe formave të tjera të diskriminimit dhe urrejtjes në Gjermani.”

Qendra e ka zanafillën në një projekt vendor në shtetin federal Meklenburg-Vorpomern në lindje të Gjermanisë, që u quajt “Lola für Lulu”. Projekti synonte të inkurajonte gratë dhe vajzat që të angazhohen në proceset politike nga pikëpamja feministe, me fokus forcimin e proceseve të shoqërisë civile në strukturat demokratike.

Për më shumë informacion (në gjuhën gjermane), shih http://www.lola-fuer-lulu.de/wir-ueber-uns/fachstelle-gender-und-rechtsextremismus/

Përveç kësaj, oficerët e policisë si dhe punonjësit e tjerë të sektorit të sigurisë që punojnë në kontakt të drejtpërdrejtë me përdoruesit e këtyre shërbimeve, si punonjësit e gjykatave dhe të burgjeve, duhet të trajnohen për të zhvilluar të menduarin kritik, analizimin e konflikteve, empatinë, aftësitë komunikuese dhe aftësi të tjera sociale.

Përveç nismave të tjera të integrimit gjinor, si mbështetja e rekrutimit dhe mbajtja në punë e grave në sektorin e sigurisë dhe në hartimin të politikave me ndjeshmëri gjinore, nevojitet edhe trajnimi për barazinë gjinore për t’u garantuar që të gjithë aktorët e sektorit të sigurisë janë të aftë për të ofruar siguri dhe drejtësi në mënyrë efikase dhe për të krijuar një atmosferë pune të respektueshme që nxit të drejtat e barabarta. Po aq i rëndësishëm është edhe trajnimi specifik për barazinë gjinore, si trajnimi për të kuptuar ngacmimet seksuale dhe mënyrën e parandalimit dhe adresimit të tyre[148].

148 Studimi ka treguar se ndikimi financiar i ngacmimit seksual në institucione është i madh. Në këtë ndikim përfshihet humbja e produktivitetit, rënia e moralit, mungesa në punë dhe rritje e qarkullimit të stafit. Ngacmimi seksual pengon gjithashtu integrimin efektiv dhe të qëndrueshëm të grave në institucionet e sigurisë.

Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve për ndërgjegjësimin gjinor mund të zhvillohen nga vetë institucionet e sektorit të sigurisë (si për shembull, nga akademitë e policisë), të organizohen nga organizatat ndërkombëtare të specializuara për trajnimin e forcave të zbatimit të ligjit ose nga OJQ-të lokale ose ndërkombëtare. Në ofrimin e trajnimeve për ndërgjegjësim gjinor për policinë, përfshirja e OJQ-ve lokale të grave, të cilat shpesh kanë zhvilluar ekspertizë në fusha të caktuara, si për shembull në mbështetjen e viktimave të DhBSGj-së, mund të jetë instrumentale.

Në Gjeorgji, një nismë e financuar nga BE-ja në mars 2018 përgatiti një analizë gjinore të plotë në sektorin e sigurisë. Kjo analizë kishte për objektiv që t'i ofronte fakte dhe shifra Komisionit Parlamentar të Sigurisë dhe Mbrojtjes me qëllim që anëtarët e tij të kishin parasysh aspektet gjinore në mbajtjen e seancave dëgjimore vjetore me Ministrin e Brendshëm dhe Ministrin e Mbrojtjes.

Gjithashtu, anëtarët e komisionit mund të shfrytëzonin vlerësimin e ndikimit gjinor, një instrument ky që ishte zhvilluar nga Këshilli për Barazi Gjinore brenda parlamentit. Instrumenti konsistonte në disa tregues që masnin se si politikat dhe ligjet specifike ndikojnë te burrat dhe gratë, por edhe se si këto politika mund të përdoren për të promovuar barazinë gjinore.

Kjo analizë gjinore ishte një raport i brendshëm i hartuar nga kryeautori i udhëzuesit. Për më shumë informacion mbi instrumentin e vlerësimit të ndikimit gjinor, shih (në anglisht) http://www.parliament.ge/en/parlamentarebi/deputy-chairmen/tamar-chugoshvili/news1/kanonmdeblobis-genderuli-gavlenis-shefaseba.page

Në kuadrin e ndalimit të EDhRÇT-së, një numër i konsiderueshëm OSHC-sh – lokale dhe ndërkombëtare – kanë përvojë në mbështetjen e sektorit të sigurisë me trajnime për komunikimin me komunitetin dhe për punë të natyrave të tjera parandaluese. **Përfshirja e OSHC-ve në trajnimin e forcave të zbatimit të ligjit për EDhRÇT-në jo vetëm që i jep policisë një këndvështrim qytetar mbi kërcënimin që përbën radikalizimi që çon në terrorizëm për grupe të caktuara dhe për mënyrën e adresimit të tij, por e bën edhe më të besueshëm sektorin e sigurisë në sytë e popullatës, së cilës ka detyrën t'i shërbejë**[149]**. 3) Çfarë mund të mësojmë nga reformimi i sektorit të sigurisë**[150]

149 Për më shumë informacion mbi trajnimin gjinor për sektorin e sigurisë, shih Toiko Tõnisson Kleppe, "Trajnimi gjinor për personelin e sektorit të sigurisë – praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra," në: Megan Bastick dhe Kristin Valasek (eds.) *Paketa e instrumenteve të reformimit të sektorit të sigurisë dhe gjinia* (Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW 2008), Gjendet në: https://dcaf.ch/gender-training-security-sector-personnel-good-practices-and-lessons-learned-tool-12

150 Reformimi i mbrojtjes është pjesë përbërëse e SSR dhe po aq e rëndësishme sa reforma në polici dhe drejtësi për të garantuar transformimin efektiv dhe të qëndrueshëm afatgjatë të të gjithë sistemit. Për qëllime të këtij manuali dhe të audiencës së tij kryesore të synuar, megjithatë nuk është përfshirë një kapitull i veçantë mbi gjininë dhe reformën në mbrojtje. Për më shumë informacion mbi temën, shih Cheryl Hendricks dhe Laura Hutton, "Reformimi i mbrojtjes dhe Gjinia". Gjendet në: https://www.files.ethz.ch/isn/143082/Tool%2003_Defense%20Reform%20and%20Gender.pdf

## Integrimi gjinor në reformimin e policisë

Është detyrë e policisë që të ruajë rendin publik dhe të mbrojë njerëzit dhe pronën e tyre nga aktet kriminale. Kjo detyrë përfshin edhe mbrojtjen e grave dhe vajzave, por, megjithatë, pak vëmendje i është kushtuar marrjes së masave që edhe gratë të jenë pjesë e shërbimeve të policisë, si në vijën e parë të reagimit, ashtu edhe në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse. Integrimi gjinor në punën e policisë përbën një domosdoshmëri operacionale për krijimin e një komunikimi më të mirë si dhe krijimin e një besimi dhe aksesi më të madh.

Reformimi apo zhvillimi i policisë është një mundësi për integrimin e aspektit gjinor në të gjitha aktivitetet dhe proceset e Q/RSS-së, duke përfshirë edhe zhvillimin e politikave të shëndosha institucionale dhe protokolleve dhe procedurave operacionale, ofrimin e mundësive për trajnim dhe rritje kapacitetesh, si dhe për ndryshime strukturore, si ngritjen e njësive për trajtimin e DhBSGj-së dhe dhunës së ushtruar nga partnerët intimë dhe anëtarët e familjes[151].

Në kuadrin e objektivave kyçe të Q/RSS-së janë theksuar disa praktika të mira të integrimit gjinor në punën e policisë: përpjekjet për rritjen e efikasitetit operacional, ndërtimi i institucioneve përfaqësuese, si dhe profesionalizimi i shërbimit përmes njohurive dhe rritjes së kapaciteteve.

Të tjera mësime janë nxjerrë edhe nga integrimi i aspektit gjinor në politikat dhe procedurat institucionale, si dhe nga mbështetja e integrimit gjinor në mekanizmat efiçentë të mbikqyrjes qytetare (shih kutizën me shembullin nga Gjeorgjia).

Aspektet gjinore luajnë një rol po aq instrumental në zbatimin e qasjeve të policimit me bazë komunitetin. Kur qasje të tilla janë pjesë e reformimit të policisë, është e domosdoshme që aspekti gjinor të integrohet në to që prej fillimit. Këtu përfshihet garantimi i vullnetit dhe mbështetjes politike nga nivelet e larta drejtuese, si dhe garantimi i fondeve specifike për projektet që fokusohen te ndërgjegjësimi i integrimit gjinor.

## Integrimi gjinor në reformën e drejtësisë penale

Drejtësia dhe siguria janë të lidhura pazgjidhshmërisht. Një sektor i fortë drejtësie mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe frenon dhunuesit e mundshëm. Ashtu sikurse mund të variojnë nevojat për siguri, variojnë edhe përvojat me sistemet e drejtësisë, si dhe shkalla e efiçencës së funksionimit të tyre – e cila mund të ndryshojë ose jo. Për shembull, gratë ndeshen me pengesa në përpjekjet për akses në drejtësi, kurse burrat kanë më shumë gjasa të

151 Për më shumë informacion mbi gjininë dhe reformën policore, shih Tara Denham, "Reforma policore dhe gjinia", në: Megan Bastick dhe Kristin Valasek (eds.) *Paketa e instrumenteve të reformimit të sektorit të sigurisë dhe gjinia* (Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW 2008). Gjendet në: https://www.dcaf.ch/police-reform-and-gender-tool-2

përfundojnë burg[152]. Që të dy këta faktorë mund të ndikojnë në mundësinë e njerëzve për të komunikuar me policinë dhe me autoritete të tjera të sigurisë mbi shqetësimet apo problemet e tyre. Ky fat është përcaktues në përpjekjet e policisë për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe krimeve të tjera.

Një nga pengesat kryesore për drejtësi, si për burrat ashtu edhe për gratë, mbetet stigma në lidhje me DhBSGj-në dhe me dhunën e ushtruar nga partneri intim ose nga persona të tjerë të familjes. Në shumë shoqëri është viktima ajo që fajësohet kur raporton dhunën seksuale. Për shkak të frikës së stigmatizimit apo poshtërimit, shumë viktima nuk i raportojnë kurrë incidente të tilla. Kjo ndodh më shpesh për viktimat meshkuj të dhunës seksuale dhe për viktimat lesbike, gej, biseksualë, transgjinorë apo *queer* (LGBTQ), të cilët mund të bëhen objekt i ngacmimeve të tjera dhe dhunës së mëtejshme për shkak të orientimit të tyre seksual apo identitetit të tyre gjinor.

Në shumë raste, reagimi i zakonshëm i komuniteteve që konsiston në fajësimin e viktimës pasqyrohet edhe nga gjykata, gjë që çon në një viktimizim të dytë nga sistemi i drejtësisë. Kështu, reformimi apo zhvillimi efikas i sistemit të drejtësisë penale kërkon një njohje të hollësishme të nevojave të ndryshme të të gjitha grupeve të shoqërisë për siguri dhe drejtësi.

Mënyra se si perceptimi i roleve gjinore ndikon te mënyra se si trajtohen në sallën e gjyqit gratë dhe burrat – si viktimat ashtu edhe dhunuesit – ka shumë aspekte. Studimet e kohëve të fundit për ekstremistet e dhunshme femra në sistemin e drejtësisë penale tregon se në disa raste, kanë qenë paragjykimet tradicionale gjinore ato që kanë dominuar në seancat gjyqësore dhe që kanë çuar në dënime më të lehta për autoret femra[153].

Jo vetëm prokurorët, por edhe komentatorët e lajmeve i portretizojnë vazhdimisht autoret femra si naive dhe si shënjestra të lehta të ekstremizmit të dhunshëm, edhe kur ato vetë e pranojnë fajin në gjyq[154].

Megjithatë, studimet gjithashtu tregojnë se burrat dhe gratë që marrin pjesë në planet terroriste, shfaqin shkallë të ngjashme suksesi në gjetjen e materialeve që u duhen dhe në përpjekjet për zbatimin e planeve të tyre. Të dhënat gjithashtu tregojnë se raporti mes burrave dhe grave të përfshirë në ekzekutimin e planeve të tilla me sukses ka qenë i ngjashëm (26%). Burrat dhe gratë kanë qenë njëlloj të prirur për të fshehur informacionet e lidhura me këto plane dhe ka qenë gjithashtu i njëjti raport burrash dhe grash që kanë qenë të lidhur me grupet e dhunshme terroriste para "angazhimit në sjellje radikale të motivuara ideologjikisht".[155]

---

152 Për më shumë informacion mbi gjininë dhe reformën në drejtësi, shih Shelby Quast, "Reforma në drejtësi dhe gjinia", në: Megan Bastick dhe Kristin Valasek (eds.) *Paketa e instrumenteve të reformës në sektorin e sigurisë dhe gjinia* (Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW 2008), Gjendet në: Shelby Quast, "Reforma në drejtësi dhe gjinia"

153 Shih, për shembull, studimi i kryer nga Audrey Alexander dhe Rebecca Turkington tek: CTC Sentinel 11.8, shtator 2018. Gjendet në https://ctc.usma.edu/september-2018/

154 Po aty.

155 Po aty.

Në Gjermani, rasti i Beate Zschäpe, një anëtare e Lëvizjes Nacionaliste Sekrete (*Nationalist Socialist Underground*), shërben si një shembull ilustrues. Në gjykimin për planifikimin e dhjetë vrasjeve, dy bombardimeve dhe pesëmbëdhjetë grabitjeve në një sërë sulmesh raciste, prokurori i Zschäpe e portretizoi atë si "thjesht të dashurën e nënshtruar të dy burrave vrasës". (Për më shumë hollësi mbi këtë rast studimi në lidhje me hetimin dhe gjykimin e saj, shih Kapitullin V).

## Integrimi gjinor në reformën penale

Të tjera mësime të nxjerra në krijimin e institucioneve të ndjeshme ndaj aspektit gjinor rrjedhin edhe nga integrimi gjinor në reformën penale. Në çdo sektor sigurie, sistemi penal përbën një pjesë të pandashme, një pjesë që është në të njëjtën kohë tejet delikate. Të gjitha shtetet që veprojnë sipas praktikave të mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës kërkojnë një sistem që vendos dhe zbaton sanksione ndaj njerëzve të dënuar për krime në përputhje me të drejtën kombëtare për të drejtat e njeriut dhe me standardet e tjera të mbrojtjes. Shumica e sistemeve të drejtësisë kanë sanksione të ndryshme që mund të përdoren, të cilat variojnë nga paralajmërimi, gjobat, shërbimi në komunitet dhe deri te dënimi me burg.

Funksionet kryesore të sistemit penal përfshijnë frenimin e autorëve të mundshëm të veprave penale, largimin nga shoqëria të personave që përbëjnë kërcënim serioz ndaj sigurisë së personave të tjerë, rehabilitimin e autorëve, si dhe shfaqjen e mosaprovimit të akteve të tyre nga shoqëria. Përveç kësaj, ky sistem ka për qëllim të japë një ndjesi drejtësie dhe vënieje në vend të të drejtave të viktimave të krimeve. Megjithatë, ashtu sikurse edhe në pjesë të tjera të sektorit të sigurisë, diskriminimi dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut ndodhin veçanërisht përmes procedurave diskriminiuese të dënimit dhe përmes mënyrave të administrimit të penaliteteve.

Njohja dhe integrimi i nevojave, të drejtave dhe aftësive të ndryshme të burrave dhe të grave, vajzave dhe djemve, në të gjitha fushat e reformës penale, janë jetësore për ngritjen e një sistemi efikas penal që është në përputhje me të drejtat e njeriut, jodiskriminues dhe që përpiqet për rehabilitimin e autorëve[156].

Marrja parasysh e dallimeve dhe marrëdhënieve gjinore ka rëndësi të jashtëzakonshme në adresimin e DhBSGj-së dhe abuzimeve në burgje: duke qenë institucione ku mbahen të dënuarit e të njëjtit seks dhe ku ka mungesa të theksuara ekuilibri të pushtetit, ambientet e burgjeve janë të prirura ta favorizojnë dhunën seksuale si përdhunimin dhe forma të tjera të shfrytëzimit seksual të burrave dhe grave. Për zbutjen e këtij rreziku, të burgosurat gra duhet

156 Për më shumë informacion mbi gjininë dhe reformën penale, shih Qendrën Ndërkombëtare për Studimet e Burgjeve,: "Reforma penale dhe gjinia", në: Megan Bastick dhe Kristin Valasek (eds.) *Paketa e instrumenteve e reformimit në sektorin e sigurisë dhe gjinia* (Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW 2008), Gjendet në: https://www.dcaf.ch/penal-reform-and-gender-tool-5

të mbikqyren vetëm nga punonjëse femra të burgjeve[157]. Adresimi i rrezikut të abuzimit dhe të DhBSGj-së është veçanërisht i rëndësishëm nëse të burgosurit (qofshin burra apo gra) i përkasin komuniteteve të pakicave – gjë që ndodh shpesh në rastin e të dënuarve për vepra penale që lidhen me terrorizmin[158].

Kështu, menaxhimi i burgjeve me ndjeshmëri gjinore nënkupton vëmendje të posaçme në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe zhvillimin në karrierë të punonjëseve femra të institucioneve korrigjuese. Për shembull, këto përpjekje mund të bëhen përmes **fushatave të rekrutimit në media, por edhe duke mbështetur aplikimin e orareve të punës më elastike dhe më familjare, si dhe përmes hartimit të politikave për adresimin e ngacmimeve seksuale dhe diskriminimit.**

Kur autorët e veprave penale të terrorizmit dënohen me burgim, pavarësisht gjinisë, duhet pasur parasysh situata specifike dhe dobësitë potenciale të tyre. Nisur nga numri i ulët i grave që dënohen me burgim, shpesh ndodh që shteti të ketë vetëm një burg për to. Në këto raste, duhet shqyrtuar për shembull nëse gruaja është e vetmja që kujdeset për familjen, apo si mund të vijë për vizita familja e saj që banon larg burgut. Gjithashtu, gratë në burgje kanë nevojë për tjetër kujdes shëndetësor dhe higjienik krahasuar me burrat. [159]

Zyra e OKB-së kundër Drogës dhe Krimit ka krijuar parime kyçe dhe rekomandime për menaxhimin e të burgosurve të dhunshëm ekstremistë dhe për parandalimin e EDhRÇT-së në burgje. Këto udhëzime rekomandojnë që këta të burgosur:

a) të ndahen sipas gjinisë, statusit ligjor dhe moshës;

b) të klasifikohen sipas informacionit të marrë përmes një vlerësimi risku dhe nevojash; dhe

c) të mbahen në ambiente sa më pak kufizuese të nevojshme për sigurinë e tyre dhe burgim të sigurt.[160]

Gjinia luan rol të rëndësishëm në momentin kur personat e dyshuar për veprën penale të terrorizmit (si autorët e tjerë të dyshuar për vepra penale) duhet të klasifikohen dhe të kategorizohen pasi ndahen sipas gjinisë dhe moshës. Ky

157 A/RES/65/229 (2121 dhjetor 2010), me titull "Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të grave të burgosura dhe masat alternative për autoret femra të veprave penale (Rregullat e Bangkokut)". Gjendet në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Bangkok_Rules_ENG_22032015.pdf

158 Për gratë e burgosura, shih rregullin 54 të Rregullave të Bangkokut.

159 Po aty, Rregullat 10 dhe 11.

160 *Parimet kyçe dhe rekomandimet për menaxhimin e të burgosurve të dhunshëm ekstremistë dhe për parandalimin e radikalizimit që çon në dhunë në burgje* (Zyra e OKB-së kundër Drogës dhe Krimit), fq. 4. Gjendet në: https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Summary-of-recommendations-on-VEPs.pdf

klasifikim shërben për t'i grupuar të burgosurit sipas kategorive në një mënyrë që mbështet rehabilitimin e tyre. Klasifikimi bëhet edhe mbi bazën e nevojave shëndetësore dhe sigurisë së të burgosurve, ku të dy janë faktorë gjinorë.

Disa burgje në Gjermani organizojnë nisma këshillimi që quhen "Praefix R" për prindërit që: a) janë të orientuar drejt ekstremizmit të djathtë dhe mundet t'ua kenë përcjellë këtë qëndrim/frymë fëmijëve të tyre; apo b) kanë vënë re se fëmijët e tyre adoleshentë kanë prirje drejt ekstremizmit të djathtë të dhunshëm.

Këshillimi synon të forcojë dhe/ose të stabilizojë marrëdhëniet mes fëmijëve dhe prindërve, duke I ndihmuar prindërit të përmirësojnë aftësitë për rritjen e fëmijëve, si edhe për të parë me sy kritik vlerat dhe qëndrimet me të cilat janë edukuar prej prindërve të tyre. Nisma fokusohet njësoj si te baballarët, ashtu edhe te nënat, duke shmangur njëanshmërinë lidhur me faktin se kush ofron kujdesin parësor në familje. Prandaj, u kanë dhënë si grave edhe burrave, hapësirën të mendojnë se çfarë kuptimi ka prindërimi për ta.

Kjo nismë u bazua në premisën se fëmijët e prindërve të burgosur janë veçanërisht vulnerabël. Ata vuajnë shpesh mungesën e prindit të burgosur, u vjen turp dhe ndiejnë një lloj faji për gabimin e prindit, si dhe mund të ekspozohen ndaj refuzimit dhe bulizmit në ambientin e tyre. (Për më shumë informacion, shih studimin e plotë për fëmijët e prindërve të burgosur në katër shtete evropiane: http://childrenofprisoners.eu/wp-content/uploads/2013/12/COPINGFinal.pdf.)
Për shkak të faktorëve të tjerë, si lidhjet e paqëndrueshme familjare dhe përcjellja e traumave ndër breza, ka më shumë gjasa që këta fëmijë të bashkohen me grupet e dhunshme radikale.

"Praefix R" ishte projekt pilot i financuar nga Ministria Federale për Çështjet Familjare, Qytetarët e Rritur, Gratë dhe Rininë, i cili u zbatua për dy vjet.

Për më shumë informacion dhe për raportin përfundimtar të vlerësimit, shih https://www.ifgg-berlin.de/praefix-r.htm (në gjermanisht)

Në disa shtete, individët e dyshuar për krime terrorizmi kalojnë vite në paraburgim dhe rrjedhimisht nuk kanë akses në shërbimet dhe programet që përfitojnë të dënuarit me vendim gjykate. Gratë e burgosura përballen me një rrezik më të lartë abuzimi në mjediset e parandalimit, siç është pranuar edhe nga Rregullat e Bangkokut të OKB-së.[161] Gjithashtu, pranohet se periudha mes arrestimit dhe gjyqit mund të mbartë shumë rreziqe, sepse mund të mbruhen shqetësime të perceptuara apo reale kundër qeverisë. Po kështu, kjo periudhë është një terren pjellor, në të cilën personat që ndodhen në paraburgim të dyshuar për terrorizëm, mund të radikalizojnë të burgosurit e tjerë.[162]

161 Po aty, Rregulli 56.

162 *Udhëzues për menaxhimin e të burgosurve të dhunshëm ekstremistë dhe për parandalimin e radikalizimit që çon në dhunë në burgje* (Zyra e OKB-së kundër Drogës dhe Krimit), fq. 67. Gjendet në: https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Handbook_on_VEPs.pdf

### Mësimet nga programet ekzistuese për burrat mbi paqen, sigurinë dhe mashkulloritetin

Edhe pse është e vështirë të gjenden lidhje shkak-pasojë mes sigurisë dhe mashkulloritetit, në metodologjitë e programeve ekzistuese për burrat që merren me këto dy aspekte mund të gjenden mësime dhe mjete të vyera për hartimin e politikave dhe masave efektive për parandalimin e terrorizmit dhe EDhRÇT-së, si dhe kundër mashkulloritetit toksik që mbizotëron shpesh në grupet e dhunshme ekstremiste.

Programet kushtuar burrave japin efekte, pasi ofrojnë ndjesinë e përkatësisë dhe hapësira ku burrat mund të zbërthejnë dhe të kuptojnë konceptet e mashkulloritetit. Gjithashtu, këto programe përbëjnë edhe një mundësi për burrat që të vlerësojnë sjelljet e tyre të dëmshme pa qenë objekt gjykimi. E gjitha kjo nevojitet për të nxitur ndryshimin real të sjelljes. Disa shembuj të suksesshëm të këtyre programeve janë Fushata "Shiriti i Bardhë" dhe Rrethet e Djemve kundër Dhunës organizuar nga OJF-ja ndërkombëtare "Promundo". Një tjetër shembull i mirë i punës që fokusohet te siguria dhe mashkulloriteti është programi i prindërimit pozitiv ofruar nga organizata "*Sonke Gender Justice*" në Afrikën e Jugut, një program ky që merret vetëm me baballarët.

**Fushata "Shiriti i Bardhë"** është një lëvizje globale e burrave dhe djemve që punojnë për t'i dhënë fund dhunës së meshkujve ndaj grave dhe vajzave, themeluar nga një grup burrash pro-feministë në Ontario të Kanadasë në nëntor 1991 si një reagim ndaj masakrës ndaj studenteve të "École Polytechnique" në vitin 1989. Fushata synonte të rriste ndërgjegjësimin për prevalencën e dhunës mashkullore ndaj grave, ku shiriti i bardhë ishte si një shenjë betimi se nuk do të kryejnë, nuk do të tolerojnë dhe nuk do të heshtin përballë dhunës ndaj grave dhe vajzave.[163] Kjo lëvizje është aktive në mbi 60 shtete dhe synon të promovojë marrëdhëniet e shëndetshme, barazinë gjinore dhe mashkulloritetin e dhembshur.

Përmes projekteve në Kanada, fushata "Shiriti i Bardhë" merret posaçërisht me angazhimin e burrave dhe djemve në komunitetet e emigrantëve dhe refugjatëve, duke kërkuar aleatë meshkuj që drejtonë aktivitetet ndërgjegjësuese në këto komunitete.[164]

---

163 Shih: https://www.whiteribbon.ca/about.html

164 Shih: https://www.whiteribbon.ca/projects.html

**Rrethet e Djemve kundër Dhunës** (YMCAV) organizuar nga **Promundo** është një projekt edukimi në grup për të transformuar perceptimin gjinor, që synon të ulë dhunën e rrugës dhe të mos lejojë që djemtë 10-19 vjeç të bashkohen me bandat e rrugës, duke i ndihmuar që të largohen prej tyre. Projekti po zbatohet në Kinshasa (Republika Demokratike e Kongos).

Në vitin 2016, Promundo realizoi një studim në Kinshasa për të analizuar se si mund të ulet dhuna, si mund të promovohet barazia gjinore mes djemve dhe si mund të krijohen mjedise, programe dhe politika efikase që parandalojnë përfshirjen e djemve në grupet e dhunshme.

Projekti YMCAV organizon edukimin në grup të djemve, duke i bërë ata që ta përkufizojnë edhe një herë çfarë do të thotë të jesh burrë. Gjithashtu, krijon mjedise mbështetëse në shkolla dhe qendra rinore, si edhe punon që të rrisë mbështetjen e programit dhe politikave nga aktorët e tjerë kongolezë.[165]

Në Afrikën e Jugut, organizata **Sonke Gender Justice** zbuloi se shumë baballarë nuk përfshiheshin në jetën e fëmijëve të tyre. Arsyet ishin të ndryshme, por shpesh baballarët ishin të papunë ose fitonin fare pak të ardhura dhe kjo i bënte të ndihen të pazotë për të siguruar jetesën materiale të fëmijëve të tyre. Për këtë arsye, largoheshin vetë nga familja ose u ndalohej të takonin fëmijët. Në këtë situatë, fëmijët privohen nga dobitë e shumta sociale dhe emocionale që sjell marrëdhënia me një baba aktiv në jetën e tyre.

Studimi tregoi se babai i përfshirë në familje jo vetëm lehtëson barrën e kujdesit që duhet të ofrojë nëna, por ndihmon edhe fëmijën të ecë në jetë. Vihet re një zhvillim konjitiv më i lartë, rezultate shkollore më të mira, shëndet më i mirë mendor për djemtë dhe vajzat si edhe normë më e ulët veprash penale. Studimet në shumë shtete kanë treguar se ndërveprimi baba-fëmijë (djalë apo vajzë qoftë fëmija) është i rëndësishëm që fëmijët të zhvillojnë empatinë dhe aftësitë sociale.[166]

Organizata “Sonke Gender Justice” punon që të krijojë dinamika familjare më të shëndetshme, bashkëjetesën e roleve prindërore në jetën e fëmijëve, si edhe marrëdhënie ku ekziston barazia gjinore. Përmes fushatës **MenCare Global Fatherhood**, programi u qaset burrave si ofrues kujdesi dhe si baballarë, ku për 12 javë merret me grupe baballarësh me bazë komunitetin në Afrikën e Jugut. Kjo fushatë zbatohet në mbi 25 shtete në pesë kontinente.

165 https://promundoglobal.org/work/?program=conflict-and-security

166 http://genderjustice.org.za/project/child-rights-positive-parenting/

Që nga krijimi i saj në vitin 2011, fushata **MenCare** ka punuar me 250,000 individë. Në këto grupe prindërimi, baballarët aktualë, baballarët e ardhshëm dhe ofruesit e kujdesit – bashkë edhe me disa nëna dhe ofruese kujdesi – diskutojnë rreth përvojave të tyre të prindërimit, mësojnë aftësi praktike prindërimi dhe komunikimi, nxiten të mbështetin nënën e fëmijëve të tyre, si edhe mësojnë metodat e disiplinës pozitive. **Sonke** po e koordinon këtë fushatë me Promundo-n.[167]

167 Po aty.



# Kapitulli V: Raste studimore nga rajoni i OSBE-së. Mësimet e nxjerra lidhur me ndërgjegjësimin gjinor në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

# 1) PUNA NË TERREN DHE ANGAZHIMI ME KOMUNITETET

## Ritmi i punës me parandalimin: Rasti i Policisë Kalorësiake Mbretërore Kanadeze dhe "tabelat e situatës" së Torontos

### FAKTORËT DHE GJETJET KYÇE

- Oficeret femra të policisë janë thelbësore për të garantuar që ekipet e angazhimit publik të kontaktojnë si me burrat edhe me gratë në komunitet;
- Pjesëmarrja e drejtuesve të policisë në këto ekipe (të paktën fillimisht) ndihmon për t'i dhënë besueshmëri aktiviteteve në terren;
- Gratë luanë rol të rëndësishëm në familje, prandaj janë në pozita solide për të evidentuar prirjet drejt radikalizimit që mund të çojë në dhunë;
- Për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, gratë janë të prirura të kuptojnë faktorët mbrojtës, si p.sh. mbështetjen e fortë familjare dhe shoqërore, vetëvlerësimin pozitiv dhe angazhimin komunitar;
- Të dhënat e mbledhura nga të ashtuquajturat "tabela të situatës" në Toronto tregojnë se janë në gjendje t'u shërbejnë njësoj burrave dhe grave në terma sasiorë.

### KONTEKSTI

Ndërkohë që numri i viktimave kanadeze në incidente të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm mbetet relativisht i ulët, në dhjetëvjeçarët e fundit janë vrarë ose plagosur disa qindra civilë. [168] Ashtu si vendet e tjera të globit, Kanadaja e sheh terrorizmin e dhunshëm të frymëzuar nga al-Kaeda dhe ISIL/Daesh si një nga kërcënimet kryesore ndaj sigurisë së saj kombëtare.[169] Vendi nuk është imun as nga aktet e dhunshme që vijnë nga grupe ekstremiste të krahut të djathtë ose formave të tjera të dhunës ekstremiste. [170]

168 https://www.counterextremism.com/countries/canada

169 Shih Raportin Publik për Sigurinë Publike të Kanadasë për vitin *2017 lidhur me Kërcënimet Terroriste ndaj Kanadasë.* Gjendet në: https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrcs/pblctns/pblc-rprt-trrrst-thrt-cnd-2017/index-en.aspx

170 Raporti Publik për Sigurinë Publike të Kanadasë për vitin *2017 lidhur me Kërcënimet Terroriste ndaj Kanadasë*, thotë se, ndërkohë që e djathta ekstreme "nuk është grup koherent nga ana ideologjike", ka "gjithnjë potencial" për terrorizëm të motivuar nga ideologjitë e krahut të djathtë.

Për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm, autoritetet kanadeze punojnë në nivele të ndryshme. Nga masat dhe aktivitetet që ndërmarrin ata për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, më e rëndësishmja është strategjia kombëtare kundër terrorizmit, e cila është krijuar për të ushtruar qëndresë ndaj terrorizmit dhe për të siguruar kuadrin për trajtimin e kërcënimeve terroriste vendase dhe ndërkombëtare. Ajo udhëzon më shumë se njëzet departamente dhe agjenci federale, duke i ndihmuar ato që "të parandalojnë, të zbulojnë, dhe t'u përgjigjen" më mirë kërcënimeve terroriste. [171]

Për **parandalimin e radikalizmit që çon në dhunë**, Kanadaja ndjek një qasje të plotë qeveritare. Qendra Kanadeze për Angazhimin e Komunitetit dhe Parandalimin e Dhunës (CCCEPV) punon me të gjitha nivelet e qeverisë, me organizatat jofitimprurëse, komunitetet, rininë, praktikuesit e vijës së parë, botën akademike, zbatimin e ligjit dhe organizatat ndërkombëtare. [172] Aktivitetet e CCCEPV-së përfshijnë:

- Hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Kanadasë për Kundërvënien ndaj Radikalizmit që çon drejt Dhunës;
- Mbështetjen e përpjekjeve për ndërhyrje përmes financimit, hulumtimit, politikave dhe programimit;
- Punën me partnerët për të matur dhe vlerësuar më mirë çfarë funksionon, çfarë jo dhe çfarë ndihmon në kundërvënie ndaj radikalizmit që çon drejt dhunës;
- Angazhimin me grupe në sektorë të ndryshëm, me fokus të veçantë gratë, për të nxitur marrëdhëniet dhe për të krijuar mundësi bashkëpunimi.

## ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Në nivel komuniteti, policia në Kanada angazhohet në një sërë nismash parandaluese, përfshirë aktivitete specifike të hartuara për të përmirësuar kontaktin e saj me të gjitha komunitetet. Njësia e Angazhimit Publik e Policisë Mbretërore të Kanadasë (RCMP) në Toronto, Ontario, punon për t'u afruar me publikun, në veçanti me rininë, për të folur mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe dobësitë që lidhen me të. Ndërkohë që detyrat e përditshme të policisë, si kontrolli i trafikut, marrja e telefonatave dhe patrullimet në lagje, kryhen nga policia bashkiake dhe ajo lokale, RCMP hyn në skenë kur policia ndeshet me raste që lidhen me çështje shtetërore - siç është EDhRÇT-ja. Ekipet e angazhimit publik të RCMP bashkëpunojnë ngushtë me policinë lokale, në nivel lokal, për të krijuar marrëdhënie me komunitetin.

Kur Njësia e Angazhimit Publik u krijua për herë të parë në vitin 2005, ekipi punoi fort për t'u bërë i njohur në komunitetet përreth Torontos. Ngritja e rrjeteve dhe krijimi i lidhjeve ishin prioritetet kryesore për këtë njësi të vogël, e cila në fillim u prit ftohtë nga komunitetet e qytetit. Ekipi ishte përqendruar te angazhimi dhe, për këtë arsye, ishte e rëndësishme t'u bëhej e qartë banorëve

171 https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/ntnl-scrt/cntr-trrrsm/cntr-trrrsm-strtg-en.aspx

172 Për më tepër informacion mbi punën e Qendrës, shih https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/bt/cc/index-en.aspx

se mandati i tij nuk ishte të mblidhte informata, por të informonte, të edukonte dhe të parandalonte radikalizimin e pjesëtarëve të komunitetit.

Për të krijuar marrëdhënie të qëndrueshme me komunitetin lokal, Njësia e Angazhimit Publik komunikon me aktorë të besuar të komunitetit, si me udhëheqësit politikë dhe fetarë, përfaqësuesit e shkollave dhe persona të tjerë në pozicione të rëndësishme. Theks i veçantë i është kushtuar afrimit me anëtaret gra të komunitetit të qytetit, duke pasur parasysh rolet e rëndësishme që luajnë ato në familje dhe mundësinë e tyre për të njohur pikat e dobëta ndaj radikalizimit që mund të çojë në dhunë. Po ashtu, gratë janë të prirura për të kuptuar edhe faktorët mbrojtës që mund të parandalojnë ekstremizmin e dhunshëm, siç janë mbështetja e fortë familjare dhe sociale, vetëvlerësimi pozitiv dhe angazhimi i komunitetit. Për të gjithë qytetarët organizohen takime. Përveç tyre, mbahen edhe takime të posaçme ku mblidhen së bashku vetëm gratë.

Janë dhënë mendime të ndryshme për përbërjen e Njësisë së Angazhimit Publik: Ajo përfshin oficerë policie si burra dhe gra, me origjinë të ndryshme etnike dhe me formime të ndryshme arsimore (duke përfshirë, për shembull, edhe analistë dhe studiues). Kjo përpjekje është bërë me vetëdije, për t'u siguruar që Njësia e Angazhimit Publik të perceptohet si e besueshme dhe e denjë për t'u besuar nga komunitetet në tërësi. Veç kësaj, është vlerësuar si i rëndësishëm edhe fakti që pjesë e ekipit ka qenë edhe një oficer i nivelit të lartë drejtues. Siç është shprehur një anëtar i ekipit: "Fakti që ata mund të flisnin me komandën e lartë e mbylli shumë shpejt hendekun [midis policisë dhe komunitetit] dhe na ndihmoi të krijonim atë besim kritik."[173]

## ZGJIDHJA PËRMES BASHKËPUNIMIT E DHE PROBLEMET NË PARANDALIMIN E EDHRÇT-SË

Shembulli i dytë përfshin një qasje bashkëpunuese të bazuar në prova për zgjidhjen e problemeve, për trajtimin e problemeve komplekse njerëzore dhe sociale (si EDhRÇT-ja) në hapësirën parapenale. Shërbimi policor në Toronto mori mbështetje financiare nga qeveria, në shtator të vitit 2018, për zgjerimin e "FOCUS Toronto", një program bashkëpunues për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, duke marrë mbështetje ndërsektoriale dhe ekspertizë nga policia, nga ofrues të tjerë të shërbimeve, si dhe nga shoqëria civile.[174]

Kjo qasje bashkëpunuese njihet gjithashtu me emrin "tabela situatash" ose "modeli *hub*". Një nga këto modele bashkëpunuese për zgjidhjen e problemeve u krijua dhe u drejtua nga një grua në policinë e Otavës në fund të viteve 1990-të.

173 Intervistë e OSBE-së ne 2018 me inspektoren. Lise Crouch, ndihmës-oficere e operacioneve kriminale në RCMP.

174 https://markets.businessinsider.com/news/stocks/federal-funding-for-toronto-police-to-expand-counter-radicalization-to-violence-initiative-1027515358

Ndërkohë, modele të ngjashme funksionojnë me sukses edhe në qytete të tjera në të gjithë Kanadanë.[175]

"Tabelat e situatave" përfshijnë takime javore të bashkërendimit midis policisë, ofruesve të tjerë të shërbimeve dhe aktorëve të shoqërisë civile. Ata punojnë së bashku për të identifikuar individët, grupet dhe vendet me rrezikshmëri të lartë të EDhRÇT-së, qoftë si autorë ose si viktima, dhe koordinojnë masat e ndërhyrjet e duhura. Këto ekipe nga shumë agjenci janë në gjendje të zbatojnë një qasje gjithëpërfshirëse, duke i lidhur përfituesit e tyre me shërbimet e duhura. Pas këtyre takimeve, përgjigjja e parë është zakonisht e shpejtë, ndodh brenda dy ditësh pasi të jenë zhvilluar diskutimet.[176]

Një analizë e 479 situatave, të diskutuara në takimet e FOCUS Toronto, ka treguar se 93% e çështjeve mund t'u referohen shërbimeve të veçanta, si policia ose drejtësia, shërbimet sociale, shërbimet e mirëqenies ose strehimit. Në 88% të rasteve, rreziku i përgjithshëm është ulur – me rrezik nënkuptohen rrethanat në një situatë ose rrethanat e një individi, familjeje, grupi ose vendi, që tregon se ekziston një probabilitet i lartë dëmtimi ose viktimizimi.

**Të dhënat e mbledhura tregojnë po ashtu se FOCUS Toronto është në gjendje t'u shërbejë një numri të barabartë burrash dhe grash** (49% e përfituesve të zgjidhjeve ishin gra, 48% burra).[177] Ky është një konstatim domethënës, pasi tregon se **shërbimi është në gjendje të trajtojë përvojat dhe nevojat e ndryshme të burrave dhe grave në komunitet**.

## Angazhimi efektiv i komuniteteve të pakicave: Rasti i policisë së Oslos në Norvegji

### FAKTORËT DHE GJETJET KYÇE

- Oficeret femra të policisë janë në pozita të mira për të marrë drejtimin në krijimin e marrëdhënieve të besimit me gratë e komuniteteve të pakicave ("efektivë të komunitetit pakicë");
- Efektivët e angazhimit komunitar shpesh zotërojnë njohuritë dhe aftësi e duhura që të zhvillojnë dhe të zbatojnë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve

175 http://www.gov.pe.ca/photos/original/COR_Hub_PEI.pdf
Për më tepër informacion mbi gjetjet e studimit mbi këto modele, shih Chad Nilson: "Modeli i Hub-eve të Kanadasë: Thirrja për Perceptime dhe Vlerësime nga ata klientë në fokus të ndërhyrjeve bashkëpunuese me bazë riskun" në Buletinin për Sigurinë dhe Mirëqenien e Komunitetit, 2016. Gjendet në https://www.usask.ca/cfbsjs/documents/FINALArticleNilsonCanadasHubModel.pdf. Shih edhe Dale R. McFee dhe Norman E. Taylor, "Hub-i i Princit Albert dhe lindja e sigurisë bashkëpunuese të komunitetit me bazë riskun", Seria e Punimeve të Policisë Kanadeze, 2014. Gjendet në : http://publications.gc.ca/collections/collection_2017/sp-ps/PS67-1-1-2014-eng.pdf

176 Për më tepër informacion, shih https://www.toronto.ca/community-people/public-safety-alerts/community-safety-programs/focus-toronto/

177 Po aty.

të grave lidhur me një sërë temash, duke përfshirë barazinë gjinore, të drejtat qytetare dhe parandalimin e radikalizimit;

- Sjellja e grave nga komunitete të ndryshme pakicash në aktivitete periodike forcon marrëdhënien e besimit me policinë dhe u mundëson krijimin e rrjeteve mes tyre;

- Përfshirja e perspektivës gjinore në punën me komunitetet në terren nuk do të thotë të përqendrohemi vetëm te gratë. Të kuptuarit e shqetësimeve specifike të djemve ishte thelbësor për përmirësimin e situatës së sigurisë gjatë Ramazanit në krahasim me vitet e kaluara;

- Njësitë policore që përqendrohen te parandalimi/kundërvënia ndaj EDhRÇT-së vlerësojnë dhe varen nga puna e ekipeve që merren me komunitetet në terren;

- Më shumë efektive femra duhet të bashkohen me ekipet e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së.

## KONTEKSTI

Niveli i kriminalitetit në Norvegji është relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera të Evropës Perëndimore. Madje, në vitin 2017, numri total krimeve të denoncuara në kryeqytetin e Oslos u ul me 5.3% nga viti 2016.[178] Shumica e çështjeve penale të denoncuara në polici janë incidente të lidhura me vjedhjet.[179]

Sa u përket rasteve të EDhRÇT-së, Norvegjia ka më pak luftëtarë të huaj që udhëtojnë drejt Sirisë apo Irakut, sesa vendet e tjera të Evropës Perëndimore si Suedia, Franca, Danimarka apo Belgjika.[180] Sidoqoftë, Shërbimi i Brendshëm i Sigurisë së Norvegjisë, «Politiets Sikkerhetstjeneste», raportoi në vlerësimin vjetor të kërcënimeve për vitin 2018 se «individët dhe grupet e frymëzuara nga ideologjitë ekstremiste islamike përbëjnë ende kërcënimin kryesor për terrorizëm».[181] Ekziston edhe frika nga terroristët mbrujtur brenda vendit, përfshirë individët dhe grupe të dhunshme të krahut të djathtë.

Në korrik 2011, Norvegjia pësoi “sulmin më shkatërrues ndaj vendeve skandinave që nga Lufta II Botërore”.[182] Ekstremisti i djathtë Anders Behring Breivik vrau 77 persona dhe plagosi mbi 300 të tjerë në dy sulme shkatërruese, ku veproi i vetëm. Në tetor 2013, një qytetar norvegjez me prejardhje afrikane luajti rol

---

178 https://www.ssb.no/en/sosiale-forhold-og-kriminalitet/statistikker/lovbrudda

179 Për shifrat e kriminalitetit vitet e fundit në Norvegji, shih: https://www.tnp.no/norway/panorama/crime-rates-decrease-norway

180 Shifrat më të fundit tregojnë se është evidentuar një total prej 100 personash që kanë udhëtuar nga Norvegjia për të marrë pjesë në organizatat terroriste në Siri. Për më shumë informacion, shih Yngve Carlsson dhe Shoqata Norvegjeze e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale, „Ekstremizmi i Dhunshëm: Parandalimi i një problemi të lig – roli i autoriteteve vendore”. ” (C-REX Qendra për Kërkime mbi Ekstremizmin, 2017). Gjendet në: https://www.sv.uio.no/c-rex/english/publications/c-rex-working-paper-series/Violent-extremism-working-paper-2-2017.pdf

181 Shërbimi i sigurisë i Norvegjisë, *Vlerësimi i Kërcënimeve 2018*. Gjendet në : https://www.pst.no/alle-artikler/trusselvurderinger/annual-threat-assessment-2018/

182 Siç raportohet nga *The Economist*. Shih https://www.economist.com/newsbook/2011/07/22/terrorism-strikes-scandinavia

kryesor në planifikimin dhe kryerjen e një sulmi terrorist në një qendër tregtare në Najrobi të Kenias.

Për parandalimin efektiv të EDhRÇT-së, qeveria norvegjeze miratoi një Plan Kombëtar Veprimi kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm në vitin 2014.[183] Plani i Veprimit ndihmon në përmirësimin e përpjekjeve parandaluese ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe trajtimin sa më herët të personave të rrezikuar.

Ashtu si edhe në vende të tjera, EDhRÇT-ja është shpesh një shqetësim më i madh në mjediset e mëdha urbane, siç është qyteti i Oslos, ku dallimet në të ardhura, arsimim dhe prejardhje kulturore janë pika potenciale tensioni. Një e treta e popullsisë së Oslos i përket një komuniteti pakice, ku shumica vijnë nga shtete me jo shumë besim te policia dhe sistemi i drejtësisë penale.[184]

Për adresimin e kësaj mungese besimi, policia e Oslos filloi aktivitete të përqendruara në terren për vendosjen e një dialogu sistematik me një sërë komunitetesh në qytet. Kjo u bë për të treguar se policia interesohet vërtet për mirëqenien e qytetarëve, madje që para se të ndodhin problemet me krimin. Në pararojë të këtyre nismave për të vendosur marrëdhënie dhe për të fituar besim ishin fillimisht zyrtarët e lartë të policisë, por pastaj u konstatua qartë se duheshin efektivë të trajnuar posaçërisht (burra edhe gra) për plotësimin e këtyre ekipeve.

Që nga viti 2009, «efektivët e komunitetit të pakicave» janë ngarkuar që të shkojnë rregullisht në terren dhe të takohen me burra dhe gra nga komunitete të ndryshme pakicash. Kjo nismë është zbatuar kryesisht në qendër të Oslos dhe në pjesën veriore. Për t'u siguruar që në takime të marrin pjesë si burrat, ashtu dhe gratë e komunitetit, ekipi i efektivëve përbëhet nga tre burra dhe dy gra.

Përveç vizitave sistematike në shkolla, vendet e kultit dhe qendrat komunitare, organizohen edhe takime më të zgjeruara për të mbledhur gra nga pakica të ndryshme për t'iu dhënë mundësinë e dialogut dhe shkëmbimit të mendimeve dhe përvojave.

Në tetor të vitit 2018, 225 gra nga i gjithë qyteti i Oslos morën pjesë në një forum bashkëpunimi të organizuar nga policia për të dëgjuar Iram Haq-in, një aktore me origjinë norvegjezo-pakistaneze e nominuar për çmimin *Oscar* dhe regjisore filmi, që të tregonte historinë e jetës së saj. Forume të tilla bashkëpunimi planifikohen të mbahen çdo vit.

183 Për Planin e Veprimit, shih https://www.regjeringen.no/en/dokumenter/Action-plan-against-Radicalisation-and-Violent-Extremism/id762413/ (në anglisht).

184 https://www.ssb.no/en/befolkning/statistikker/innvbef/aar/2017-03-02

> Aktualisht, rreth 30% e të gjithë efektivëve të policisë së Oslos janë gra. Në vitin 2018, gratë përbënin pothuajse 50% të rekrutëve të rinj në Kolegjin Universitar të Policisë së Oslos.
>
> Kur rekrutohen efektivë, sidomos për punë policore parandaluese, inkurajohet kandidimi i grave dhe atyre prej pakicave.

Aktivitete të tjera me fokus gratë e të gjitha moshave përfshijnë trajnimet dhe kurset për tema të përgjithshme si barazia gjinore dhe të drejtat qytetare në Norvegji, por edhe mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin terrorist, si dhe faktorët e rrezikut dhe dobësitë që lidhen me të.

Fitimi i besimit të grave nga komunitetet e pakicave i ka mundësuar policisë në vitin 2015 që të pengojë efektivisht radikalizimin e mëtejshëm të shumë djemve të rinj dhe anëtarësimin e tyre në ISIL/Daesh në Siri.[185]

Përmes shkëmbimeve të rregullta mes efektivëve të komuniteteve të pakicave dhe njësive e ekipeve në policinë e Oslos, efektivët kuptojnë më mirë kushtet e jetesës së grave dhe burrave të pakicave dhe shqetësimet e tyre për sigurinë. Kështu, u përgjigjen më mirë nevojave të sigurisë së këtyre komuniteteve.

I ashtuquajturi "ekip antiradikalizim" i policisë së Oslos e çmon shumë punën e efektivëve të komuniteteve të pakicave. Ky ekip përbëhet nga 11 efektivë, duke përfshirë edhe një oficere të inteligjencës. Pavarësisht përpjekjeve aktive të drejtuesit të ekipit, rekrutimi i më shumë grave mbetet problematik, ngaqë janë të pakta gratë që aplikojnë.

Përveç kontakteve në terren me gratë e komuniteteve të pakicave, policia e Oslos ka ndërmarrë edhe nisma për komunikimin me djemtë e rinj. Policia vuri re se gjatë muajit të Ramazanit, djemtë mblidhen zakonisht në rrugë deri vonë, teksa presin perëndimin e diellit që të kthehen në shtëpi për të ngrënë. Kjo çoi në një sërë situatash të tensionuara dhe rritje të krimit ordiner.[186]

Për të garantuar qetësinë publike në rrugë gjatë periudhës së agjërimit në 2018-ën, policia u angazhua me drejtuesit fetarë, liderët e komunitetit, prindërit dhe mësuesit që disa javë para Ramazanit. Qëllimi ishte që të diskutoheshin parimet e agjërimit dhe mësimet e Kuranit, të identifikoheshin rreziqet që paraqet pritja e gjatë deri në perëndimin e diellit dhe të diskutoheshin mënyrat si mund të zbuten disa prej këtyre rreziqeve.

Si rezultat, u formuan grupe për çdo lagje që përbëheshin nga efektivë, udhëheqës fetarë, pjesëtarë të respektuar të komunitetit, prindër dhe mësues. Kur këto grupe dilnin në rrugë mbrëmjeve dhe vendosnin kontakte me të rinjtë, situata rezultonte shumë më e qetë. Në krahasim me vitet e kaluara, policia raportoi ulje të konsiderueshme të krimit ordiner në vitin 2018.[187]

185 Intervistë telefonike private me një pjesëtar të Policisë së Oslos, tetor 2018.

186 Po aty

187 Po aty

# 2) TRAJNIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE TË KOMUNITETEVE

## Programi për gratë e përfshira në transformimin e komunitetit si dhe Programi për Ndërhyrjen e Hershme të Grave: Rasti i Irlandës së Veriut

### FAKTORËT DHE GJETJET KYÇE

- Gratë janë partnere kyçe në përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës së frymëzuar ideologjikisht;

- Në veçanti, gratë që nuk kanë qenë aktive në komunitetet e tyre, mund të bëhen agjente efektive të ndryshimit nëse mbështeten dhe fuqizohen mes një sërë fushash, duke përfshirë gratë në sistemin e drejtësisë, gratë në ndërtimin e paqes, lidershipit, mentorimit dhe qytetarisë;

- Për të evidentuar përfituesit më të përshtatshëm të një programi për ngritjen e kapaciteteve në nivel komuniteti, është e rëndësishme që në hapin e parë të përfshihet ndërgjegjësimi për objektivat kryesorë të programit;

- Programet e ngritjes së kapaciteteve në niveli komuniteti shfrytëzojnë partneritetin e ngushtë me OJF-të vendase, sepse OJF-të shpesh kanë njohuri të thella për çështje specifike dhe shqetësimet që mund të shfrytëzohen në krijimin e rrjeteve të komunitetit;

- Mundësia që u jepet grave me prejardhje dhe përvoja të ndryshme për të mësuar mund të ofrojë hapësirën e nevojshme për dialog dhe për shkëmbime mendimesh dhe perceptimesh mbi problematika tejet delikate, siç është dhuna e frymëzuar ideologjikisht, burgosja dhe drejtësia restauruese;

- Ekzistojnë evidenca se gratë që kanë marrë pjesë në këtë program dhe që më parë kishin qenë të izoluara, tashmë janë pjesëmarrëse aktive dhe madje drejtuese të projekteve komunitare.

## KONTEKSTI

Në vitet 1969-1999, pothuajse 3 500 persona humbën jetën si rezultat i dhunës politike në Irlandën e Veriut.[188] Konflikti (i etiketuar si "Problemet") e kishte zanafillën në ndarjen e Irlandës në vitin 1921 dhe është zhvilluar mes shumë komuniteteve kombëtare, kulturore dhe fetare.

Protestantët në Irlandën e Veriut (48%) identifikohen gjerësisht si britanikë dhe mbështesin pjesën tjetër të Mbretërisë së Bashkuar (unionistët). Shumica e katolikëve në Irlandën e Veriut (45) e konsiderojnë veten irlandezë dhe shumë prej tyre aspirojnë për një Irlandë të Bashkuar (nacionalistët). Edhe pse u arrit një marrëveshje politike në vitin 1998, ende vijojnë tensionet dhe pakënaqësitë lidhur me trashëgiminë e "Problemeve". Këto kanë të bëjnë kryesisht me të drejtat e viktimave, përçarjen e vazhdueshme për çështjet e identitetit, ekzistencën e përhershme të dhunës së frymëzuar ideologjikisht, si dhe me zbehjen e dallimeve kohët e fundit mes organizatave paraushtarake, kriminalitetit dhe krimit të organizuar.

Për të trajtuar këto problematika dhe për të afruar palët dhe komunitetet në zgjidhjen e tyre, në vitin 2015 lindi "Marrëveshja e Fillimit të Ri" e cila, mes fushave të zhvillimit dhe reformës, evidenton nevojën e veçantë për një strategji të re gjithëpërfshirëse për shpërbërjen e grupeve paraushtarake.

## PROGRAMI PËR GRATË E PËRFSHIRA NË TRANSFORMIMIN E KOMUNITETIT (WICT)

Sa i takon angazhimit dhe parandalimit nga ana e komunitetit, Marrëveshja thekson nevojën konstante për të zhvilluar "një program që rrit pjesëmarrjen dhe ndikimin e grave në zhvillimin e komunitetit".[189] Si rrjedhojë, programi për Gratë e Përfshira në Transformimin e Komunitetit u hartua nga Departamenti i Komuniteteve të Irlandës së Veriut bashkë me departamente të tjera dhe me përfaqësues të komunitetit dhe organizatave të grave.

Ky program synon të rrisë pjesëmarrjen e grave në zhvillimin e komunitetit, në kuadrin e disa masave të ideuara për t'i dhënë fund dhunës së frymëzuar ideologjikisht.

Konkretisht, programi ka këto objektiva:
- Të mbështesë dhe të forcojë aftësinë e grave për të punuar në komunitetet e tyre duke i lidhur me OJF-të dhe duke i përfshirë në masa komunitare;
- Të mbështesë krijimin e marrëdhënieve influencuese për gratë që ndërtojnë pjesëmarrjen në strukturat politike dhe të rrisin lidershipin qytetar nga niveli i lagjes e lart.

---

188 Për numrin e viktimave prej konfliktit nëpër vite, shih: https://www.theguardian.com/news/datablog/2010/jun/10/deaths-in-northern-ireland-conflict-data#data

189 Për informacion të plotë mbi marrëveshjen, shih: https://www.dfa.ie/media/dfa/alldfawebsitemedia/ourrolesandpolicies/northernireland/20151117-A-Fresh-Start---The-Stormont-Agreement-and-Implementation-Plan.pdf

Gjatë procesit të hartimit dhe zhvillimit të programit, u konstatua nevoja për një program me ndërhyrje fillestare që t'i paraprijë programit kryesor. Qëllimi i këtij Programi të Ndërhyrjes së Hershme të Grave (WEIP) ishte ndërgjegjësimi dhe promovimi i angazhimi të grave sipas rekomandimeve të Marrëveshjes së Fillimit të Ri. Programi interesohej posaçërisht që të angazhonte gratë ende të papërfshira (ose të shkëputura) në aktivitetet komunitare.

WEIP u prezantua në shkurt dhe në mars të 2017-ës në 24 komunitete të ndryshme. Sipas konstatimeve të raportit të detajuar, programi komunikoi me 263 gra, megjithëse plani kishte qenë për 250. Gjithashtu, ai arriti të vendoste kontakte me gratë që ishin shkëputur nga komuniteti i tyre në një gamë të gjerë fushash.[190]

Raporti nënvizon se ndonëse gratë ishin të interesuara të mbështesnin komunitetet e tyre dhe e shihnin veten kontribuuese aktive për ndryshim, ato ishin ndjerë të pafuqishme në lidhje me zgjidhjen e shqetësimeve lokale.[191]

Bazuar në mësimet e nxjerra prej programit WEIP, faza e parë e Programit për Gratë e Përfshira në Transformimin e Komunitetit (WICT) u zbatua në prill 2017 - mars 2018 në 26 zona në mbarë Irlandën e Veriut.[192] Programi ofroi trajnim dhe mundësi zhvillimi për 505 gra në fusha si:

- Zhvillimi personal;
- Shëndeti dhe mirëqenia;
- Gratë dhe sistemi i drejtësisë;
- Gratë në ndërtimin e paqes;
- Lidershipi dhe mentorimi;
- Qytetaria.

Para trajnimit mbi këto tema, koordinatorët e programit realizuan vlerësimin e nevojave për trajnim me secilën grua, në mënyrë që të hartonin një plan mësimor individual. Bashkë me modulet e trajnimit, u ofrua edhe këshillim për aftësitë në jetë, mentorim dhe mundësi trajnimi larg shtëpisë (sidomos për gratë që jetonin në ambiente familjare të paqëndrueshme dhe që mund të ndiheshin të pasigurta pikërisht për shkak të angazhimit të tyre në këto problematika).

190 Për informacion të plotë mbi ËEIP, shih https://www.communities-ni.gov.uk/sites/default/files/publications/communities/dfc-review-womens-early-intervention-programme.docx

191 Po aty, fq. 27.

192 Për informacion të plotë mbi zonat ku u zbatua program, shih https://www.communities-ni.gov.uk/publications/women-involved-community-transformation-programme-locations

### REZULTATET

Sipas një raporti të brendshëm vlerësimi,[193] duket se faza e parë e programit i ka ndihmuar gratë pjesëmarrëse të fitojnë vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e nevojshëm për t'u përfshirë më shumë (ose sadopak) në komunitetet e tyre, për të gjetur mundësitë e duhura për t'u përfshirë dhe për të kuptuar më mirë disa nga problemet kryesore me të cilat përballet komuniteti i tyre.

Raporti konstaton se një faktor i rëndësishëm që garantoi suksesin e programit WICT ishte përzgjedhja e grave me një gamë të gjerë prejardhjesh dhe përvojash. Megjithëse trajnimi trajtonte çështje mjaft delikate, si dhuna e frymëzuar ideologjikisht, burgimi dhe drejtësia restauruese, seancat kishin siguruar hapësirën shumë të nevojshme për dialog dhe shkëmbim të pikëpamjeve dhe perceptimeve shumë të ndryshme.

Për më tepër, evidencat tregojnë se gratë e izoluara tani marrin pjesë aktive dhe madje drejtojnë disa projekte komunitare; 80% e grave pjesëmarrëse në fazën e parë shfaqën interesimin për të kaluar në fazën e dytë.[194]

## Fushata e prindërve kundër terrorizmit: rasti i Zyrës së Programit të OSBE-së në Dushanbe

### FAKTORËT DHE GJETJET KYÇE

- Strategjia Kombëtare për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit dhe Plani përkatës i Veprimit, miratuar së fundmi në Taxhikistan, ofrojnë mundësi për të rritur angazhimin e grave në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- Gati 1 milion taxhikistanas, kryesisht meshkuj, janë emigrantë që punojnë jashtë Taxhikistanit, duke e bërë të domosdoshme përfshirjen e grave në strategji të tilla, pasi shumë prej tyre kanë marrë rolin e kujdestarit kryesor për familjet e tyre;
- Fushata "Prindërit kundër Terrorizmit" (PkT) e Zyrës së Programit të OSBE-së në Dushanbe, duke synuar ndërgjegjësimin dhe trajnimin për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, ka arritur të angazhojë mbi 8,000 përfitues, ku pothuajse gjysma janë gra;
- Projekti vendosi të angazhojë pjesëtarët e komunitetit, të afërmit e të cilëve janë larguar si luftëtarë të huaj terroristë (LHT), pasi ata janë zëra të

193 Raporti i brendshëm i është vënë në dispozicion autorit kryesor të këtij libri.

194 Po aty

besueshëm në këto komunitete. Ata janë në gjendje të rrisin ndërgjegjësimin dhe të ndihmojnë në përhapjen e kundërnarrativave bindëse përmes rrëfimit të historive personale;

- Trajnimi në kuadër të fushatës PkT siguroi mundësi të vlefshme për efektivët e policisë që të vendosnin kontakte me pjesëtarët e komuniteteve, të kuptonin më qartë nevojat e tyre dhe të përmirësonin marrëdhëniet me ta.

## KONTEKSTI[195]

Sipas shifrave zyrtare, kanë qenë 1 900 LHT nga Taxhikistani, një numër i lartë krahasuar me popullsinë prej rreth 9 milion banorësh të këtij vendi.[196] Edhe pse këto shifra kanë pësuar rënie që nga viti 2016, kërcënimi i ekstremistëve të dhunshëm të mbrujtur në vend është bërë i dukshëm.[197]

Për trajtimin në mënyrë efikase të parandalimit/kundërvënies së EDhRÇT-së, në nëntor të 2016-ës u miratua me ligj Strategjia Kombëtare për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit 2016-2020. Strategjia përfshin një Plan Veprimi me aktivitete specifike për të promovuar rolin e grave në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Aktivitetet përfshijnë nisma ndërgjegjësuese mbi rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm dhe hapa për të rritur pjesëmarrjen e grave në këshillat vendorë dhe në zbatimin e ligjit. Po rritet bindja që gratë mund të ndihmojnë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duke u angazhuar drejtpërdrejt me familjen e tyre dhe me pjesëtarët e komunitetit. Kjo mund të bëhet me shkëmbim informacionesh mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe me kundërnarrativa, por edhe përmes konsolidimit të qëndresës së grave ndaj ekstremizmit duke marrë përsipër role më të forta publike.

Kjo është veçanërisht e nevojshme, pasi gati 1 milion qytetarë të Taxhikistanit, kryesisht meshkuj, janë emigrantë pune në Federatën Ruse dhe vendet e tjera fqinje, gjë që ka lënë shumë gra në rolin e kujdestarit kryesor të familjeve të tyre.

## PUNA E ZYRËS SË PROGRAMIT TË OSBE-SË NË DUSHANBE

Zyra e Programit të OSBE-së në Dushanbe ka ofruar ngritje sistematike dhe të përshtatshme të kapaciteteve për agjencitë ligjzbatuese në Taxhikistan në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar tejkombëtar. Për këtë qëllim, mbështet studime, ndërgjegjësime, hartim politikash dhe trajnime mbi EDhRÇT-në, duke bërë bashkë qeverinë dhe shoqërinë civile.

---

195 Për informacion mbi përfshirjen e grave në nismat me autorët e ekstremizmit të dhunshëm në Azinë Qendrore, shih Anna Matveeva dhe Bahrom Faizullaev: "Gratë dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Evropë dhe Azi Qendrore" (*UN Women*, qershor 2017). Gjendet në: http://www2.unWomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2017/iii_unë_eca_tajikistan%20chapter_final-02%20final.pdf?la=en&vs=1241

196 Shifrat janë siguruar nga Komiteti Shtetëror i Sigurisë Kombëtare në nëntor 2018.

197 Departamenti i Shtetit i SHBA-së, *Raportimet Kombëtare për Terrorizmin 2017 – Taxhikistan*, shtator 2018. Gjendet në: https://www.refëorld.org/docid/5bcf1f7da.html

Duke vlerësuar rolin thelbësor të grave në kundërvënien dhe parandalimin efektiv të EDhRÇT-së, theksi u vu te puna me prindërit në përgjithësi dhe me nënat në veçanti, përmes fushatës "Prindërit kundër Terrorizmit (PkT)".

Fushata filloi në vitin 2015 në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Punës, Emigracionit dhe Punësimit. Me 180 trajnues dhe ekspertë vendorë, fushata arriti të përfshijë drejtpërdrejt mbi 8 000 përfitues, ku pothuajse gjysma janë gra. Fushata kishte disa synime:

- Rritjen e njohurive dhe botëkuptimin e popullatës vendase për EDhRÇT-në;
- Ndërtimin dhe mbajtjen e lidhjeve të besimit mes komunitetit dhe agjencive ligjzbatuese në kuadrin e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së;
- Theksimin e rolit të nënave si agjente pozitive të ndryshimit;
- Marrjen e mendimeve dhe pikëpamjeve të komuniteteve vendore se si t'i kundërvihemi EDhRÇT-së;
- Ofrimin e ndihmës në vendosjen e lidhjeve me palët e interesuara në kuadrin e EDhRÇT-së, sidomos me agjencitë ligjzbatuese, klerikët dhe organet e qeverisjes vendore (*khukumat*-ët).

Trajnimet e realizuara në kuadër të kësaj fushate kanë pasur në fokus pjesëtarët e komuniteteve vendore, siç janë prindërit, studentët, mësuesit dhe udhëheqësit fetarë, si dhe zyrtarët e agjencive ligjzbatuese dhe *khukumat*-ët vendorë. Për më tepër, trajnimet kanë synuar sidomos pjesëmarrjen e prindërve dhe të të afërmve të LHT-ve.

Trajnimet që janë realizuar në pjesë të ndryshme të vendit, kanë përfshirë një gamë të gjerë temash, si "Konceptet kryesore të EDhRÇT-së dhe dallimet midis tyre", "Shenjat dhe shkaqet e EDhRÇT-së", "Faktorët e tërheqjes dhe shtytjes", "Prezantimet me kuadrin ligjor të brendshëm dhe ndërkombëtar në kundërvënien ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm", "Familja dhe roli i saj në parandalimin e EDhRÇT-së" dhe "Kultura e Tolerancës".

Gjetjet nga seancat e trajnimit tregojnë se komunitetet ishin shumë mirënjohëse për këtë nismë dhe demonstruan dëshirë të qartë për të kuptuar temat. Gjithashtu, u konstatua se përfshirja e pjesëtarëve të komunitetit, të afërmit e të cilëve ishin larguar si LHT, ishte një mënyrë efektive për sensibilizimin e komunitetit mbi këto tema dhe për të mbështetur përhapjen e kundërnarrativave të besueshme. Gjithashtu, trajnimet ishin mundësi e vyer për efektivët e policisë që të vendosnin kontakte me pjesëtarët e komuniteteve vendore, të kuptonin më mirë nevojat e tyre dhe të përmirësonin marrëdhëniet me ta.

Për aktivitetet e ardhshme, Zyra e Programit planifikon ta zhvendosë gradualisht fokusin nga ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të prindërve te puna e drejtpërdrejtë me të rinjtë.

# 3) TRAJNIMET DHE AKTIVITETET E NGRITJES SË KAPACITETEVE PËR GRATË NË FUSHËN E SIGURISË

## Trajnimet për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm për efektivet e policisë: Projekti i Misionit të OSBE-së në Kosovë

### FAKTORËT DHE GJETJET KYÇE

- Efektivet e policisë që punojnë ngushtë me komunitetet përfitojnë trajnime shtesë dhe ngritje kapacitetesh në mënyrë që të kuptojnë, të zbulojnë dhe të trajtojnë shenjat e radikalizimit drejt ekstremizmit të dhunshëm;
- Një grup trajnuesish nga disiplina të ndryshme u ofruan pjesëmarrësve perspektiva të ndryshme se si të përforcojnë parandalimin e EDhRÇT-së;
- Këto trajnime shërbejnë si platformë për vazhdimin e komunikimit mes pjesëmarrësve dhe trajnuesve;
- Konstatohet se efektivet e policisë që marrin pjesë në projekte të tilla kanë kontakte dhe ndërveprime më të shpeshta me udhëheqësit fetarë për të diskutuar mbi masat parandaluese në raste individuale.

### KONTEKSTI

Kosova ka numrin më të lartë për frymë të rekrutëve të huaj të ISIL/Daesh në Evropë. Nga 1,8 milion banorë që është popullsia e këtij vendi ballkanik, gjithsej 255 burra, 46 gra dhe 59 fëmijë (si dhe 40 fëmijë të lindur në territor të huaj) emigruan drejt Irakut dhe Sirisë në vitet 2012-2015.[198] Fillimisht, ata iu bashkuan Ushtrisë së Lirë Siriane dhe Frontit Al-Nusra. Pas ndarjes së ISIL/Daesh nga Fronti Al-Nusra, shumica e kosovarëve u bashkuan me radhët e ISIL/Daesh.

Sipas një studimi të vitit 2017 të Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI),[199] ky largim drejt Lindjes së Mesme kishte si motiv për shumicën e tyre dëshirën për të mbështetur ISIL/Daesh në planin për krijimin e një komuniteti "të vërtetë" mysliman. Mesazhet që propagandojnë këtë ide u përhapën nga imamët e huaj

198 "Kosova, në vështirësi për të zhdukur problemin e brendshëm", The Washington Post, 24 gusht 2018.

199 *Të kuptuarit i Faktorëve Nxitës të Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë* (Instituti Ndërkombëtar Republikan, pranverë 2017). Gjendet në: http://www.iri.org/sites/default/files/2017-9-17_kosovo_vea_report.pdf

apo të shkolluar jashtë shtetit, të cilët shfrytëzuan mungesën e dijeve fetare të të rinjve dhe grave në Kosovë, si edhe problemet e tyre ekzistuese.

Kategori të cenueshme të popullatës së Kosovës janë privuar nga ndjesia e kontrollit dhe vetëvlerësimit për shkak të mungesës së mundësive për lëvizje sociale, si dhe korrupsionit mbarëshoqëror dhe mosreagimit të autoriteteve vendore. Në dekadën e kaluar, kjo arriti deri në pikën, ku largimi drejt territoreve të ISIL/Daesh dukej si një alternativë e leverdisshme.

Për gratë nga Kosova, motivi kryesor për t'u bashkuar me ISIL/Daesh ishte bashkimi me bashkëshortët. Sipas palëve të interesuara vendore, nuk ka asnjë të dhënë se këto gra janë përfshirë drejtpërdrejt në luftime. Megjithatë, disa prej arsyeve të përfshirjes së tyre ishin edhe dëshira për respektimin e rreptë të ligjit të Sheriatit nën regjimin e ISIL/Daesh dhe liria për të ushtruar besimin mysliman, që shpesh është objekt diskriminimi në Kosovë.[200] Megjithatë, asnjëra prej grave nuk ka udhëtuar vetëm drejt Lindjes së Mesme, gjë që tregon se radikalizimi i tyre ka ndodhur brenda strukturës së familjes.

Edhe pse nuk raportohen largime të reja që nga viti 2016 dhe qeveria nuk e konsideron terrorizmin si kërcënim madhor,[201] prapëseprapë pranohet se shkaqet që e bëjnë ISIL/Daesh tërheqës për popullatën nuk janë zbutur. Qeveria e Kosovës e ka futur parandalimin e terrorizmit dhe EDhRÇT-së si element thelbësor të strategjisë së vet për sigurinë. Deri tani janë miratuar njëra pas tjetrës dy Strategji dhe Plane Veprimi kundër Terrorizmit (2014–2018; 2018–2022).

Këto strategji bazohen në katër objektiva: **parandalimi,** duke identifikuar personat shkaktarë dhe duke iu kundërvënë ideologjive të dhunshme: **mbrojtja,** përmes rritjes së kapaciteteve institucionale mbrojtëse; **procedimi** i terroristëve të dyshuar prej agjencive ligjzbatuese; dhe **përgjigjja** ndaj sulmeve të mundshme terroriste, duke përgatitur institucionet për administrimin dhe minimizimin e pasojave.

Edhe pse strategjitë nuk i referohen shprehimisht rolit të grave në EDhRÇT, qeveria dhe agjencitë e saj e kanë njohur gjithnjë e më shumë nevojën për ndërmarrjen e nismave me bazë gjinore që trajtojnë nevojat e ndryshme, motivimet dhe funksionet ndërmjet burrave dhe grave në parandalimin e këtij fenomeni.

---

200 Rudinë Jakupi dhe Vesë Kelmendi, *Gratë në Ekstremizmin e Dhunshëm, Mësimet e Nxjerra nga Kosova* (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, janar 2017). Gjendet në: http://www.qkss.org/en/Reports/Women-in-Violent-Extremism-Lessons-learned-from-Kosovo-841

201 Kujtim Bytyqi, Analist i Lartë i Politikave të Sigurisë për *The Washington Post* në gusht 2018.

## PUNA E MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË

Për mbështetjen e kësaj përpjekjeje, Misioni i OSBE-së në Kosovë punon për të forcuar funksionet parandaluese të përfaqësuesve të ndryshëm të komunitetit (burra, gra, agjenci ligjzbatuese, udhëheqës fetarë dhe gazetarë). Në fund të vitit 2018, ky Mision ka në zbatim 35 projekte për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Synimet e këtyre projekteve ishin: të kuptuarit më mirë të faktorëve nxitës të EDhRÇT-së; promovimi i dialogut ndërfetar dhe tolerancës fetare; si dhe pajisja e grupeve të ndryshme shoqërore me aftësitë e nevojshme për identifikimin dhe trajtimin e shenjave të radikalizimit.

Një projekt i OSBE-së në veçanti synon forcimin e rolit të grave në përpjekjet për parandalimin e EDhRÇT-së, në bashkëpunim me Shoqatën e Grave të Policisë së Kosovës (SHGPK), me qëllimin mbështetjen e aftësimit të oficereve gra për të kuptuar, për të zbuluar dhe për të trajtuar shenjat e radikalizimit që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm. Ky projekt ka kapitalizuar rolin specifik që gratë luajnë në strukturën familjare dhe komunitare për të pasur akses tek të rinjtë në rrezik radikalizimi dhe për të ndikuar tek ata para se t'i futen rrugës së ekstremizmit.

Përmes një sërë seminaresh për oficeret gra të policisë, projekti i ka pajisur ato me njohuri për EDhRÇT-në që mund të ndahen dhe të shfrytëzohen në të gjitha njësitë e specializuara të policisë së Kosovës, si dhe në të gjithë shoqërinë. Trajnuesit nga disiplina të ndryshme (profesionistë nga fusha e sigurisë, praktikues të studimeve gjinore dhe studiues fetarë) iu kanë ofruar oficerëve të policisë perspektivave të ndryshme se si të forcojnë parandalimin e EDhRÇT-së, si në detyrë ashtu edhe jashtë saj.

Në trajnimet e ndryshme, 40 policë pjesëmarrës kanë shkëmbyer këndvështrime dhe kanë provuar qasje të reja në këto drejtime:

- Nxitja e angazhimit dhe fuqizimit të komunitetit lidhur me parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, me fokus të veçantë në fuqizimin e rolit të grave dhe nënave në komunitet, në mënyrë që të bashkëveprojnë në mënyrë efektive dhe të ndikojnë te individët në rrezik radikalizimi;
- Përmirësimi i komunikimit me grupe të ndryshme influencuesish, duke përfshirë prindërit, të moshuarit dhe udhëheqësit fetarë, për të demonstruar gjithëpërfshirjen dhe për të nxitur marrëdhënie më të forta besimi me agjentët shtetërore, si dhe për të promovuar tolerancën brenda dhe ndërmjet komuniteteve për parandaliin e polarizimit, paragjykimeve dhe diskriminimit;
- Integrimi i perspektivës gjinore në punën e policisë, me qëllim që të kuptohen më mirë përvojat e ndryshme të burrave dhe djemve, si dhe të grave dhe vajzave, kur ata përballen me radikalizimin dhe ekstremizmin, si edhe që të hartojnë strategji për trajtimin e EDhRÇT-së që i brendësojnë këto role dhe nevoja të ndryshme;
- Pajisja me aftësi në psikologji dhe menaxhim konflikti sociologjik për të lehtësuar komunikimin me individë të paqëndrueshëm apo të traumatizuar, duke përfshirë të rinjtë në rrezik radikalizimi dhe viktimat e dhunës dhe abuzimit;

- Forcimi i njohurive se si duhet të trajtohen rastet individuale të radikalizimit, duke përfshirë formulimin e mesazheve në internet apo jashtë internetit, që ofrojnë një perspektivë alternative për individët e prekur, ose që inkurajojnë vlerësimin kritik të propagandës fetare.

Misioni në Kosovë vuri re se pas këtyre seminareve, grupi i pjesëmarrësve dhe trajnuesit vazhduan komunikimin në formën e një platforme këshilluese. Policia ka shkëmbyer informacione për situata specifike që ajo has dhe ka kërkuar këshilla nga trajnuesit dhe kolegët e tjerë. Për më tepër, gratë police që morën pjesë në projekt tashmë kishin qasje dhe ndërveprim më të shpeshtë me udhëheqësit fetarë për të diskutuar mbi ndërhyrjet parandaluese në raste individuale. Disa nisma pasuese përfshinë edhe struktura të tjera shtetërore. Për shembull, pas identifikimit të rasteve të mundshme të EDhRÇT-së në disa komunitete, përfaqësuesit e Departamentit të Grave në Komunitetin Islamik të Qeverisë së Kosovës kryen vizita në terren për të ofruar ndihmë dhe për të nxjerrë mësime për strategjitë e parandalimit.

Në fazat e ardhshme të projektit, Misioni i OSBE-së planifikon të zhvilloje trajnime edhe në pjesë të tjera të Kosovës, duke përfshirë trajnime trajnerësh, për t'i vënë këto qasje në dispozicion të një grupi përfituesish akoma edhe më të madh. Për vitin 2019 planifikohet të bëhet një vlerësim tërësor i përfitimeve të këtyre seminareve, si edhe i ndikimit konkret në parandalimin e EDhRÇT-së.

Misioni i OSBE-së planifikon të zbatojë një gamë të gjerë aktivitetesh, për të kuptuar kontekstin dinamik dhe evolues të EDhRÇT-së në Kosovë. Këto aktivitete do të synojnë që të pajisin shoqërinë civile, grupet e grave, të rinjtë dhe udhëheqësit fetarë me mjetet e duhura që u mundësojnë njohjen dhe trajtimin e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm; të nxisin bashkëpunimin mes specialistëve të qeverisë, shoqërisë civile dhe akademikëve me sektorin privat; dhe të nxisin policimin në komunitet.

# 4) ROLI I PIKAVE FOKALE GJINORE INSTITUCIONALE

## Pikat fokale gjinore në Ministrinë e Sigurisë: Rasti i Bosnjë-Hercegovinës

### FAKTORËT DHE GJETJET KYÇE

- Pikat fokale gjinore janë thelbësore për t'iu dhënë ministrive dhe njësive administrative të tyre ekspertizë mbi çështjet gjinore, veçanërisht punonjësve që nuk merren me çështjet gjinore në punën e përditshme;
- Për të garantuar që gjinia të mos shihet thjesht si "çështje e grave", është thelbësore të kemi një numër të barabartë burrash dhe grash që shërbejnë si pika fokale gjinore;
- Sistemi i pikave fokale gjinore kontribuon që gjinia të mos jetë më "tabu" dhe që më shumë punonjës të kuptojnë rëndësinë e perspektivës gjinore dhe si ta përfshijnë atë në punën e tyre;
- Pikat fokale gjinore në këtë rast kanë arritur të krijojnë një rrjet brenda ministrisë, i cili shpërndan njohuri dhe mbështet hartimin e strategjive që rrisin ndikimin e masave që ndërmerren;
- Pikat fokale gjinore që kanë treguar përkushtim personal ndaj kësaj çështjeje kanë pasur ndikim më të madh;
- Nëse pikave fokale u ofrohen mundësi për pjesëmarrje aktive në hartimin dhe zbatimin e strategjive për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, ato mund të bëhen një burim strategjik;
- Sfidat e mbetura lidhen me faktin se të gjitha pikat fokale gjinore në këtë rast kanë funksione të tjera dhe nuk merren ekskluzivisht vetëm me çështjet gjinore.

## KONTEKSTI

Bosnje-Hercegovina është përballur me një spektër të gjerë kërcënimesh të dhunshme ekstremiste. Grupet e huaja terroriste kanë funksionuar në këtë shtet dhe kanë frymëzuar sulme terroriste, shpesh duke përdorur si mjet rekrutimi ndjenja të mbetura nga dhuna gjatë Luftës së Bosnjës 1992-1995.[202] Që nga dhjetori 2016, rreth 250 luftëtarë të huaj terroristë nga Bosnje-Hercegovina kanë udhëtuar drejt Sirisë apo Irakut për t'u bashkuar me ISIL/Daesh. Raportohet se mbi 60 prej këtyre LHT-ve janë gra.[203] Mendohet se shumica e këtyre individëve kanë mbetur në Siri ose Irak; rreth 50 janë kthyer në shtëpi.[204] Ky është ndoshta kontingjenti më i madh i luftëtarëve të huaj nga Ballkani Perëndimor[205]. Ky fluks i luftëtarëve të huaj pësoi rënie drastike pas vitit 2016 për shkak të disa përpjekjeve juridike dhe shoqërore që u ndërmorën në vend.[206] Sidoqoftë, Al-Kaeda, fronti al-Nusra dhe grupet e tjera terroriste kanë ruajtur mbështetjen mes boshnjakëve të radikalizuar dhe vazhdojnë të rekrutojnë.[207] Për më tepër, kërcënim mbeten edhe format e tjera të ekstremizmit të dhunshëm siç është nacionalizmi etnik.[208]

Qeveria e Bosnjë-Hercegovinës ka ndërmarrë disa hapa themelorë në drejtim të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së. *Strategjia e Bosnjë-Hercegovinës për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit 2015-2020* është një prej dokumenteve strategjike kryesore që udhëheq këtë punë të qeverisë.[209] Gjithashtu, Ministria e Sigurisë ka emëruar një kryekoordinator në nivel shtetëror për përpjekjet ndërkombëtare dhe kombëtare në kuadrin e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së. Qeveria ka prioritizuar përpjekjet për të forcuar qëndresën e "komuniteteve të rrezikuara" dhe mbështet punën e shoqërisë civile për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së në partneritet me disa organizata ndërkombëtare, mes tyre edhe OSBE-ja.[210]

202 "Bosnje-Hercegovina: Ekstremizmi dhe Kundërterrorizmi" (Projekti i Kundërterrorizmit). Gjendet në: https://www.counterextremism.com/countries/bosnia-herzegovina

203 Joana Cook dhe Gina Vale, *Nga Daesh te 'Diaspora': Gjurmimi i Grave dhe Të Miturve të Shtetit Islamik* (King's College London: Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit, 2018), fq. 16.

204 Richard Barrett, *Përtej Kalifatit: Luftëtarët e Huaj dhe Kërcënimi i Të Kthyerve* (Qendra "Soufan", 2017), fq. 12.

205 "Bosnje-Hercegovina: Ekstremizmi dhe Kundërterrorizmi" (Projekti i Kundërterrorizmit). Gjendet në: https://www.counterextremism.com/countries/bosnia-herzegovina

206 Raportet e vendeve për terrorizmin për vitin 2016 (Departamenti Amerikan I Shtetit, Byroja e Anti-Terrorizmit, korrik 2017), fq. 106-107.

207 Bosnje-Hercegovina: Ekstremizmi dhe Kundërterrorizmi (Projekti i Kundërterrorizmit). Shih: https://www.counterextremism.com/countries/bosnia-herzegovina.

208 Forumi Kërkimor për Ekstremizmin në Ballkanin Perëndimor: Raport Rajonal: Të Kuptojmë Ekstremizmin e Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor (Azinović, Këshilli Britanik, qershor 2018).

209 *Strategjia e Bosnjë-Hercegovinës për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit* (2015-2020 (Këshilli i Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, 2015).

210 Raportet Kombëtare për Terrorizmin 2016 (Departamenti i Shtetit i SHBA-së, Byroja e Kundërterrorizmit, shtator 2018), fq. 76-78.

## PIKAT FOKALE GJINORE SI MJET PËR INTEGRIMIN E VETËDIJES GJINORE NË SEKTORIN E SIGURISË

Ministria e Sigurisë (Bosnje-Hercegovinë) është përgjegjëse për një sërë detyrash kyçe të sigurisë, duke përfshirë mbrojtjen e kufijve ndërkombëtarë, parandalimin dhe zbulimin e autorëve të krimeve të lidhura me terrorizmin, trafikun e drogës dhe trafikimin e qenieve njerëzore dhe krime të tjera në lëmin ndërkombëtar, si dhe mbështetjen për organet e policisë dhe ekzaminimin mjeko-ligjor.[211] Njësitë administrative të Ministrisë përfshijnë Policinë Kufitare, Agjencinë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes, Drejtorinë për Koordinimin e Organeve Policore të Bosnjë-Hercegovinës, Agjencinë e Mjekësisë Ligjore, Agjencinë për Mbështetjen Policore, Agjencinë për Arsim dhe Forcim Profesional, si dhe Zyrën e Emigracionit.[212]

Ministria e Sigurisë bashkë me njësitë administrative ka ngritur një rrjet të pikave fokale gjinore (PFGj) që shërbejnë si bërthamë për integrimin e perspektivës gjinore në të gjithë punën që bëhet në ministri. Modeli i PFGj-ve mund të shërbejë si shembull praktik për subjektet e tjera të sektorit të sigurisë për integrimin më të mirë të aspekteve gjinore në punën e tyre, duke përfshirë edhe në fushën e anti-terrorizmit dhe në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

Ministria e Sigurisë ishte palë e interesuar kryesore në hartimin e të parit Plan Veprimi të Bosnjë-Hercegovinës për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që u miratua më 27 korrik 2010. Plani i Veprimit u hartua nga një grup ndërinstitucional me specialistë të ministrive dhe që përfshinte organizata joqeveritare. Kjo ishte e para strategji ndërsektoriale e hartuar prej qeverisë me qëllimin rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe integrimin gjinor në proceset e paqes dhe sigurisë, duke përfshirë edhe në sektorin e sigurisë. Plani i Veprimit ka tetë objektiva, duke përfshirë edhe shtimin e numrit të grave në polici dhe në forcat e armatosura të Bosnjë-Hercegovinës, si dhe trajnimin e aktorëve të drejtësisë penale dhe ushtarakëve mbi çështjet gjinore.[213] Që nga prezantimi i Planit të parë të Veprimit në vitin 2010, grupi ndërinstitucional e ka përditësuar atë dy herë dhe përditësimi i fundit është i vlefshëm deri në vitin 2022.[214]

Për të mbështetur angazhimet e Ministrisë së Sigurisë në kuadrin e Planit të Veprimit të Bosnjë-Hercegovinës për zbatimin e Rezolutës 1325, Ministria ka ngritur një rrjet të PFGj-ve për secilin departament dhe ka caktuar PFGj-të në njësitë administrative. Qëllimi i PFGj-ve është që t'i ofrojnë ekspertizë Ministrisë dhe njësive administrative të saj për çështjet gjinore dhe të sigurohen - falë punës

211 Për më shumë informacion, shih: http://msb.gov.ba/onama/default.aspx?id=3053&langTag=en-US

212 I gjithë informacioni për Rrjetin e Pikave Fokale Gjinore është vënë në dispozicion nga zyrtarët e Ministrisë së Sigurisë me telefon dhe e-mail në nëntor 2018.

213 Tomic, *Integrimi Gjinor i Sektorit të Sigurisë në Bosnjë-Hercegovinë: nga Dokumentet e Politikave në Realitet* (Lidhjet: Buletini Tremujor XIV.3, verë 2015), fq. 91.

214 Plani Kombëtar i Veprimit: Bosnja-Hercegovina (*PeaceWomen* - Lidhja e Grave për Paqe dhe Liri). Gjendet në: https://www.peacewomen.org/nap-bih

me punonjësit që çështjet gjinore nuk i kanë pjesë të punës së përditshme - që këto përpjekje gjinore të integrohen plotësisht në të gjithë punën që ndërmarrin departamentet e tyre.

Puna për krijimin e PFGJ-ve u drejtua nga Ankica Tomic, titullarë e Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Ministrisë dhe Zëvendëskryetare e Organit Koordinues për Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, me mbështetjen e partnerëve dhe aleatëve të tjerë kryesorë.

Detyrat e PFGj-së janë përcaktuar si vijon:

- Këshillon eprorët se si të përmirësohen parimet e barazisë gjinore në departamentin e tyre;
- Analizon të gjitha dokumentet, programet, planet, aktivitetet në funksion të integrimit të perspektivës gjinore (p.sh. statistikat e ndara sipas gjinisë, gjuhën me ndjeshmëri gjinore, buxhetimin me ndjeshmëri gjinore dhe balancën gjinore në programet arsimore, formimin profesional, konferenca, komisione dhe operacionet në mbështetje të paqes);
- Rekomandon veprime për përmirësimin e barazisë gjinore në departamente dhe në njësi të ndryshme; dhe
- Përgatit raporte për Organin Koordinues pranë Ministrisë së Sigurisë për këto veprime të rekomanduara, të cilat i paraqiten Ministrit të Sigurisë dy herë në vit.

PFGj-të dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga titullari i çdo departamenti në Ministrinë e Sigurisë. Për të garantuar që gjinia të mos konsiderohet thjesht si “çështje e grave”, ministria synon të ketë një numër të barabartë burrash dhe grash që shërbejnë si pika fokale - një qëllim që ministria pothuajse e ka arritur. Shumica e pikave fokale nuk kanë përvojë të mëparshme pune me çështje gjinore, por janë trajnuar nga ministria. Trajnimet i mësojnë se si integrohet gjinia në të gjitha dokumentet e departamenteve të ndryshme (p.sh. në strategji, plane veprimi, akte ligjore dhe nënligjore, procedura dhe vendime). Koordinimi i rrjetit të PFGj-ve udhëhiqet nga një Bord Koordinues i Ministrisë së Sigurisë. Bordi përbëhet nga të gjitha PFGj-të dhe zëvendësit e tyre. Kryetari dhe zëvendëskryetari koordinojnë mbledhjet e PFGj-ve, ku diskutohen çështjet shqetësuese dhe garantojnë kontaktet e rregullta mes tyre.

## REZULTATE POZITIVE

PFGj-të kanë pasur ndikim të rëndësishëm në punën e Ministrisë së Sigurisë. Zyrtarët e Ministrisë kanë vërejtur se falë përpjekjeve të tyre, gjinia nuk është më “tabu” në diskutimet mbi punën e ministrisë dhe se tani më shumë punonjës në ministri e kuptojnë rëndësinë e perspektivës gjinore dhe si ta përfshijnë atë në punën e tyre. Gjithashtu, PFGj-të kanë trajnuar kolegët dhe eprorët e tyre që të ndryshojnë mendësinë se “gjinia” është sinonim i “grave”. Ata kanë demonstruar se analiza gjinore kërkon të evidentosh dallimet mes grave dhe burrave, si dhe mes vajzave dhe djemve. Kështu mund të hartohen strategji, politika dhe programe efektive dhe tërësore.

Për më tepër, PFGj-të kanë ngritur një rrjet punonjësish brenda ministrisë, të cilët ndajnë njohuritë e tyre dhe mbështesin hartimin e strategjive. PFGj-të që janë mbështetur nga eprorët dhe titullarët e departamenteve dhe njësive të tyre kanë pasur ndikim më të madh në punën e atyre strukturave. Për shembull, si rezultat i kësaj mbështetjeje dhe punës së një PFGj-je, Strategjia për Armët e Vogla dhe të Lehta në Bosnjë-Hercegovinë përmban një zotim për të pasur parasysh ndikimet e ndryshme që këto armë kanë te gratë dhe tek burrat, si dhe për t'i kushtuar vëmendje përdorimit të tyre në rastet e dhunës në familje.

## SFIDAT

Rrjeti i PFGj-ve është një qasje novatore për integrimin gjinor në sektorin e sigurisë që patjetër mbart edhe sfida. Një nga sfidat më të mëdha është se PFGj-të nuk merren vetëm me aspektet gjinore, por kryejnë edhe detyra të tjera. Kjo paraqet sfida në mundësinë e tyre për t'u përqendruar në këto çështje, veçanërisht në zbatimin e programeve dhe politikave të dedikuara gjinore. Shpesh, PFGj-të më të suksesshme janë ato që kanë një lloj përkushtimi personal ndaj kësaj çështjeje. Rrjeti i PFGj-ve ka bërë përparime të ndjeshme vitin e kaluar në procesin e harmonizimit të legjislacionit që është objekt i punës së Ministrisë së Sigurisë me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit të Bosnjë-Hercegovinës për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Sidoqoftë, harmonizimi i mëtejshëm është akoma i nevojshëm.

Sfida të mëdha për përparimin mbeten mungesa e grave në postet vendimmarrëse në sektorin e sigurisë si dhe moskuptimi si duhet i rëndësisë së gjinisë në punën e departamenteve dhe njësive të ndryshme. Shndërrimi i zotimeve që kanë marrë këto struktura në veprime konkrete kërkon mbështetje të jashtëzakonshme nga drejtuesit e lartë të ministrisë dhe njësive administrative.

Përveç kësaj, monitorimi dhe vlerësimi i përparimit lidhur me integrimin gjinor dhe pjesëmarrjen e grave në Ministrinë e Sigurisë mund të rezultojë detyrë e vështirë. Megjithatë, një rrjet i PFGj-ve e ka përfshirë këtë aspekt si prioritet të punës së vet.

Në fund, është sfidë e madhe për PFGj-të që të arrijnë zotërimet e përcaktuara në Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 lidhur me emërimin e grave në poste vendimmarrëse të nivelit të lartë. Aktualisht, vetëm një grua shërben si titullare departamenti në ministri; në të gjitha postet e tjera janë burra. Edhe pse gratë përbëjnë shumicën në postet e nivelit të mesëm të administratës, rrallë ndodh të ngrihen në detyrë në nivele drejtuese.

## PFGJ-TË DHE EDHRÇT-JA

Nëse PFGj-ve u jepet mundësia të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e strategjive për EDhRÇT-në, ata mund të jenë një burim strategjik për të garantuar që strategjitë kombëtare për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së të integrojnë plotësisht gjininë në objektivat dhe rezultatet e tyre. Kjo mund të jetë vendimtare për efektivitetin e zotimeve të strategjisë.

Aktualisht, PFGj-të e Ministrisë së Sigurisë (Bosnje-Hercegovinë) nuk përfshihen në asnjë nga proceset e koordinimit të brendshëm për zbatimin e *Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit 2015-2020*. Sidoqoftë, shtylla e strategjisë për parandalimin përfshin një spektër të gjerë aktivitetesh për të parandaluar “personat dhe grupet e cenueshme që të zgjedhin” EDhRÇT-në. Kjo mund të lejojë që perspektiva gjinore të integrohet në zotimet e saj.

Kur Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit të përfundojë në vitin 2020, përditësimi i saj do të jetë një mundësi për përfshirjen e PFGj-ve në zbatimin e strategjisë. Gjithashtu, gjenerata e tretë e Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 përfshin një objektiv të lidhur me integrimin e gjinisë në përpjekjet për të forcuar “sigurinë njerëzore”, duke përfshirë edhe aktivitetet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Këto përfshijnë seminare mbi aspektet gjinore të fenomenit të EDhRÇT-së, promovimin e grave dhe grupeve të grave në përpjekjet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së dhe nismat që synojnë riintegrimin e grave dhe fëmijëve të asociuar me ISIL/Daesh pas kthimit në Bosnjë-Hercegovinë nga Iraku dhe Siria.

# 5) POLICIMI NË KOMUNITET ME NDJESHMËRI GJINORE DHE MEKANIZMAT E REFERIMIT

**Programi për policimin në komunitet dhe mekanizmat e referimit për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Rasti Jendouba dhe Tabarka në Tunizi.**

## FAKTORËT DHE GJETJET KYÇE

- Gjatë gjithë fazës së hartimit dhe zbatimit të programit janë marrë masa që angazhimi, trajnimi dhe mentorimi i palëve të interesuara të inkurajojë sidomos gratë që të udhëheqin dhe të ndikojnë në ndryshimet institucionale;

- Programi mbështet policët vendas që ta përfshijnë analizën gjinore në analizat e sigurisë së komunitetit, me qëllim marrjen parasysh të shqetësimeve dhe ngjarjeve të sigurisë nga perspektiva e grave dhe burrave, si dhe e djemve dhe vajzave; si dhe përfshirjen aktive të grave;

- Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit periodik të programit kanë treguar se burrat, gratë, djemtë dhe vajzat po përfitojnë njësoj nga mbështetja e programit për rastet individuale;

- Rezultatet tregojnë edhe se mentoret vajza janë përgjithësisht më të angazhuara, më influencuese dhe punojnë më mirë në kryerjen e detyrave; kjo është mirëpritur nga moshatarët/kolegët e tyre meshkuj.

## KONTEKSTI

Tunizia ka kaluar disa momente të rëndësishme demokratike që pas ngjarjeve të dhjetorit të 2010-ës, ku njerëzit dolën në rrugë dhe arritën të rrëzojnë qeverinë. Këtu përmendim disa zgjedhje të lira dhe të ndershme, si dhe hartimin dhe miratimin e kushtetutës së re. Sidoqoftë, vendi ende përballet me një sërë sfidash, ku ndër kryesoret janë radikalizimi terrorist dhe mungesa e besimit të publikut te policia.

Në vitin 2015, Tunizia pësoi disa incidente të rënda terroriste, që u pasuan nga sulme kryengritëse pranë kufirit me Libinë në vitin 2016, të cilat i dhanë një goditje të rëndë ekonomisë që si pikën e saj më të fortë ka turizmin. Në tetor 2018, një grua bëri një sulm vetëvrasës pranë një vendqëndrimi të makinave të policisë në një lagje të kryeqytetit Tuniz. Në përgjithësi, tunizianët kanë qenë

pjesë e konsiderueshme e LHT-ve në Siri, Irak dhe Libi, ku shumica u futën në radhët e ISIL/Daesh.[215]

Për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm në nivel vendor, Ministri i Brendshëm i Tunizisë mbështeti qeverinë holandeze[216] dhe një grup ekspertësh të Ekipit të Kundër-Ekstremizmit të Strategjisë Aktis[217] krijoi një model partneriteti komunitet-polici në janar 2017.[218] Programi është zbatuar në dy bashki të governoratit Jendouba në veriperëndim të Tunizisë, në qytetin Jendouba dhe në qytezën Tabarka. Programi angazhon edhe politikëbërës në nivel governorati dhe në nivel kombëtar për harmonizimin e komponentëve operacionalë të modelit me strategjitë kombëtare të kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për të ndikuar te vendimmarrja bazuar në mësimet e nxjerra "nga terreni".

## MODELI JENDOUBA

Figura 1: **Modeli Jendouba**

Please, send us the translation of figura 1.




Ky program për ndërtimin e besimit komunitet-polici për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm filloi si projekt pilot në Jandouba dhe Tabarka, me qëllim krijimin dhe promovimin e një modeli në kontekstin tunizian për policimin në komunitet dhe për angazhimin kundër ekstremizmit të dhunshëm, bazuar në praktikat e mira holandeze dhe praktikat ndërkombëtare. 18 muajt e parë të programit iu kushtuan krijimit të një modeli të zbatueshëm, udhëhequr nga policia në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë vendore dhe me burime të tjera me bazë komunitetin.

Në përgjithësi, ky model ka synuar të identifikojë individët që duket se kanë prirje për sjellje të dhunshme ekstremiste dhe t'i referojnë ata drejt ndërhyrjeve që i ndërpresin ato prirje, duke ngritur edhe kapacitetet që mund të kontribuojnë në marrëdhëniet më të gjata të besimit dhe në bashkëpunimi mes komunitetit dhe policisë.

---

215 Për informacion të gjerë mbi këtë fenomen, shih "Vlerësimi i Kërcënimit që Paraqesin Luftëtarët e Huaj Tunizianë" (*Institut Tunesien des Etudes Stratégiques*, janar 2018). Gjendet në: http://www.ites.tn/fr/english/Assessing-the-Threat-Posed-by-Tunisian-Foreign-Fighters/15

216 Përmes Ambasadës në Tunizi.

217 Me ekspertizë në reformat dhe tranzicionet në sektorin e sigurisë, qeverisjen politike dhe drejtësinë/shtetin e së drejtës, Ekipi i Kundërekstremizmit të Strategjisë Aktis është i specializuar në hartimin, menaxhimin dhe vlerësimin e programeve kundër ekstremizmit të dhunshëm/kundërterrorizmit bazuar në evidenca, në shumë shtete të brishta dhe të prekura nga konfliktet. Ekspertët kryesorë që hartuan dhe drejtuan "Modelin Jendouba" ishin Barbara Chalghaf, Saskia Marsh, Kathleen White dhe Tim Donnelly.

218 Programi bazohet në dy modele holandeze të përshtatura për kontekstin tunizian: Agjenti *Wijk* (efektiv ndërlidhës i policimit në komunitet) dhe rrjetet e trajnuara të mentorëve komunitarë.

Për këtë, policët e specializuar për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe mentorët e të rinjve të programit ofrojnë mbështetje mbrojtëse të drejtpërdrejtë ose angazhojnë ekspertë të komunitetit (si p.sh. profesionistë të shëndetit apo njësitë policore të mbrojtjes së fëmijëve) për parandalimin dhe trajtimin e llojeve të ndryshme të abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit (p.sh. dhuna në familje), apo lloje të tjera rrethanash të dëmshme (p.sh. abuzimi me substancat).

Ky model përfshin një mekanizëm referimi dhe një sistem të administrimit të çështjeve për individët e cenueshëm. Përveç kësaj, ka edhe një komponent specifik të angazhimit në komunitet që udhëhiqet nga ekipe efektivësh ndërlidhës dhe mentorë të të rinjve. Këta komponentë kryesorë përshkohen nga tre shtylla kyçe: ndjeshmëria gjinore, ndjeshmëria ndaj konflikteve dhe ngritja e kapaciteteve tuniziane për matjen e rezultateve dhe ndikimeve.

Gjatë gjithë fazës së hartimit dhe zbatimit të tij, programi është kujdesur që angazhimi, trajnimi dhe mentorimi i palëve të interesuara të inkurajojë sidomos gratë që të udhëheqin dhe të ndikojnë në ndryshimet institucionale. Praktikisht, kjo do të thotë, për shembull, që ekipet e mentorëve të të rinjve kanë balancim gjinor dhe aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit merren posaçërisht me aktoret gra dhe me OJF-të e grave.

Në qytetin Jendouba, aktivitetet e fundit në komunitet të ekipit që mentoron të rinjtë përfshinin takimet me nënat, si për shembull për të diskutuar rreth vazhdimit të shkollës nga fëmijët dhe për të rritur ndërgjegjësimin mes partneriteteve me OJF-të vendase lidhur me shëndetin e grave.

Projekti mbështet edhe efektivët e policisë vendase në përfshirjen e analizës gjinore në analizat e tyre të sigurisë së komunitetit, për të garantuar marrjen parasysh të shqetësimeve dhe ngjarjeve të sigurisë si nga perspektiva e grave, ashtu edhe nga ajo e burrave, djemve dhe vajzave, si dhe inkurajon përfshirjen e grave në mënyrë aktive. Pikat fokale të mentorimit të të rinjve që janë anëtarë të komitetit të referimit të rasteve të kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm përbëhen nga një djalë dhe një vajzë. Ekipet e policisë ndërlidhëse të komunitetit kanë secili të paktën një efektiv grua.

Aktorët tunizianë gjithnjë e më shumë lobojnë për modelin Jendouba. Është hera e parë në Tunizi dhe në mbarë rajonin e Afrikës Veriore që një qasje e tillë shumëpalëshe zbatohet me sukses.

## REZULTATET

Në intervale të ndryshme kohore, projekti ka kryer një analizë të efekteve të planifikuara dhe të paplanifikuara pozitive dhe negative që aktivitetet kanë pasur në çështjet politike, gjinore dhe të konflikteve. Rezultatet treguan se:

- Burrat, gratë, djemtë dhe vajzat kanë përfituar njësoj nga mbështetja që programi jep për rastet individuale (ka pasur raste për secilën kategori);
- Efektivet ndërlidhëse gra në komunitet janë po aq të angazhuara sa kolegët e tyre burra dhe mund të kontribuojnë dhe të drejtojnë njësoj brenda

kuadrit të kufizimeve që rrjedhin nga rangu dhe detyrat e përditshme;

- Në përgjithësi, mentoret gra të të rinjve janë njësoj të angazhuar dhe me ndikim, në mos më shumë, sesa bashkëmoshatarët/kolegët e tyre burra dhe arrijnë rezultate më të mira në kryerjen e detyrave, diçka që burrat e kanë mirëpritur;

- Ka shenja se planet vendor të parandalimit (planet e veprimit të efektivëve të ndërlidhjes në komunitet dhe ekipet e mentorimit të të rinjve) po përfshijnë perspektivën dhe kapacitetet e grave, dhe se aktivitetet e ekipeve të mentorimit të të rinjve fokusohen posaçërisht te gratë dhe organizatat e grave në masat parandaluese.

Me kalimin e kohës, objektivi është që pjesëmarrja e grave të rritet më tepër. Kjo mund të arrihet duke përfshirë më shumë përfaqësuese të autoriteteve ligjore vendore drejtpërdrejt në mekanizmin e referimit kundër ekstremizmit të dhunshëm, si edhe duke garantuar që ekipet e mentorimit të të rinjve të përfshijnë rregullisht gra dhe vajza në aktivitetet e tyre të komunikimit dhe të kenë masa të tjera mbrojtëse.

Propozimi për fazën e tretë të programit[219] bazohet në mësimet e nxjerra nga rritja e ndërgjegjësimit gjinor dhe fuqizimit të grave. Gjithashtu, synon të evidentojë mënyra specifike - brenda programit ose përmes partneriteteve plotësuese - të pajisjes së efektiveve gra me aftësi teknike për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe me aftësi mbrojtëse, nxitjen e mentorimit për zhvillimin në karrierë përmes lidhjeve me shoqatën e efektiveve të policisë tuniziane (*La Ligue Nationale Tunisienne De La Femme Policière*) në Tunizi dhe trajnimin e efektivëve burra dhe gra për integrimin e aspektit gjinor dhe për aftësi drejtuese.

219 Gjatë hartimit të këtij udhëzuesi, Faza III pritej të financohej nga qeveria holandeze.

# 6) VERBËRIA GJINORE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE

## Rasti i hetimit dhe gjyqit të Beate Zschäpe në Gjermani

### FAKTORËT DHE GJETJET KYÇË

- Autorët e dyshuar të veprës penale që janë nën hetim policor dhe në gjyq përballen me paragjykime të ndryshme në varësi të gjinisë së tyre;
- Gratë, sidomos ato nga popullatat që përbëjnë shumicën, shpesh stereotipizohen si individë më paqësorë, jo të dhunshëm, të dashur dhe të përkujdesur, gjë që mund të rezultojë në mangësi të rënda dhe momente verbërie në hetimet penale;
- Paragjykimet gjinore në procedimet penale mund të shumëfishohen nga media dhe publiku, duke shtuar rrezikun e mangësive në këto procedime;
- Agjencitë ligjzbatuese dhe administrata gjyqësore duhet të trajnohen mbi temën e paragjykimeve gjinore dhe efektet e dëmshme që mund të kenë te hetimet dhe procedimet penale.

### KONTEKSTI

Në korrik 2018, Gjykata e Lartë Rajonale në Mynih e shpalli fajtore Beate Zschäpe – pjesëtare e Lëvizjes Nacionaliste Sekrete (*Nationalsozialistischer Untergrund - NSU*), një grup terrorist i krahut të djathtë – për dhjetë vrasje, dy vendosje bombash dhe disa vrasje të mbetura në tentative dhe grabitje. Vendimi: burgim i përjetshëm.

Gjyqi zgjati për pesë vjet (437 ditë gjithsej) dhe ishte një nga gjyqet më të gjatë, më të kushtueshëm dhe më të mëdhenj në historinë e Gjermanisë.[220] Gjatë gjykimit, provat treguan se policia federale gjermane i kishte përjashtuar prej vitesh neonazistët si të dyshuar në vrasje. Mendohej se vrasjet kishin lidhje me dhunën e bandave mes popullatës gjermano-turke (9 nga 10 viktimat kishin prejardhje emigrantësh) në vend.

Hetimi zbuloi se NSU-ja ishte përballur disa herë me informatorë të paguar të shërbimit sekret brenda qarqeve neonaziste. Kur dy drejtues të NSU-së vdiqën në një vrasje-vetëvrasje në dukje pas një grabitjeje të dështuar banke në nëntor

220 Philip Oltermann, "Neonazistja gjermane Beate Zschäpe dënohet me burgim të përjetshëm për vrasjet e NSU-së" (*The Guardian*, korrik 2018). Gjendet në: https://www.theguardian.com/ëorld/2018/jul/11/german-neo-nazi-beate-zschape-gets-life-for-nsu-murders

2011, vëmendja u zhvendos te Zschäpe me shpresën se ajo do të hidhte dritë mbi aktivitetin e fshehtë terrorist të kësaj tresheje, që kishte vazhduar e padiktuar për 13 vjet.

Ndoshta shqetësimi kryesor ishte fakti se policia kishte qenë afër Zschäpe-s në disa raste, por pa pasur asnjë dyshim. Kjo pasqyron një raport të fundit të fondacionit "Amadeu Antonio", një OJF që punon kundër racizmit dhe antisemitizmit në Gjermani, ku argumentohej se gratë gjermane stereotipizohen pozitivisht, sepse konsiderohen si paqësore, jo të dhunshme, të dashura dhe përkujdesëse.[221]

Raporti vijon duke vërejtur se gratë janë përfshirë aktivisht si autore krimesh gjatë lëvizjes naziste gjermane në Luftën II Botërore në një sërë pozitash dhe funksionesh. Pas mbarimit të luftës, gratë zunë poste në organizatat ekstremiste dhe në parti politike të djathta të Gjermanisë Perëndimore. Disa prej tyre ishte organizatore dhe propaganduese ideologjike në poste drejtuese. Disa të tjera morën pjesë si anëtare të grupeve militante (ndonjëherë edhe terroriste). Këto gra shpesh fokusoheshin te të rinjtë.[222]

Raporti konstaton rritje të dukshme në 20 vitet e fundit jo vetëm të numrit të grave që mund të kategorizohen si "individë aktivë të krahut të djathtë", por edhe të grupeve të grave të angazhuara në skenën e ekstremizmit të djathtë.

Gjatë dekadave të fundit, grupet neonaziste dhe grupet nacionaliste agresive e kanë shtuar përkrahjen në Gjermani, sidomos mes të rinjve.[223] Kjo prirje sa vjen e vazhdon: në shtator 2018, demonstratat e dhunshme dhe sulmet me objektiv personat me prejardhje emigrante nga ekstremistët e krahut të djathtë në Shemnic janë hetuar dhe disa të dyshuar kanë përfunduar në pranga (të gjithë meshkuj). [224]

Ashtu si në rastin e Beate Zschäpe-s, shumica e pjesëtarëve të grupeve të dhunshme të djathta e kanë filluar "karrierën" në adoleshencë. Zschäpe arriti shpejt në poste kyçe në disa organizata të djathta në qytetin e lindjes së saj, Jena. Që atëherë, Zschäpe ishte përfshirë në disa sulme të dhunshme ndaj aktivistëve të krahut të majtë, duke konfirmuar sa i gabuar është supozimi stereotipizues për virtytet femërore se janë paqësore, të qeta dhe përkujdesëse.

---

221 "Të anashkaluara dhe të nënvlerësuara: Gratë e Grupeve të Ekstremit të Djathtë në Gjermani", Raport përmbledhës, Fondacioni „Amadeu Antonio", 2014).

222 Po aty.

223 Richard Stöss, "Zur Entëicklung des Rechtsextremismus in Deutschland" (Bundeszentrale für politische Bildung, 2015). Gjendet në: http://www.bpb.de/politik/extremismus/rechtsextremismus/198940/zur-entwicklung-des-rechtsextremismus-in-deutschland (në gjermanisht).

224 https://www.zeit.de/gesellschaft/zeitgeschehen/2018-10/chemnitz-sechs-mutmassliche-rechtsterroristen-festgenommen (në gjermanisht); https://www.nytimes.com/2018/08/30/ëorld/europe/germany-neo-nazi-protests-chemnitz.html

Në fakt, gjatë gjithë kohës që kishte qenë një nga tre udhëheqësit e NSU-së, Zschäpe kishte shfrytëzuar pikërisht këto pikëpamje paragjykuese me bazë race dhe gjinie, që të fshihte me sukses aktivitetin e saj kriminal. Sikurse tregon rasti i saj studimor në NSU, për qëllimet e saj kriminale, ajo kishte arritur të mashtronte me sukses jo vetëm fqinjët, por edhe vetë policinë.[225]

Në fund të vitit 2006, policia mori në pyetje Zschäpe-n për ca dëmtime uji në banesën bosh të fqinjit. Gjatë marrjes në pyetje në komisariat, ajo kishte dhënë përgjigje kontradiktore dhe një emër të ndryshëm nga ai që kishte pasur në kartën e saj të identitetit. Me gjithë sjelljen e saj të dyshimtë, policia nuk ishte alarmuar.[226]

Më vonë, kur Zschäpe u vetëdorëzua, policia (dhe sidomos media) në vend që të analizonte prirjen e grave në organizatat e dhunshme të krahut të djathtë apo vetë biografinë e Zschäpe-s, shpenzoi shumë kohë me hamendësime se ajo kishte marrëdhënie seksuale me dy pjesëtarët e tjerë të celulës dhe se kishte luajtur rol pasiv dhe të papërfillshëm në krimet e dhunshme të kësaj tresheje. Kjo vërteton se si matet pesha e grave në grupet e dhunshme ekstremiste, duke i vendosur ato në kontestin e marrëdhënieve seksuale me burrat, gjë që rezulton në boshllëqe gjatë hetimit të ekstremizmit të dhunshëm.




"Djalli i pispillosur." Tabloidi kryesor gjerman *Bild* raporton mbi gjyqin e NSU-së më 7 maj 2013, me Beate Zschäpe në kryeartikull.

Gjatë gjyqit, vëmendja e medias u përqendrua te veshja, modeli i flokëve dhe mimika e Zschäpe-s,[227] por nuk kishte ndodhur aspak kështu me të dyshuarit meshkuj në të njëjtin gjyq. Po kështu, u komentua shumë mungesa e saj e dhembshurisë për viktimat, ndërkohë që po i njëjti fakt nuk u nënvizua në rastin e të dyshuarve meshkuj.

225 Ulrich Overdieck, "Të anashkaluara dhe të nënvlerësuara: Gratë e Grupeve të Ekstremit të Djathtë në Gjermani" Rast studimor për Beate Zschäpe (Fondacioni „Amadeu Antonio", 2014).

226 Po aty.

227 Shih për shembull: https://www.n-tv.de/politik/Wie-man-Beate-Zschaepe-deuten-koennte-article10688391.html (në gjermanisht).

# Kapitulli VI: Udhëzime për integrimin e perspektivës gjinore në sektorin e sigurisë

Ky kapitull synon të ofrojë një udhëzim hap pas hapi për oficerët e vijës së parë të zbatimit të ligjit dhe zyrtarët e lartë të zbatimit të ligjit që punojnë në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, si dhe për akademitë policore. Është ndërtuar i mbështetur mbi mësimet e nxjerra nga çështjet e përgjithshme gjinore në sektorin e sigurisë në Kapitullin IV dhe në rastet studimore nga rajoni i OSBE-së, të dokumentuara në Kapitullin V.

## Oficerët e vijës së parë

Oficerët e vijës së parë janë aktorë thelbësorë në ndërtimin e besimit dhe marrëdhënieve me komunitetet ku shërbejnë. Oficerët e vijës së parë që punojnë në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, mund të jenë oficerë policie që kryejnë patrullime të rregullta, veprimtari komunitare policimi ose hetime kriminale. Udhëzimet e mëposhtme janë hartuar posaçërisht për ata oficerë që punojnë të shpërndarë në komunitet, me parandalimin e EDhRÇT-së dhe me patrullime në komunitet.

Në të gjitha këto fusha, është absolutisht i nevojshëm një kuptim i shëndoshë i roleve dhe qëndrimeve të ndryshme gjinore, si dhe i marrëdhënieve dhe dinamikës së fuqisë mes burrave dhe grave. Kjo është e vërtetë jo vetëm që veprimtaria të jetë plotësisht efikase, por edhe që të jetë në gjendje të vendosë dhe ushqejë marrëdhënie të besueshme në një komunitet.

Për oficerët e angazhuar në komunitet, që kërkojnë më së shumti të vendosin marrëdhënie me komunitetin pa mbledhur informacion specifik për qëllime informative, është veçanërisht e rëndësishme që kjo të theksohet në të gjitha bashkëbisedimet ku përfshihen.

Oficerët e vijës së parë, në mënyrën më ideale, duhet të shihen si partnerë nga udhëheqësit fetarë, pjesëtarë të tjerë të rëndësishëm të komunitetit, si dhe nga mësuesit e prindërit. Kjo do të thotë që duhet të jenë të aftë të krijojnë marrëdhënie si me burra, ashtu edhe me gra.

Në disa komunitete, oficerët e policisë mund të kenë nevojë të bëjnë përpjekje shtesë për t’u siguruar që të kenë qasje te gratë e vajzat. Për arsye të ndryshme, gratë mund të mos jenë aq të dukshme në rrugë, në qendra komunitare apo në vende publike, si kafenetë. Siç ilustrohet në shembullin studimor të policisë së Oslos në kapitullin V, është thelbësore që gratë të bëhen pjesëtare të skuadrave të angazhimit komunitar, për të siguruar këtë qasje edhe te gratë dhe te vajzat.

Sa herë që oficeri i policisë flet me anëtarët e komunitetit, ai shfaq vetëdijësimin dhe qëndrimin e tij lidhur me gjininë. Tregohet i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore ose i verbër ndaj tyre. Prandaj, është me rëndësi të madhe integrimi i konsideratave mbi gjininë në reflektimet dhe pyetjet e tyre.

Kur policia merr një kërkesë për të ndërhyrë, ka disa pyetje kyçe që duhen bërë:

| PYETJET[228] | ASPEKTET GJINORE |
|---|---|
| A ka rol policia në këtë kërkesë? | • Për t'u marrë me kërkesën, është i nevojshëm oficer mashkull apo femër?<br>• Burrat/gratë që duan të flasin për këtë kërkesë, a mund të qëndrojnë të sigurt në mjedisin ku ndodhen?<br>• Burrat dhe gratë e përfshirë në këtë kërkesë, a duhen ndarë nga njëri-tjetri për bisedime fakt-mbledhëse? |
| Nëse po, cili është konkretisht roli i policisë? | • Personat e përfshirë në kërkesë, a kërkojnë mbrojtje të posaçme?<br>• A kanë nevojë për mbrojtje të posaçme pjesëtarët e tjerë të familjes?<br>• Ndërhyrja nga policia, si urdhërimi i ndalimit, mund të ketë ndikime negative për shtëpinë? Nëse po, si mund të zbutet ky rrezik? |
| Nëse jo, kush duhet mandatuar për të dhënë shërbimin e duhur për këtë kërkesë? | • A ka oficerë të tjerë specifikë policie të shërbimit në komunitet që kanë përcaktuar ekspertizë për shërbimin e kërkuar?<br>• A duhet të zbatohen mekanizmat referuese të komunitetit? |
| Si mund të angazhohet policia me agjencinë e duhur? | • A ka pika specifike fokusi që kanë lidhje me oficerë policie të shërbimit në komunitet? |

Oficerët e vijës së parë janë të pozicionuar mirë edhe për të punuar me agjenci të tjera dhe oficerë të shërbimit në komunitet, për të ndërmarrë trajnime dhe veprimtari për ngritjen e kapaciteteve në komunitetet ku punojnë. Ngritja e shënjestruar e kapaciteteve mund të trajtojë, për shembull, gratë e burrat e komuniteteve pakicë ose individë që mendohet se kanë rrezik nga EDhRÇT-ja (shih rastet studimore më sipër, mbi RCMP në Toronto dhe policinë e Oslos).

228 Tri nga këto pyetje përdoren zakonisht nga ekipe të angazhimit në publik në Toronto (për më tepër hollësi, shih rastin studimor të Kanadasë, Kapitulli V).

*Tema për aktivitete të tilla mund të përfshijnë:*

- Të drejtat civile dhe barazia gjinore;
- Aftësitë e kujdestarisë dhe prindërimit për burrat dhe për gratë;
- Funksionimi i institucioneve shtetërore dhe roli i policisë në veçanti;
- Të drejtat qytetare të ndërlidhura me ligjin;
- Parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe çfarë duhet bërë nëse shenja të tyre shfaqen në familje apo komunitet;
- Dhuna me bazë seksuale ose gjinore;
- Parandalimi i krimeve dhe shkeljeve;
- Ngacmimet seksuale;
- Krimet e urrejtjes.

# Drejtuesit e lartë

Mbështetja dhe kontributi aktiv i administratorëve dhe drejtuesve të lartë është jetësor për të siguruar që institucionet e zbatimit të ligjit t'i integrojnë konsiderimet gjinore në punën e tyre strategjike dhe praktike mbi parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Për këtë arsye, drejtuesit e lartë duhet t'i kuptojnë plotësisht përparësitë e përfshirjes së konsideratave gjinore në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, si dhe çfarë hapash duhen ndërmarrë për ta bërë këtë.

*Ndër të tjera, drejtuesit e lartë mund të:*

- **Zhvillojnë dhe mbështesin programe specifike shërbimi** që synojnë, në veçanti, të vendosin marrëdhënie me gratë në komunitetet pakicë. Ekipe të tilla duhet të përbëhen nga gra dhe burra, për të siguruar qasje të barabartë për gratë dhe burrat përfitues.
- **Sugjerojnë ngritjen e strukturave të brendshme që lehtësojnë integrimin e perspektivës gjinore në** parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, kur ndodhin rishikime dhe ristrukturime institucionale. Kjo mund të përfshijë caktimin e këshilltarëve gjinorë ose të pikave të kontaktit në departamente, si dhe pasjen e ekspertëve për çështjet gjinore në ekipet e shërbimit në komunitet dhe në ekipet që punojnë me anti-radikalizimin dhe terrorizmin.
- **Përcaktojnë takime të rregullta mes ekipeve të angazhuara të komunitetit dhe oficerëve që punojnë me** parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, për të ndarë informacionin e ndërlidhur dhe për t'u siguruar që ka mirëkuptim të ndërsjellë për përfitimet nga krijimi i marrëdhënieve me komunitetin.

*Për më tepër, drejtuesit e lartë të zbatimit të ligjit janë në pozicionin e duhur për të **alokuar fonde** për projekte që përfshijnë çështje gjinore. Këto projekte mund të përfshijnë:*

- Nisjen e një vetëvlerësimi mbi gjendjen gjinore brenda institucionit;
- Mbështetjen e rekrutimit, ruajtjes dhe promovimit të oficereve gra në polici;
- Mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për gratë e komuniteteve pakicë lidhur me të drejtat qytetare dhe rolin e policisë;
- Mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për burrat e rinj, siç është mashkulloriteti pozitive.

*Po ashtu, është e këshillueshme që drejtuesit e lartë:*

- **Të sjellin në qendër të vëmendjes çështjet gjinore në të gjitha programet që zhvillojnë**. Për ta bërë me efektivitet këtë, duhet të kryejnë analiza gjinore që mbulojnë të gjitha fazat e programit, duke nisur nga llogaritjet e programit apo faza përgatitore e duke përfunduar te monitorimi dhe vlerësimi. Analiza gjinore mundëson identifikimin e normave specifike të kontekstit, të stereotipeve, marrëdhënieve dhe dinamikës së pushtetit që formësojnë rolet gjinore. Njohja e këtyre çështjeve të brendshme të institucionit dhe ekipi i menaxhimit të programit janë po aq të rëndësishme sa edhe të kuptuarit e tyre në kontekstin e komunitetit përfitues.

*Në procesin e vlerësimit paraprak të një programi të planifikuar ose në bërjen e kërkimeve bazë për të, pyetjet e ndjeshme mbi temat gjinore mund të përfshijnë nëse:*

- Programi shqyrton gjendjen sociale, ekonomike, kulturore dhe/ose politike të burrave dhe grave. Në një program për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, një shembull i kësaj do të ishte nëse ka dallime gjinore në ndonjë nga faktorët shtytës-tërheqës drejt radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Ai mban parasysh ndikimet e ndryshme që do të kenë mbi burrat dhe gratë masat që do të zhvillohen, duke përfshirë edhe ndikimet negative. Për shembull, kur zhvillon masat për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, duhet pyetur nëse ka numër të mjaftueshëm oficeresh gra në forcën e punës, për të kontaktuar me gratë e komuniteteve pakicë.
- Të dhënat që vlerësojnë çështjen e trajtuar janë zbërthyer sipas gjinisë dhe, nëse jo, a ka pasur ndonjë arsye që nuk është bërë kjo.
- Është konsultuar apo jo ndonjë organizatë femërore me peshë apo nëse mund të përdoret informacioni nga kjo organizatë.

*Çështjet e ndjeshme gjinore lidhur me veprimtaritë e planifikuara të programit dhe objektivat e tij mund të përfshijnë nëse:*

- Objektivat e programit trajtojnë nevojat e burrave dhe të grave, duke përfshirë edhe nevoja të veçanta për gratë dhe vajzat dhe, nëse po, nëse janë treguar qartë.
- Veprimtaritë e propozuara trajtojnë në mënyrën e duhur përmasat gjinore të theksuara në kërkimin vlerësues dhe sfondin e programit. Për shembull, nëse programi synon gratë në rrezik nga EDhRÇT-ja, duhet të përfshijë vetëdijësimin për normat dhe paragjykimet gjinore që përdorin zakonisht organizatat terroriste.
- Programi është zhvilluar dhe vlerësohet rregullisht së bashku me oficere gra të policisë dhe oficeret gra të zbatimit të ligjit.
- Ka pengesa apo rreziqe për gratë e përfshira në program dhe, nëse po, cilat janë e si mund të kapërcehen ose zbuten. Për shembull, kur zhvillon veprimtari mbi ngritjen e kapaciteteve për gratë nga komunitetet pakicë lidhur me atë se si të identifikohen shtysat dhe rreziqet e radikalizimit, duhet pyetur nëse kjo mund të bëhet në mjedisin e tyre të jetesës apo nëse këto gra kanë nevojë për një hapësirë të sigurt.
- Veprimtaritë e programit kanë ndikime potenciale negative, në veçanti mbi të drejtat e njeriut për gratë dhe, nëse po, a mund të gjenden hapa zbutëse.

*Drejtuesit e lartë duhet gjithashtu:*

- Të marrin masat që procedurat standarde të operimit dhe protokollet e vlerësimit të riskut të **pasqyrojnë dallimet gjinore**. Për shembull, kur vlerëson prirjen e një personi specifik për t'u përfshirë në EDhRÇT, në këtë vlerësim duhet të mbahet parasysh edhe koncepti i mashkulloritetit, të pranojë se fyerja apo ankesa mund të ndryshojë nga burri te gruaja dhe të pasqyrojë faktin se besimi i grave në sektorin e sigurisë mund të jetë veçanërisht i dobët.
- Të punojë me strategjitë për **të rritur rekrutimin e oficereve gra**. Gratë oficere duhet të përfshihen edhe në ekipet kundër radikalizimit dhe kundër terrorizmit, si dhe të nxiten të forcojnë aftësitë dhe njohuritë mbi këtë temë. [229]
- Të mbështesë një **mjedis pune, ku respektohen të drejtat e grave dhe të burrave, si dhe të mos ketë stereotipe gjinore**. Hapat për këtë mund të përfshijnë zhvillimin e një **politike me tolerancë zero ndaj ngacmimet seksuale dhe një kod sjelljeje për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin**. Që i gjithë personeli të jetë i vetëdijshëm për këto angazhime institucionale dhe që t'i vërë ato në zbatim, mund të përcaktohen disa pika kontakti për çështjet gjinore për mbështetjen e zbatimit të tyre dhe mund të zhvillohen veprimtari të rregullta për ngritjen e ndërgjegjësimit.

229 Shih pjesën pasardhëse mbi akademitë policore.

# Akademitë policore

Siç u theksua në Kapitullin IV, trajnimi dhe edukimi i ndërtuar enkas për çështjet gjinore dhe rëndësinë e tyre në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, është thelbësor për të siguruar efikasitetin operacional të sektorit të sigurisë si një i tërë dhe veçanërisht zbatimin e ligjit.

Akademitë e policisë, me inpute nga oficerë policie që shërbejnë në komunitet dhe nga aktorë të tjerë, si akademikët që bëjnë studime mbi tema të veçanta të mashkulloritetit ose feminitetit, janë të pozicionuar mirë për të zhvilluar dhe për t'i ofruar këto lloj trajnimesh. Ndërkaq, tema gjinore duhet të integrohet në kurrikulën bazë të trajnimit për të gjithë oficerët e policisë, si dhe në programet e trajnimit dhe edukimit të specializuar dhe të përparuar.

Përveç trajnimit specifik gjinor për të gjithë oficerët e policisë, gjinia duhet të përfshihet në të gjithë kurrikulën e akademive policore. Në kontekstin e këtij manuali, është treguar në mënyrë specifike se si mund të përfshihen çështjet gjinore në trajnime për policimin në komunitet dhe për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

*Trajnimi gjinor bazë duhet të përfshijë:*

- Përkufizimin e gjinisë, ndërgjegjësimit gjinor, barazisë gjinore dhe përhapjen e çështjeve gjinore;
- Shpjegimin pse çështjet gjinore kanë rëndësi në nivel institucional dhe në punën aktive të policisë;
- Ligjet dhe rregulloret e zbatueshme lidhur me gjininë në një vend apo kontekst të caktuar, si dhe politikat institucionale që i vënë në zbatim këto ligje;

Trajnimi mbi çështjet gjinore apo parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, duhet të përfshijë një njohje të përgjithshme të kuadrit ndërkombëtar lidhur me gjininë dhe parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë edhe dokumentet përkatëse të UNSCR-së apo ato strategjike të OKB-së dhe OSBE-së. Mbi të gjitha, duhet të përfshijnë Deklaratën e Këshillit Ministror të OSBE-së nr. 4/15 mbi parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së si dhe rishikimin e 6-të të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për Strategjinë Globale mbi Kundërterrorizmin.

Ai duhet të diskutojë edhe pse ndërgjegjësimi gjinor ka rëndësi në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Kjo jo vetëm që përfshin rolet e ndryshme që mund të luajnë gratë në parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, por edhe rolin e tyre si kontribuuese aktive në kundërvënien ndaj EDhRÇT-së dhe krimeve që lidhen me të. Trajnimi duhet të shpjegojë gjithashtu nocionin e "mashkulloritetit toksik", si dhe të faktorëve shtytës dhe tërheqës drejt EDhRÇT-së, veçanërisht tek djemtë.

Për të siguruar lidhjen e vazhdueshme dhe efektivitetin e trajnimeve që adresojnë gjininë, si trajnimi bazë, ashtu edhe ai i përparuar, duhet t'i nënshtrohen një procesi vlerësimi. Përpjekje specifike duhet t'i kushtohen zhvillimit të treguesve të përcaktuar për matjen e ndryshimeve të sjelljes së pjesëmarrësve, si dhe ndryshimeve në qëndrime. Akademitë e policisë duhet gjithashtu të kujdesen që grupet e trajnimit të përfshijnë si burra, ashtu edhe pjesëmarrëse gra.

Oficeret gra që punojnë me policimin në komunitet ose me njësitë e policimit të patrullimit apo me policimin me bazë inteligjencën, duhet të jenë objektiv i veçantë i këtyre trajnimeve dhe të nxiten për të marrë pjesë në trajnime të përparuara dhe të specializuara për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, për të rritur gjasat që gratë të bashkohen me njësitë/ekipet e anti-radikalizimit dhe anti-terrorizmit. Një trajnim i tillë i specializuar për gratë oficere mund t'i pajisë ato me aftësi të tjera ndër-kulturore, me një lloj ndjeshmërie ndaj konflikteve dhe me aftësi të dobishme komunikuese për t'u afruar me komunitetet e pakicave.



# Kapitulli VII: Integrimi i perspektivës gjinore në strategji, politika dhe programe për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

Rastet e studimit dhe studimet e paraqitura në këtë manual, së bashku me përvojën e ekspertëve dhe profesionistëve të konsultuar në kuadrin e hartimit të këtij udhëzuesi, kanë dalë në një sërë përfundimesh kyçe që rekomandojnë të merren parasysh nga aktorët e sektorit të sigurisë në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në integrimin e aspektit gjinor në strategjitë, politikat dhe programet e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së.

# Analiza gjinore

Para se të zhvillohen strategji, politika dhe programe për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, aktorët e sektorit të sigurisë duhet të bëjnë një analizë të veçorive specifike të kontekstit dhe të dallimeve mes grave/vajzave dhe burrave/djemve, për të parë se si mund të ndikojnë ato për arritjen e përpjekjeve efikase dhe të qëndrueshme.

Analiza gjinore lejon të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i dallimeve midis grave dhe burrave në shpërndarjen e burimeve, mundësive, kufizimeve dhe strukturave të pushtetit në një kontekst të caktuar. Kjo është veçanërisht e nevojshme për t'u siguruar që çdo ndryshim gjinor në faktorët që nxisin EDhRÇT-në në një komunitet të caktuar, të llogaritet para se të fillohen përpjekjet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Kjo mund të ndihmojë aktorët e sektorit të sigurisë që të kuptojnë se çfarë i motivon njerëz të ndryshëm të bëhen pjesë e rrjeteve ekstremiste dhe terroriste. Analiza gjinore mund të vlerësojë gjëra të tilla si:

- Ndikimi i roleve dhe normave gjinore në strategjitë e rekrutimit të organizatave të dhunshme ekstremiste;
- Dallimet në rolet e grave dhe burrave brenda organizatave të dhunshme ekstremiste të synuara;
- Ndikimi i mundshëm i këtyre ndryshimeve në programet e shkëputjes, çradikalizimit dhe ri-integrimit;
- Rolet specifike gjinore në strukturat e familjes dhe si mund të ketë kjo ndikime të ndryshme në ri-aftësimin e anëtarëve të familjes kundër rekrutimit për ekstremizëm të dhunshëm;
- Kufizimet dhe mundësitë për ngushtimin e hendeqeve gjinore dhe fuqizimin e grave në strategjitë parandaluese;
- Ndikimet e ndryshme potenciale të strategjive, politikave dhe programeve për gratë/vajzat dhe burrat/djemtë, duke përfshirë edhe rrjedhojat e paqëllimta ose negative.

Aktorët e sektorit të sigurisë nuk duhet të kenë patjetër "ekspertizë gjinore" për të kryer analiza të tilla. Ata duhet vetëm të kenë kohë për të shqyrtuar faktorët e mësipërm. Janë zhvilluar shumë mjete ndihmëse për këto analiza, mjete që nuk kërkojnë ekspertizë në çështjet gjinore. Ato përfshijnë disa pyetje që mund të bëhen nga aktorët e sektorit të sigurisë për t'u siguruar që dallimet gjinore dhe dinamika e tyre janë pjesë e strategjive, politikave dhe programeve në të gjithë ciklin e jetës së këtyre përpjekjeve.[230]

230 Për shembuj pyetjesh të tilla, shih: *Integrimi Gjinor i Thjeshtuar: Udhëzues për Stafet e Programeve* (Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, 2013), f. 22-23. Gjendet në: http://www.undp.org/content/dam/somalia/docs/Project_Documents/Womens_Empowerment/Gender%20Mainstreaming%20Made%20Easy_Handbook%20for%20Programme%20Staff1.pdf

# Personeli gjinor

Institucionet e sektorit të sigurisë të përfshira në përpjekjet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së duhet të investojnë burime të dedikuara stafit që mbulon çështjet gjinore, në mënyrë që këto institucione ta integrojnë ndjeshmërinë gjinore në punën e tyre. Në kushte ideale, do të duhet të kishte këshilltarë gjinorë me kohë të plotë, që të shërbenin si ekspertë teknikë për integrimin e ndërgjegjësimit gjinor në tërësinë e punës së këtyre institucioneve për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Kjo mund të përfshijë edhe trajnimin e pikave të kontaktit mbi çështjet gjinore (jo domosdoshmërisht këshilltarë me kohë të plotë[231]), të cilët mund të ofrojnë mbështetje të përditshme për zyra, departamente apo lloje të tjera subjektesh brenda institucionit. Për më tepër, i gjithë personeli i sektorit të sigurisë duhet të trajnohet se si ta integrojë perspektivën gjinore në punën e tij.

Puna e të gjithë personelit gjinor në institucionet e sektorit të sigurisë duhet të ketë një mandat të qartë, të mbështetur nga drejtuesit e lartë. Pa këtë mbështetje, është vënë re se këshilltarët gjinorë dhe pikat e kontaktit përballen shpesh me kufizime në mundësinë e tyre për të ndikuar ose për të imponuar përgjegjshmërinë gjinore në punën e të gjithë personelit. Përfundimisht, mbështetja nga drejtuesit e lartë mund të jetë shpesh një nga faktorët më të rëndësishëm në suksesin e personelit gjinor. Rrjetet që ofrojnë takime sistematike, trajnime dhe shkëmbime informacionesh ndërmjet personelit të dedikuar gjinor, janë po ashtu thelbësore për suksesin e tyre.

Që personeli gjinor të jetë më efikas, brenda institucioneve të sektorit të sigurisë duhet të ngrihen mekanizma raportimi që u japin mundësi drejtuesve të lartë që t'u kërkojnë llogari subjekteve për ecurinë sa u përket çështjeve gjinore dhe monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit të kësaj pune. Kritik për këto përpjekje është integrimi i këtyre mekanizmave raportuese në strategjitë kombëtare mbi parandalimin e EDhRÇT-së, si dhe në planet kombëtare të veprimit për gratë, paqen dhe sigurinë, dhe garantimi se ka ekziston e njëjta qasje midis këtyre strategjive. Është krijuar një varg rekomandimesh dhe librash udhëzues që mund t'u vijnë në ndihmë aktorëve të sektorit të sigurisë në krijimin e këtyre mekanizmave raportues.[232]

---

231 Shih, për shembull, rrjetin e krijuar nga Ministria e Sigurisë së Bosnje Hercegovinës, për të cilin flitet më sipër , f. 78.

232 Shih, për shembull, *Reference Guide: Developing National and Regional Action Plans to Prevent Violent Extremism* (Zyra për Anti-terrorizmin e Kombeve të Bashkuara, Botimi i parë). Gjendet në: https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/sites/www.un.org.counterterrorism.ctitf/files/UNOCT_PVEReferenceGuide_FINAL.pdf

# Nisma për ngritjen e kapaciteteve

Personat e rrezikuar nga EDhRÇT-ja dhe komunitetet përreth tyre ka të ngjarë të bien në kontakt me aktorët e sektorit të sigurisë, veçanërisht me pjesëtarë të skuadrave të zbatimit të ligjit. Mënyra se si e kuptojnë aktorët e zbatimit të ligjit kërcënimin dhe ndikimin e tij në komunitete, përcakton edhe sa efikase janë përgjigjet e tyre. Po ashtu, me rëndësi është edhe të kuptuarit se si lidhet dinamika gjinore me EDhRÇT-në dhe si ndikon ajo në komunitetet në të cilat jetojnë ose me të cilat bashkëveprojnë individë të rrezikuar të përfshihen në radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm. Nuk mund të supozohet se çdo aktor i sektorit të sigurisë ka një kuptim të qartë të këtyre dinamikave gjinore. Prandaj rekomandohet që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së të investojnë burime në nisma trajnimi për aktorët e sektorit të sigurisë, me qëllim integrimin e çështjeve gjinore në operacionet e tyre. Drejtuesit në këto institucione duhet të krijojnë mundësi që personeli i tyre të marrë pjesë në trajnime të tilla dhe, më pas, t'i bëjnë përgjegjës këta pjesëtarë të personelit për vënien në zbatim në punën e tyre të përditshme të asaj që kanë mësuar.

Siç e ka bërë të qartë ky manual, të kuptuarit e shtrirjes së pjesëmarrjes së grave kundër ekstremizmit të dhunshëm mund të përftohet përmes nismave për krijimin e kapaciteteve. Kjo përfshin dallimet gjinore në rolet e luajtura nga gratë dhe burrat brenda organizatave të ekstremizmit të dhunshëm dhe mënyrën se si përdorin këto organizata norma gjinore, stereotipe dhe dinamika për të çuar përpara rekrutimet dhe operacionet e tyre. Ky manual mund të ndihmojë në krijimin e një kurrikule për një trajnim të tillë.

Për më tepër, nismat e dedikuara për ndërtimin e kapaciteteve për aktoret femra të sektorit të sigurisë, veçanërisht për policinë, për një spektër të gjerë të çështjeve që lidhen me EDhRÇT-në, shpesh janë të nevojshme, sidomos në kontekstet në të cilat gratë nuk përfaqësohen në mënyrë domethënëse në këto institucione dhe/ose aktualisht nuk shërbejnë në role të vijës së parë. Trajnimi i vënë në zbatim për gratë policore në Kosovë është shembulli i një nisme të tillë për ndërtimin e kapaciteteve [233]. Përfaqësimi i grave në sektorin e sigurisë është njëherazi thelbësor për të siguruar që institucionet e tij janë përfaqësuese të popullatës të cilën kanë për detyrë të mbrojnë - diçka thelbësore kjo për parandalimin/kundërvënien efikas ndaj EDhRÇT-së. Kjo do të thotë se institucionet e sektorit të sigurisë duhet të investojnë në edukimin dhe zhvillimin profesional të grave.

233 Shih më lart, Kapitulli V, pjesa 3, f. 74.

# Reforma e sektorit të sigurisë

Ky manual ka paraqitur një numër konsideratash kyçe në lidhje me integrimin gjinor në përpjekjet e reformimit të sektorit të sigurisë, veçanërisht në reformimin e drejtësisë penale. Reforma të tilla janë përbërës thelbësorë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive EDhRÇT-së. Ato përfshijnë rekrutimin e më shumë grave në role operative të policisë dhe poste drejtuese, si dhe sigurimin që oficerët e policisë meshkuj dhe femra të kuptojnë dinamikat gjinore në punën me EDhRÇT-në. Është zhvilluar një numër burimesh të vlefshme për forcimin e vëmendjes ndaj çështjeve gjinore në punën e aktorëve të sektorit të sigurisë.[234]

Në veçanti, integrimi i ndërgjegjësimit gjinor në mekanizmat e policimit të orientuar nga komuniteti është thelbësor për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Siç e ka bërë të qartë ky manual, mekanizmat e policimit të orientuar nga komuniteti nuk duhen parë thjesht si strategji apo taktikë, por duhet të përfshijnë ndryshime në qëndrimet dhe filozofinë e forcës policore, ndryshime që nxisin drejt arritjes së qëllimit për ndërtimin e besimit me komunitetet. Kjo kërkon që njësitë policore të pasqyrojnë shumëllojshmërinë (në gjini, përkatësi etnike, racë dhe fe) të komuniteteve që u shërbejnë.

Nismat e policimit të orientuara nga komuniteti në Oslo dhe Tunizi, të paraqitura në këtë manual[235], tregojnë rëndësinë së të pasurit të forcave policore, në të cilat oficeret femra dhe oficerë meshkuj shërbejnë në pozicione që u lejojnë të bashkëveprojnë dhe të krijojnë partneritete me komunitetet lokale. Kjo krijon besim, veçanërisht me komunitetet e marxhinalizuara ose të arritshme me vështirësi. Kjo mund të bëhet pjesë e rëndësishme përbërëse e përpjekjeve për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Shpesh ndodh që oficeret femra, të ngarkuara me takimin e grave në bashkësitë lokale dhe organizatat e grave, të ngjallin besim më lehtë nga sa mund ta krijojnë oficerët meshkuj. Modele të tilla duhet të mbahen parasysh nga institucionet e policisë.

# Bashkërendimi me shoqërinë civile

Mekanizmat efikase të policimit në komunitet shpesh nuk mund të zbatohen pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e organizatave të shoqërisë civile. Kjo kërkon që sektori i sigurisë t'i kushtojë kohë, vëmendje dhe burime përpjekjeve që synojnë ngritjen e besimit dhe partneritetit me të gjitha pjesët e shoqërisë civile. Është po aq e rëndësishme të trajtohen politikat dhe abuzimet e zbatimit të ligjit që mund të pengojnë ndërtimin e marrëdhënieve me organizata të tilla. Shoqëria civile ka njohuri për dinamikat lokale, çka mund të jenë të dobishme për parandalimin e krimit, përfshirë EDhRÇT-në. Policia duhet të punojë me shoqërinë civile për

---

234 Shih për shembull: Kristin Valasek, "Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Përkatësia Gjinore", Paketa për Reformimin e Sektorit të Sigurisë, Eds. Megan Bastick dhe Kristin Valasek, Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW, 2008.

235 Shih më lart, Kapitulli V, pjesa 1.2, f. 66, dhe pjesa 5.1, f. 82.

të lehtësuar përpjekjet lokale për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, si dhe për të hapur linja komunikimi për të njohur aktivitetet që përbëjnë shqetësim për komunitetet. Për arsyet e përshkruara në këtë manual, grupet e grave duhet gjithashtu të përfshihen në këtë punë.

Ky manual ka theksuar një numër modelesh për forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimin midis subjekteve të sektorit të sigurisë dhe organizatave të shoqërisë civile, si, për shembull, mobilizimi i këtyre organizatave në partneritete me policinë duke përdorur të ashtuquajturat mekanizma të referimit. Këto janë mekanizma formale ose informale që përfshijnë praktikues dhe profesionistë nga disiplina të ndryshme dhe/ose agjenci e organizata, dhe që synojnë të identifikojnë, vlerësojnë, ndihmojnë dhe trajtojnë ata që shfaqin shenja se janë në rrezik ose të cenueshëm për t'u angazhuar ose në rrugën drejt EDhRÇT-së.

Modele të tilla synojnë të angazhojnë individë që janë të cenueshëm ndaj EDhRÇT-së, edhe pse nuk përligjin veprime të zbatimit të ligjit. Kjo i hap këto mekanizma ndaj një game të gjerë ekspertize, përvoje dhe përfaqësimi të komunitetit.[236] E njëjta gjë mund të thuhet për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në të ashtuquajturat tryeza situatash, siç përshkruhet më lart [237], në të cilat policia, ofrues të tjerë të shërbimeve dhe aktorë të shoqërisë civile punojnë për të identifikuar individë, grupe dhe vende me rrezik të lartë të EDhRÇT-së, qoftë si autorë apo si viktima, dhe bashkërendojnë masat dhe ndërhyrjet e përshtatshme. Organizatat e shoqërisë civile po ashtu mund të ofrojnë një perspektivë të vlefshme dhe integrale mbi dinamikën gjinore, në lidhje me pikat e dobëta të individëve ndaj EDhRÇT-së. Kështu, aktorët e sektorit të sigurisë duhet t'i kushtojnë burime dhe vëmendje përfshirjes së organizatave të tilla. Pa investuar përpjekje për të ndërtuar besim dhe partneritete me organizata të tilla të shoqërisë civile, mund të jetë e vështirë, madje e pamundur, t'i bindësh ato që të marrin pjesë në mekanizmat e referimit.

Për më tepër, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile, përfshirë grupet ndërkombëtare, në trajnimin e sektorit të sigurisë për EDhRÇT-në, mund të ndihmojë në rritjen e të kuptuarit për natyrën e kërcënimit, si ndikon dinamika gjinore në të dhe si të përfshihen gjerësisht çështjet gjinore në punën e aktorëve të sektorit të sigurisë. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në nismat e rritjes së kapaciteteve, jo vetëm siguron që policia të shfrytëzojë një perspektivë civile mbi kërcënimin e EDhRÇT-së dhe dinamikat e lidhura me gjininë, por kjo mund të ndihmojë aktorët e sektorit të sigurisë që të kuptojnë më mirë se si veprimet e tyre mund të jenë faktor në krijimin e kushteve të favorshme të administrimit të EDhRÇT-së.

---

236 Për më tepër mbi këtë temë, shih: *Parandalimi i Terrorizmit dhe Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Qasja e Policimit në Komunitet* (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2014).

237 Shih më lart, Kapitulli V, pjesa 1.1, f. 63.

Informacione më të hollësishme mbi angazhimin me shoqërinë civile mund të gjenden në botimin e OSBE-së "Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm: Një fokus mbi Evropën Jug-Lindore". Ky është një mjet i dobishëm për zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe oficerët e policimit në komunitet[238].

# Spektri EDhRÇT

Ky udhëzues trajton problematikat kryesore lidhur me natyrën e kërcënimit EDhRÇT dhe si duhet të konsiderohet nga aktorët e sektorit të sigurisë. Mbi të gjitha, udhëzuesi thekson se aspektet gjinore duhet të jenë komponent thelbësor i përpjekjeve për P/K EDhRÇT-në. Kjo është e vërtetë për një gamë të gjerë kërcënimesh EDhRÇT dhe jo vetëm me forma specifike. Siç e konfirmojnë gjetjet, dinamikat gjinore nuk janë unike për një organizatë ekstremizmi të dhunshëm, apo për organizata me ideologji të ngjashme. Gratë luajnë një sërë rolesh në grupet dhe lëvizjet që ndjekin ideologjitë ekstremiste. Për më tepër, normat dhe stereotipet gjinore, përfshirë konceptet e mashkulloritetit dhe feminitetit, shpesh manipulohen për t'u përdor si mjet rekrutimi, për të ndërtuar kohezion grupi dhe, në disa kontekste, për shtrimin e terrenit për një sërë grupesh dhe lëvizjesh.

Është thelbësore që përfshirja e grave në EDhRÇT apo përkrahja që u ofrojnë grupeve apo lëvizjeve të tilla, të mos shihet apo të matet sikur rrjedh nga marrëdhëniet e tyre me burrat. Gratë duhet të shihen si agjentë aktivë. Për më tepër, është e rëndësishme që gratë dhe burrat të mos shihen si grup uniform. Motivimet e tyre për t'iu bashkuar organizatave të dhunshme ekstremiste ndryshojnë sipas secilit individ. Për më tepër, ndryshojnë edhe rolet që luajnë në grupe të ndryshme. Duke kuptuar dinamikat gjinore në spektrin e gjerë të kërcënimeve EDhRÇT, aktorët e sektorit të sigurisë janë në gjendje t'i përgjigjen në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme proceseve të radikalizimit ndër burrat dhe gratë që mbështesin këto grupe. Hapi i parë drejt arritjes së këtij objektivi është integrimi i gjetjeve të këtij udhëzuesi lidhur me dinamikat gjinore në nismat për ngritjen e kapaciteteve të sektorit të sigurisë.

---

238 Roli i Shoqërisë Civile në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Një Fokus mbi Evropën Jug-lindore". Gjendet në: https://www.amazon.com/Religion-Violence-Encyclopedia-Conflict-Antiquity/dp/0765620480#reader_0765620480

# Burimet e OSBE-së


Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Plani i Veprimit i Bukureshtit për Kundërvënien ndaj Terrorizmit* (2001)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Udhëzues për Parandalimin e Terrorizmit dhe Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Qasja e Policimit në Komunitet* (2014)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Reformimi i Policisë: Zhvillimet në Serbi dhe Malin e Zi* (2005)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Parandalimi i Terrorizmit dhe Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Qasja e Policimit në Komunitet* (2014)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Roli i Shoqërisë Civile në Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Fokusi te Evropa Juglindore* (2018)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Statusi i Konventave Universale dhe Protokolleve kundër Terrorizmit, si dhe i Instrumenteve të tjera Ligjore Ndërkombëtare dhe Rajonale në lidhje me terrorizmin dhe Bashkëpunimi për Çështjet Penale në Zonën e OSBE-së* (2018)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Këshilli Ministror, Deklaratë për Forcimin e Përpjekjeve të OSBE-së për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit (2016, MC/DOC/1/16).

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Asambleja parlamentare, *Deklarata e Berlinit dhe Rezolutat e Miratuara nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së në Sesionin e 27-të Vjetor* (2018)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Këshilli i Përhershëm, Takimi i 535[të] Plenar, Buletini Nr. 535 i Këshillit të Përhershëm, Pika 7 e Axhendës, Vendimi Nr. 638 2004 Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore (2004)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Këshilltari i Lartë i Policisë pranë Sekretarit të Përgjithshëm, *Udhëzues për Policimin Demokratik* (2008)

# Bibliografia

"Alek Minassian, i dyshuari për sulmin me furgon në Toronto lëvdoi vrasësin 'incel'", *BBC News* (25 prill 2018). Gjendet në: https://www.bbc.com/news/world-us-canada-43883052

Alexander, Audrey dhe Rebecca Turkington, "Trajtimi i terroristëve: Si ndikon gjinia te drejtësia?", *CTC Sentinel* 11.8 (2018). Gjendet në: https://ctc.usma.edu/treatment-terrorists-gender-affect-justice/

Almohammad, Asaad dhe Anne Speckhard, *Rangjet operacionale dhe roli i operativeve femra të ISIS: Nga vrasësit dhe policia e moralit te spiunët dhe kamikazët*, Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2017). Gjendet në: https://www.icsve.org/the-operational-ranks-and-roles-of-female-isis-operatives-from-assassins-and-morality-police-to-spies-and-suicide-bombers/

Fondacioni Amadeu Antonio, Qendra e Ekspertizës për Përkatësinë Gjinore dhe Ekstremizmin e Djathtë, *Të nënvlerësuara dhe të shpërfillura: Gratë në Grupet e Djathta Ekstremiste në Gjermani*, Raport Përmbledhës (2014). Gjendet në: http://aas18.wegewerk.org/w/files/pdfs/fachstelle/140407_overlooked-and-underrated.-german-women-in-right-wing-extremist-groups.pdf

Anderlini, Sanam dhe Victoria Stanski, *Parandalimi, Zgjidhja dhe Rindërtimi i Konflikteve, Alarmi Ndërkombëtar*, Women Waging Peace (2004) Gjendet në: https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/ToolkitËomenandConflictPreventionandResolution_InternationalAlert2004.pdf

Qendra e Ligës kundër Shpifjes për Ekstremizmin, *Kur armiku janë gratë: Ndërthurja e mizogjinisë dhe supremacisë së bardhë* (2018). Gjendet në: https://www.adl.org/resources/reports/when-women-are-the-enemy-the-intersection-of-misogyny-and-white-supremacy

Arutunyan, Anna, *Të kthyerit e ISIS sjellin si shpresë, ashtu edhe frikë në Çeçeni*, Grupi Ndërkombëtar i Krizave (26 mars, 2018). Gjendet në: https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/caucasus/chechnya-russia/isis-returnees-bring-both-hope-and-fear-chechnya

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 (2012). Gjendet në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf

Azinović, Vlado, Forumi i Ballkanit Perëndimor për Studimet mbi Ekstremizmin: Raport Rajonal: *Ekstremizmi i Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor* (2018). Gjendet në: https://www.rcc.int/p-cve/docs/198/western-balkans-extremism-research-forum--regional-report--understanding-violent-extremism-in-the-ëestern-balkans-2018

Barrett, Richard, *Përtej Kalifatit: Luftëtarët e Huaj dhe Kërcënimi i të Kthyerve*, Qendra Soufan (2017). Gjendet në: https://thesoufancenter.org/ëp-content/uploads/2017/11/Beyond-the-Caliphate-Foreign-Fighters-and-the-Threat-of-Returnees-TSC-Report-October-2017-v3.pdf

Barsa, Michelle, *Qasjet e ShBA-së në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm duhet t'i japin prioritet grave*, New America (2015). Gjendet në: https://www.newamerica.org/ëeekly/edition-72/us-approaches-countering-violent-extremism-must-prioritize-women/

Bennhold, Katrin, "Protesta e Chemnitz-it tregon forcën e re të së djathtës ekstremiste të Gjermanisë," *New York Times* (30 gusht 2018). Gjendet në: https://www.nytimes.com/2018/08/30/world/europe/germany-neonazi-protests-chemnitz.html

Bigio, Jamille dhe Rachel Vogelstein, *Si i çon përpara interesat e ShBA-së pjesëmarrja e grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve*, Këshilli për Marrëdhëniet me Jashtë (tetor 2016). Gjendet në: https://www.cfr.org/report/how-womens-participation-conflict-prevention-and-resolution-advances-us-interests

Blee, Kathleen, et al., "Pse largohen gratë nga e djathta ekstreme", Qendra e Universitetit të Oslos për Studime mbi Ekstremizmin (9 korrik 2018). Gjendet në: https://www.sv.uio.no/c-rex/english/news-and-events/right-now/why-do-women-leave-the-far-right.html

Bloom, Mia, *Bomba e papritur: Gratë dhe terrorizmi*, (Universiteti i Pensilvanisë, Press Philadelphia, 2011)

Bloom, Mia, "Bombat e papritura: Gratë dhe terrori", Çështjet gjinore, qershor 2011, Volumi 28, Issue 1–2, fq. 1–21.

Këshilli i Ministrave të Bosnje-Hercegovinës, *Strategjia e Bosnje-Hercegovinës për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizimit 2015−2020* (2015). Gjendet në: https://polis.osce.org/file/347/doënload?token=iM9lAER-

Botobekov, Uran, "Gratë e Azisë Qendrore në Vijën e Frontit të Xhihadit", *Diplomati* (10 janar, 2017). Gjendet në: https://thediplomat.com/2017/01/the-central-asian-women-on-the-frontline-of-jihad/

Boutin, Berenice, et al., Fenomeni i Luftëtarëve të Huaj në Bashkimin Evropian: Profilet, Kërcënimet dhe Politikat, Qendra Ndërkombëtare për Anti-Terrorizmin – Hagë (prill 2016). Gjendet në: https://icct.nl/wp-content/uploads/2016/03/ICCT-Report_Foreign-Fighters-Phenomenon-in-the-EU_1-Prill-2016_including-AnnexesLinks.pdf

Bowman, Emma dhe Ian Stewart, "Gratë pas të Djathtës Alternative", Radio Publike Kombëtare (20 gusht 2017). Gjendet në: https://www.npr.org/2017/08/20/544134546/the-ëomen-behind-the-alt-right

Byman, Daniel, *Çfarë ndodh kur ISIS vepron underground?*, Institucioni Brookings, (18 janar 2018). Gjendet në: https://www.brookings.edu/blog/markaz/2018/01/18/what-happens-when-isis-goes-underground/

Carlsson, Yngve, *Ekstremizmi i Dhunshëm: Parandalimi i një problemi djallëzor – roli i autoriteteve lokale*, Qendra e Universitetit të Oslos për Studimin e Ekstremizmit. Punimet e Serisë C-Rex, Nr. 2, 2017. Gjendet në: *https://www.sv.uio.no/c-rex/english/publications/c-rex-working-paper-series/Violent-extremism-working-paper-2-2017.pdf*

Vlerësimi i Komunitetit i Irlandës së Veriut, *Rishikimi i Departamentit për Programin e Ndërhyrjeve të Hershme të Grave të Komunitetit* (28 qershor 2017). Gjendet në: https://www.communities-ni.gov.uk/publications/evaluation-womens-early-intervention-programme

Konventa për Veprat Penale dhe Vepra të Tjera në Bordin e Avionëve (1963). Gjendet në: https://treaties.un.org/doc/db/terrorism/conv1-english.pdf

Cook, Joana dhe Gina Vale, *Nga Daesh tek 'Diaspora': Gjurmimi i Grave dhe të Miturve të Shtetit Islamik*, King's College, Londër: Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit, Departamenti i Studimeve të Luftës (23 korrik 2018). Gjendet në: https://icsr.info/2018/07/23/from-daesh-to-diaspora-tracing-the-ëomen-and-minors-of-islamic-state/

Coomarasway, Radhika, *Studim Global për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1325*, Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (2015). Gjendet në: https://www.peaceëomen.org/sites/default/files/UNW-GLOBAL-STUDY-1325-2015%20(1).pdf

Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Terrorizmin, Takimi i 31[të] Plenar, *Rolet e grave në Daesh: Diskutime* (2016). Gjendet në: https://rm.coe.int/16806b33a7

Projekti i Anti-Terrorizmit, Bosnje-Hercegovinë: Raportet për Ekstremizmin dhe Anti-Ekstremizmin. Gjendet në*: https://www.counterextremism.com/countries*

Projekti i Anti-Ekstremizmit, *Baza e të dhënave për terroristët dhe ekstremistët.* Gjendet në: https://www.counterextremism.com/extremists

Davis, Jessica, "Evolucioni i Xhihadit Global: Kamikazet femra në Irak", *Studimet për Konfliktin & Terrorizmin*, Volumi 36, Numri 4 (2013).

Dearden, Lizzie, "Ndalimi i rrobave trupore të banjos: Pse po i arreston Franca gratë myslimane që veshin kostum banjoje trupor dhe pse janë kaq të zemëruar njerëzit?" *Independent* (24 gusht 2016). Gjendet në: https://www.independent.co.uk/neës/ëorld/europe/burkini-ban-why-is-france-arresting-muslim-women-for-wearing-full-body-swimwear-and-ëhy-are-people-a7207971.html

Denham, Tara, Reformimi i policisë dhe përkatësia gjinore, Paketa e Reformës së Përkatësisë Gjinore dhe Sektorit të Sigurisë, eds. Megan Bastick dhe Kristin Valasek, DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW (2008). Gjendet në: https://www.dcaf.ch/gender-security-sector-reform-toolkit

Denoeux, Guilain dhe Lynn Carter, *Udhëzues për faktorët që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm*, Management Systems International dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (2009). Gjendet në: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf

Dickey, Christopher, "Tani ISIS po i shndërron gratë në mish për top në Francë", *Daily Beast* (2016). Gjendet në: https://www.thedailybeast.com/now-isis-is-turning-women-into-cannon-fodder-in-france

El-Said, Hamed dhe Richard Barrett, *Njohja më e mirë e fenomenit të luftëtarëve të huaj terroristë në Siri*, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Anti-Terrorizimin (korrik 2017). Gjendet në: https://www.un.org/en/counterterrorism/assets/img/Report_Final_20170727.pdf

ESRI, Baza e të Dhënave të Sulmeve Terroriste. Gjendet në: https://storymaps.esri.com/stories/terrorist-attacks/

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, *Udhëzues për ligjin e mosdiskriminimit* – edicioni i vitit 2018 (mars 2018). Gjendet në: https://fra.europa.eu/en/publication/2018/handbook-european-law-non-discrimination

Komiteti i Parlamentit Evropian për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore, *Radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm – fokusi te gratë: Si radikalizohen gratë dhe si fuqizohen ato për të parandaluar radikalizimin* (dhjetor 2017). Gjendet në: http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/596838/IPOL_STU(2017)596838_EN.pdf

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin për Zbatimin e Ligjit (EUROPOL), *Raport i Bashkimit Evropian për Situatën dhe Tendencat e Terrorizimit* (TE-SAT) (2016 dhe 2018) Te gjitha raportet e TE-SAT. Gjendet në: https://www.europol.europa.eu/activities-services/main-reports/eu-terrorism-situation-and-trend-report#fndtn-tabs-0-bottom-2

Flood, Maria, *Përkatësia Gjinore dhe Ekstremizmi i Dhunshëm: Debate Bashkëkohore*, Qendra e Universitetit të Oslos për Studimin e Ekstremizmit (9 korrik 2018). Gjendet në: https://www.sv.uio.no/c-rex/english/neës-and-events/right-noë/gender-and-violent-extremism.html

Fink, Zeiger, dhe Bhulai, Hedayah (eds.), *Bota e njeriut? Eksplorimi i roleve të grave në kundërvënien ndaj terrorizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm*, Qendra Globale për Sigurinë Bashkëpunuese (prill 2016). Gjendet në: https://www.globalcenter.org/publications/a-mans-world-exploring-the-roles-of-women-in-countering-terrorism-and-violent-extremism/

Fransen, Rosalie, et al., *Analizë: Planet Kombëtare të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Analiza e përmbajtjes nga këndvështrimi gjinor*, Aleanca e Grave për Lidership në fushën e Sigurisë, Rrjeti Ndërkombëtar i Shoqërisë Civile për Veprim (2017). Tek: Fransen, Rosalie, et al., *Analizë: Planet Kombëtare të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Analizë e Përmbajtjes nga Perspektiva Gjinore*

Geelhoed, Fiore, "Fondamentalizmi", tek Jeffrey Ian Ross, ed., *Feja dhe Dhuna: Enciklopedia e Besimit dhe Konfliktit nga Antikiteti deri Sot* Taylor & Francis. Nju Jork, 2011

Forumi Global kundër Terrorizimit, Praktikat e Mira në lidhje me Gratë dhe Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm. Gjendet në: https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/A/GCTF-Good-Practices-on-Women-and-CVE.pdf

Forumi Global kundër Terrorizimit, Roli i familjeve në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Rekomandime strategjike dhe opsione programesh. Gjendet në: https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Toolkit-documents/English-The-Role-of-Familes-in-PCVE.pdf

Qeveria e Kanadasë, Strategjia Kombëtare për Kundërvënien ndaj Radikalizimit që çon drejt Dhunës (2018). Gjendet në: https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrcs/pblctns/ntnl-strtg-cntrng-rdclztn-vlnc/index-en.aspx

Qeveria e Francës, Code pénal art. 421-1, Legifrance. Gjendet në: https://www.legifrance.gouv.fr/affichCodeArticle.do?cidTexte=LEGITEXT000006070719&idArticle=LEGIARTI000023712838&dateTexte=20111204

Qeveria e Irlandës, *Një fillim i ri: Marrëveshja e Stormontit dhe Plani i Zbatimit* (17 nëntor 2015). Gjendet në: https://www.dfa.ie/media/dfa/alldfawebsitemedia/ourrolesandpolicies/northernireland/20151117-A-Fresh-Start---The-Stormont-Agreement-and-Implementation-Plan.pdf

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, *Akti i Terrorizimit i Vitit 2000* (2000). Gjendet në: https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2000/11/contents

Hedayah, Udhëzues dhe Praktika të Mira për Hartimin e Strategjive Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Gjendet në: http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-1792016192156.pdf

Hill, Felicity, *Kontributi i grave në parandalimin e konflikteve, paralajmërimet e hershme dhe çarmatimi*, Instituti i Kombeve të Bashkuara për Studimet e Çarmatimit (2003). Gjendet në: http://www.peacewomen.org/sites/default/files/unidir_womcontributionconfprevention_2006_0.pdf

Holmes, Melinda, *Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm, Mbrojtja e të Drejtave dhe Policimi në Komunitet: Pse kanë rëndësi partneritetet midis shoqërisë civile dhe sektorit të sigurisë*, Aleanca e Grave për Liderët në fushën e sigurisë, Rrjeti Ndërkombëtar i Shoqërisë Civile për Veprim (2017). Gjendet në: https://www.icanpeacework.org/wp-content/uploads/2018/02/PVE-and-Policing-Brief-2017.pdf

Idris, Iffat dhe Ayat Abdelaziz, *Gratë dhe kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm*, Helpdesk Research Report, GSDRC (maj 2017). Gjendet në: https://gsdrc.org/publications/ëomen-and-countering-violent-extremism/

Ingram, Kiriloi M., "Manipulimi i Shtetit Islamik me Gjininë në Operacionet e tyre të Informacioneve *Online*", *VOX-Pol* (22 mars 2018). Gjendet në: https://www.voxpol.eu/the-islamic-states-manipulation-of-gender-in-their-online-information-operations/

Institut Tunesien des Etudes Stratégiques, *Vlerësimi i Kërcënimeve që paraqesin Luftëtarët e Huaj Tunizianë* (2018). Gjendet në: http://www.ites.tn/fr/english/Assessing-the-Threat-Posed-by-Tunisian-Foreign-Fighters/15

Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes Peng (1979). Gjendet në: https://treaties.un.org/doc/db/terrorism/english-18-5.pdf

Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Bombardimeve Terroriste (1997). Gjendet në: https://www.unodc.org/documents/treaties/Special/1997%20International%20Convention%20for%20the%20Suppression%20of%20Terrorist.pdf

Qendra e Institutit Ndërkombëtar Republikan për Analizat e Studimeve të Sondazheve, Njohja e faktorëve lokalë që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë (2017). Gjendet në: http://www.iri.org/sites/default/files/2017-9-17_kosovo_vea_report.pdf

Johnson, Verity, "Një hap e ndan mizogjenin e zemëruar nga ekstremisti i dhunshëm", *Stuff* (2018). Gjendet në: https://www.stuff.co.nz/life-style/life/103591936/verity-johnson-its-a-short-step-from-angry-misogynist-to-violent-extremist

Jones, Seth, *Lindja e Ekstremizmit të Djathtë në Shtetet e Bashkuara*, Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (7 nëntor 2018). Gjendet në: https://www.csis.org/analysis/rise-far-right-extremism-united-states

Komisioni Kombëtar i Jordanisë për Gratë dhe Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, *Raport Teknik: Gratë dhe Radikalizimi i Dhunshëm në Jordani* (2016). Gjendet në: https://www.refworld.org/pdfid/5881d4e44.pdf

Kao, Kristen dhe Mara Redlich Revkin, *Të dënosh apo të falësh? Riintegrimi i bashkëpunëtorëve të rebelëve pas konfliktit të Irak*, Programi i Universitetit të Gotenburgut për Qeverisjen dhe Zhvillimin Lokal (2018). Gjendet në: https://gld.gu.se/media/1503/gld-working-paper-17-final.pdf

"Inteligjenca e Kazakistanit: 150 gra kazake janë anëtare të Shtetit Islamik", Radio Free Europe/Radio Liberty (18 nëntor 2014). Gjendet në: https://www.rferl.org/a/under-black-flag-kazakhstan-kazakh-ëomen-islamic-state/26698040.html

Kitchener, Caroline, "Gratë pas të Djathtës Alternative'", *The Atlantic* (18 gusht 2017). Gjendet në: https://www.theatlantic.com/politics/archive/2017/08/the-ëomen-behind-the-alt-right/537168/

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, *Gratë në Ekstremizmin e Dhunshëm: Mësimet e Nxjerra nga Kosova* (26 janar 1017). Gjendet në: http://www.qkss.org/en/Reports/Women-in-Violent-Extremism-Lessons-learned-from-Kosovo-841

Krouse, William J. dhe Daniel Richardson, *Vrasjet masive me armë zjarri: Incidentet dhe viktimat, 1999-2003*, Shërbimi Studimor i Kongresit të Shteteve të Bashkuara, R44126 (30 korrik 2015). Gjendet në: https://fas.org/sgp/crs/misc/R44126.pdf

Republika Kirgize, Ligji i Republikës Kirgize për Kundërvënien ndaj Terrorizmit, Nr. 178 (2006). Gjendet në: https://www.legislationline.org/documents/id/22040

Lahoud, Nelly, *Fuqizim apo nënshtrim: Analizë gjinore e Mesazheve të ISIL*, Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (2018). Gjendet në: http://arabstates.unwomen.org/en/digital-library/publications/2018/6/empowerment-or-subjugation

Lonsway, Kimberley A., *Punësimi & Mbajtja në Punë e më shumë Grave: Avantazhet për Agjencitë e Zbatimit të Ligjit*, Qendra Kombëtare për Gratë dhe Policimin, Fondacioni i Shumicës Feministe (2003). Gjendet në: http://womenandpolicing.com/pdf/neëadvantagesreport.pdf

Malik, Nikita, *Trafikimi i Terrorit: Si e financojnë terrorizmin skllavëria moderne dhe dhuna seksuale*, Qendra e Shoqërisë Henry Jackson për Përgjigjen ndaj Radikalizimit dhe Terrorizmit (2017). Gjendet në: http://henryjacksonsociety.org/wp-content/uploads/2017/10/HJS-Trafficking-Terror-Report-web.pdf

Martin, Susan Ehrlich dhe Nancy C. Jurik, *Të bësh drejtësi, të merresh me përkatësinë gjinore: Gratë në profesionet e avokatisë dhe drejtësisë penale*, Botimet e SAGE (2006).

Mataeva, A. "Radikalizimi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Kirgistan". *The RUSI Journal.* Vol. 163, 2018, Numri 1. fq. 30–46.

McFee, Dale R. dhe Norman E. Taylor, *Qendra e Princit Albert dhe shfaqja e sigurisë së komunitet e fokusuar te risqet*, Seria e Diskutimeve të Kolegjit të Policisë Kanadeze (2014). Gjendet në: http://publications.gc.ca/site/eng/9.832291/publication.html

Mehra, Tanya, *Luftëtarët e Huaj Terroristë: Tendencat, Dinamikat dhe Përgjigja mes Politikave*, Qendra Ndërkombëtare e Anti-Terrorizimit – Haga dhe Forumi Global kundër Terrorizmit (2016). Gjendet në: https://icct.nl/publication/foreign-terrorist-fighters-trends-dynamics-and-policy-responses/

Michelle, Nicolette, "Gratë me një qëllim: Vala e re e grave tradicionale të së djathtës alternative", *Medium* (2018). Gjendet në: https://medium.com/@luvnicomichelle/women-with-a-purpose-the-new-wave-of-the-alt-right-tradwives-c980550a699d

Miller, Amalia R. dhe Carmit Segal, *A e përmirësojnë oficeret femra cilësinë e zbatimit të ligjit? Efektet në raportimin e krimit dhe përshkallëzimin e dhunës në familje*, Universiteti i Zyrihut, Qendra Ndërkombëtare UBS e Ekonomikut në Siguri, Punimi Nr. 9 (2014). Gjendet në: https://www.ubscenter.uzh.ch/assets/workingpapers/ËP9_Do_Female_Officers_Improve_Laë_Enforcement_Quality.pdf

Naddaff, A.J., "Kosova, shtëpia shumë të rekrutuarve të ISIS-it, po lufton për eliminimin e problemit të saj me terrorizmin e kultivuar në vend", *The Washington Post* (14 gusht 2018). Gjendet në: https://www.washingtonpost.com/gdpr-consent/?destination=%2fworld%2f2018%2f08%2f24%2fkosovo-home-many-isis-recruits-is-struggling-stamp-out-its-homegrown-terrorism-problem%2f%3f&utm_term=.eae8fc41b354

Konsorciumi Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Reagimeve ndaj Terrorizmit (START), Baza Globale e të Dhënave për Terrorizmin. Gjendet në: https://www.start.umd.edu/gtd/

Newman, Caroline, "Studim: Punësimi i Oficereve Gra të Policisë ndihmon në raportimin e dhunës në familje dhe sulmeve seksuale", *UVA Today* (2018). Gjendet në: https://news.virginia.edu/content/study-hiring-female-police-officers-helps-women-report-violence-sexual-assault

Ní Aoláin, Fionnuala, "Mashkulloriteti, xhihadi dhe mobilizimi", *Just Security* (2016). Gjendet në: https://www.justsecurity.org/33624/masculinity-jihad-mobilization/

Nilson, Chad, *Modeli i Qendrës Kanadeze: Apel për perceptime dhe vlerësime nga ata klientë që janë në fokus të ndërhyrjeve bashkëpunuese me bazë riskun, Buletin për Sigurinë dhe Mirëqenien e Komunitetit* (2016). Gjendet në: https://journalcswb.ca/index.php/cswb/article/view/30/51

Ministria Norvegjeze e Drejtësisë dhe Sigurisë Publike, *Plani i Veprimit kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm* (2014). Gjendet në: https://www.regjeringen.no/en/dokumenter/Action-plan-against-Radicalisation-and-Violent-Extremism/id762413/

Pearson, Elizabeth, *Pse burrat luftojnë, kurse gratë jo: Mashkulloriteti dhe Dhuna Ekstremiste*, Instituti i Tony Blair për Ndryshim Global (2018). Gjendet në: https://institute.global/insight/co-existence/ëhy-men-fight-and-ëomen-dont-masculinity-and-extremist-violence

“Ndalimi i marshimit në ditën e pavarësisë polake nga nacionalistët në Varshavë”, *BBC News* (7 nëntor 2018). Gjendet në: https://www.bbc.com/neës/ëorld-europe-46123001

Provost, Claire dhe Lara Whyte, *Pse po u bashkohen gratë lëvizjeve të djathta ekstreme dhe pse po habitemi ne kaq shumë?*, openDemocracy (2018). Gjendet në: https://www.opendemocracy.net/en/5050/women-far-right-movements-why-are-we-surprised/

Siguria Publike në Kanada, Raport Publik i vitit 2017 për Kërcënimet Terroriste ndaj Kanadasë (2017). Gjendet në: https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrcs/pblctns/pblc-rprt-trrrst-thrt-cnd-2017/index-en.aspx

Siguria Publike në Kanada, “Financimet federale për Policinë e Torontos për zgjerimin e iniciativës së kundërvënies ndaj radikalizimit që çon në dhunë”, *PR Newswire* (06 shtator 2018). Gjendet në: https://www.newswire.ca/news-releases/federal-funding-for-toronto-police-to-expand-counter-radicalization-to-violence-initiative-692624631.html

Oltermann, Philip, “Gjermanja neonaziste Beate Zschäpe dënohet me burgim të përjetshëm për vrasjet e NSU-së”, *The Guardian* (11 korrik 2018). Gjendet në: https://www.theguardian.com/ëorld/2018/jul/11/german-neonazi-beate-zschape-gets-life-for-nsu-murders

Iniciativa e Shoqërisë së Hapur për Drejtësi, Profilizimi Etnik në Bashkimin Evropian: I përhapur, Joefikas dhe Diskriminues (maj 2009). Gjendet në: https://www.opensocietyfoundations.org/reports/ethnic-profiling-european-union-pervasive-ineffective-and-discriminatory

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Udhëzuesi i OSBE-së për Mekanizmat e Referimit*, prill 2019.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Plani i Veprimit i Bukureshtit për Kundërvënien ndaj Terrorizmit* (2001). Gjendet në: https://www.osce.org/atu/42524

**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë**

Wallnerstrasse 6
A-1010 Vienna, Austria
Tel.: +43 1 514 360

pm@osce.org
www.osce.org

**Ndiqni OSBE-në**

OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë